



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

RAPORTI I GJELBËR 2022



Raporti i Gjellbër i Kosovës 2022

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Prishtinë 2022

Dhjetor, 2022

Fjala hyrëse

Sektori i bujqësisë është një sektor dominant në vendin tonë, duke nisur nga fakti se bujqësia kontribuon rreth 7% të GDP-së së përgjithshme të vendit dhe shënon pjesëmarrje të konsiderueshme edhe në numrin e të punësuarve në Kosovë. Prandaj, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural po punon që politikat e saj ti orientoj në fushat ku vendi ka më shumë nevojë në mënyrë që të kemi zhvillim të mëtejshëm të sektorit dhe përkrahje edhe më të madhe në zbatimin e politikave tona në shërbim të fermerëve.

Vlen të theksohet se MBPZhR, gjatë këtij viti ka zhvilluar një sërë aktivitete të cilat kanë qenë dhe vazhdojnë të mbesin prioritet i yni për zhvillim ekonomik të vendit. Kemi finalizuar dy Strategjitë kryesore të sektorit të bujqësisë dhe pylltarisë, kemi implementuar programet tona mbështetëse duke shumëfishuar mbështetjen karshi fermerëve tanë, kemi avancuar pjesën legjislative ku janë proceduar në Qeveri disa Ligje të cilat në të ardhmen do të na mundësojnë përkrahje më të madhe financiare si dhe arrihen e shumë qëllimeve tona që vendi ynë të jetë i përfaqësuar në çdo etapë të zhvillimit të sektorit të bujqësisë.

Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si pjesë të aktiviteteve të saj, këtë vit për të 10ⁱⁿ vit me radhë ka përgatitur Raportin e Gjelbër. Raporti i Gjelbër është i vetmi raport i tillë i përgatitur në nivel rajoni përmes të cilit ofrohen informacione për gjendjen e përgjithshme statistikore të sektorit të bujqësisë, për politikat zhvillimore, strategjitë zhvillimore, shkëmbimin tregtar dhe shumë të dhëna tjera të cilat shërbejnë si tregues mbi zhvillimin e sektorit në vendin tonë.

MBPZhR, vazhdon të mbetet e përkushtuar gjithnjë në zbatimin të objektivave të saj, zbatimin të legjislacionit, implementimin të programeve mbështetëse, digjitalizimin e sektorit, avancimin e teknologjive, bashkëpunimin me gjitha palët e interesit vetëm që vendit dhe fermerit ti ofrohet shërbim cilësor, korrekt dhe i duhur për të qenë në hap me zhvillimet e fundit dhe të ketë përfaqësim cilësor në harmoni me gjitha standardet në tregjet vendore dhe të jashtme.

Faton Peci

Ministër



Hyrja

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka kënaqësinë që këtë vit, për të 10 in vit me radhë të publikoj Raportin e Gjelbër. Gjatë këtyre 10 viteve raporti është avancuar dhe përmirësuar duke ofruar të dhëna statistikore të përmbledhura në një vend, dhe jo vetëm statistika por edhe një analizë të përgjithshme mbi gjendjen e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimeve kryesore në nivel vendi.

Raporti i Gjelbër për vitin 2022, në përmbajtjen e tij paraqet të dhënat për mjedisin e përgjithshëm ekonomik, prodhimin bujqësor dhe përdorimin e tij, pylltarinë, tregtinë, sigurinë dhe cilësinë e ushqimit, politikat bujqësore të cilat përfshijnë pagesat direkte/subvencionet si dhe përkrahjen përmes granteve investive. Përmes këtyre kaptinave ofrohen të dhënat e përmbledhura dhe të përpunuara në bashkëpunim me të gjitha departamentet dhe agjencitë brenda MBPZhR-ës, si dhe institucionet dhe agjencitë tjera jashtë ombrellës së ministrisë. Ndërkaq, për të fuqizuar rolin e raportit në mënyrë që të jetë gjithpërfshirës dhe i paanshëm, MBPZhR ka themeluar me vendim edhe Komitetin Drejtues, i cili ka rol kyç në hartimin e këtij raporti.

Vlenë të ceket se në edicionin e sivjetmë të Raporti të Gjelbër, tek bilancet e furnizimit për pemë, perime, drithëra, qumësht dhe mish janë rishikuar të dhënat e shkëmbimit tregtar ndër vite dhe janë harmonizuar kodet doganore, gjithashtu edhe tek çmimet e produkteve bujqësore ka pasur disa ndryshime në çmime për arsye të harmonizimit dhe unifikimit të çmimeve.

Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore (**përbërë nga Delvina Hana Bakija, Hakile Xhaferi, Adelina Maksuti, Skender Bajrami, Belgin Dabiqaj dhe Shkëlqim Duraku**) i cili harton dhe e publikon Raportin e Gjelbër, falënderon të gjithë lexuesit të cilët për këto 10 vite, na kanë inkurajuar dhe mbështetur me sugjerimet e tyre që raporti të jetë gjithnjë e më i strukturuar dhe në shërbim të sektorit, si i vetmi burim gjithpërfshirës i të dhënave statistikore të bujqësisë në vend. Ne vazhdojmë të punojmë me përkushtim maksimal që raporti të vazhdojë të mbetet si udhërrëfyes në nivel vendi i cili ofron informacionet e nevojshme dhe të dhëna të qëndrueshme mbi sektorin.

Delvina Hana Bakija



Drejtoreshë e Departamentit të Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave	6
Lista e figurave	9
Lista e shkurtesave	11
1 Mjedisi i përgjithshëm ekonomik	12
1.1 Niveli i zhvillimit socio-ekonomik.....	14
1.2 Puna dhe punësimi	15
1.3 Llogaritë ekonomike në bujqësi.....	17
1.3.1 Prodhimet bujqësore	17
1.3.2 Të ardhurat sipërmarrëse	20
1.3.3 Inputet në bujqësi	21
1.4 Çmimet e inputeve dhe prodhimeve bujqësore.....	23
1.4.1 Çmimet e inputeve bujqësore	23
1.4.2 Çmimet e prodhimeve bujqësore	25
Çmimet e fermës të prodhimeve bujqësore	26
Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore	27
Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore	29
Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e regjionit dhe BE-së.....	31
1.5 Privatizimi i tokave bujqësore	32
1.6 Bizneset bujqësore – Agroindustria	35
2 Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij	42
2.1 Përdorimi i tokës bujqësore	42
2.2 Prodhimtaria bimore	45
2.2.1 Drithërat	45
2.2.2 Perimet.....	48
2.2.3 Pemët.....	54
2.2.4 Vreshtat dhe verërat.....	59
Vreshtat	59
Verërat.....	64
Analizat fiziko- kimike të verës.....	65
2.2.5 Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbëra.....	67
2.2.6 Kulturat industriale.....	68
2.3 Ujitja e tokës bujqësore	69
2.4 Blegtoria	70
2.4.1 Gjedhet.....	70
2.4.2 Dhentë dhe dhitë	72
2.4.3 Derrat dhe kafshët tjera të fermës	72
2.4.4 Shpezëtaria	73
2.4.5 Bletaria	74
3 Pylltaria	75
4 Tregtia	83
4.1 Tregtia e përgjithshme.....	83
4.2 Tregtia e produkteve bujqësore.....	83
4.2.1 Tregtia sipas grupeve të shteteve	85

Tregtia me vendet e CEFTA-s.....	85
Tregtia me vendet e BE-së.....	87
Tregtia me vendet e treta	90
4.2.2 Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24).....	92
Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24).....	92
Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24).....	93
5 Siguria, standardet dhe cilësia e ushqimit.....	94
5.1 Emetimi i gazrave serrë.....	98
6 Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural	102
6.1 Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve.....	102
6.2 Pagesat direkte/subvencionet.....	104
6.2.1 Pagesat direkte për kulturat bujqësore, verë dhe sigurim bujqësor	109
Primi i sigurimit bujqësor	113
6.2.2 Pagesat direkte për blegtori dhe qumësht.....	114
6.2.3 Mbështetja e inuteve në bujqësi	117
Mbështetja e fidanëve.....	117
6.3 Agro kreditë dhe fondi garantues.....	118
6.3.1 Agro Kreditë	118
Fondi Kosovar për Garanci Kreditore - FKGK	122
6.4 Sigurimet në fushën e bujqësisë	124
Zhvillimi dhe Shitja e Produktet Indeks të Sigurimit Bujqësor	124
Dëmet/ humbjet dhe Pagesat e Dëmshpërblimit	125
Produktet Tradicionale të Sigurimit Bujqësor	126
Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.....	126
Kampanjat Publike Vetëdijësuese.....	127
Sistemi Informativ i Sigurimeve Bujqësore.....	128
6.5 Projektet e zhvillimit rural – Grantet investive	128
6.6 Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve.....	131
Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor.....	131
Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor	133
7 Shtojcat	134
7.1 Lista e ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me Bujqësinë, Pylltarinë dhe Zhvillimin Rural	134
7.1.1 Legjislacioni kombëtar në fuqi.....	134
7.1.2 Udhëzimet Administrative të miratuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2021	134
7.2 Statistikat krahasuese	135
7.3 Personat përgjegjës për Raportin e Gjellbër, 2022.....	137

Lista e tabelave

Tabela 1:	Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale (në '000 €)	13
Tabela 2:	Indikatorët kryesor të tregut të punës sipas variablave, 2017-2021 (%)	16
Tabela 3:	Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2015-2021, (2015=100)	24
Tabela 4:	Çmimet vjetore për energji elektrike dhe naftë në €, 2016-2021	24
Tabela 5:	Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë, €/kg	26
Tabela 6:	Çmimet mesatare vjetore të tregut me shumicë, €/kg	27
Tabela 7:	Çmimet mesatare vjetore të tregut me pakicë, €/kg.....	28
Tabela 8:	Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore, €/kg.....	29
Tabela 9:	Vlera për njësi e prodhimeve bujqësore të importuara, €/kg	30
Tabela 10:	Çmimet e disa prodhimeve në Kosovë dhe disa vende të BE-së në vitin 2021, €/kg.....	31
Tabela 11:	Shitjet e tokave bujqësore në Kosovë, sipas regjioneve, 2005-2021	32
Tabela 12:	Shitja e tokave bujqësore në Kosovë, 2005-2021	34
Tabela 13:	Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike, 2017-2021.....	35
Tabela 14:	Ndërmarrjet e regjistruara të agrobizneseve, 2017-2021	37
Tabela 15:	Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari, 2021.....	39
Tabela 16:	Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, ha.....	42
Tabela 17:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i drithërave, 2017-2021	45
Tabela 18:	Bilanci i furnizimit për grurin, 2017-2021.....	46
Tabela 19:	Bilanci i furnizimit për misrin, 2017-2021.....	47
Tabela 20:	Sipërfaqja me perime, 2017 - 2021.....	48
Tabela 21:	Prodhimi i perimeve, 2017 - 2021.....	49
Tabela 22:	Rendimenti i perimeve, 2017 - 2021.....	50
Tabela 23:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kulturave të dyta pas korrjes së parë	51
Tabela 24:	Bilanci i furnizimit për domaten, 2017-2021	52
Tabela 25:	Bilanci i furnizimit për specin, 2017-2021	53
Tabela 26:	Bilanci i furnizimit për pataten, 2017-2021.....	54
Tabela 27:	Sipërfaqja dhe prodhimi i pemëve, 2017 - 2021	55
Tabela 28:	Rendimenti i pemëve, 2017 - 2021	56
Tabela 29:	Bilanci i furnizimit për mollën, 2017-2021.....	57
Tabela 30:	Bilanci i furnizimit për kumbullën, 2017-2021.....	58
Tabela 31:	Bilanci i furnizimit për dredhëzën, 2017-2021	59
Tabela 32:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i rrushit, 2017-2021	59
Tabela 33:	Bilanci i furnizimit për rrush tryeze, 2017-2021.....	61
Tabela 34:	Varietetet e rrushit të tryezës, 2021	62
Tabela 35:	Varietetet e rrushit të verës, 2021	63
Tabela 36:	Prodhimi i verës 2017-2021, '000 litra	64
Tabela 37:	Prodhimi i verës sipas kompanive, 2021	65
Tabela 38:	Analizat fiziko - kimike të verës për periudhën 2017 - 2021	66
Tabela 39:	Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i kulturave foragjere dhe drithërave të kositura të gjelbëra, 2017-2021.....	67

Tabela 40:	Sipërfaqja dhe prodhimi i kulturave industriale, 2017-2021	68
Tabela 41:	Ujitja e tokave bujqësore në komuna për vitin 2021	69
Tabela 42:	Fondi dhe struktura e gjedheve, 2017-2021.....	70
Tabela 43:	Bilanci i furnizimit për mish të gjedhit, 2017-2021	71
Tabela 44:	Bilanci i furnizimit për qumështin dhe produktet e qumështit të lopës, 2017-2021	71
Tabela 45:	Numri i dhenve dhe dhive, 2017-2021.....	72
Tabela 46:	Numri i derrave dhe kafshëve të tjera të fermës, 2017-2021	72
Tabela 47:	Numri i shpezëve dhe vezëve 2017-2021, në '000	73
Tabela 48:	Numri i koshereve të bletëve, 2017-2021.....	74
Tabela 49:	Pëlqimet për themelim, dhënie në menaxhim dhe miratimi i PM.....	77
Tabela 50:	Licencat e lëshuara	77
Tabela 51:	Plani i prerjeve në pyjet shtetërore.....	78
Tabela 52:	Realizimi i planit të prerjeve në pyjet shtetërore.....	78
Tabela 53:	Plani në kultivimi dhe shfrytëzimin e pyjeve private dhe punët tekniko-profesionale.....	79
Tabela 54:	Të dhënat mbi përdorimin e pyjeve private	79
Tabela 55:	Kallëzimet apo fletëparaqitjet, 2021	80
Tabela 56:	Konfiskimi i materialit drunor.....	80
Tabela 57:	Numri i rasteve të zjarreve pyjore dhe sipërfaqja, 2021	81
Tabela 58:	Prodhimtaria e fidanëve, 2021	81
Tabela 59:	Pyllëzimet vjeshtore, 2021	82
Tabela 60:	Eksporti-Importi i përgjithshëm.....	83
Tabela 61:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore.....	83
Tabela 62:	Eksport, Importi dhe Bilanci tregtar i produkteve bujqësore (1-24), në '000.....	84
Tabela 63:	Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm (majtas), Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm (djathtas).....	84
Tabela 64:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve, 2021 në mil. €	85
Tabela 65:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore me vendet e CEFTA-s.....	86
Tabela 66:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore në vendet CEFTA-s, në '000 €.....	87
Tabela 67:	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore me vendet e BE-së.....	88
Tabela 68:	Eksporti sipas vendeve të BE-së në '000 € (majtas) dhe Eksporti sipas vendeve të BE-së në % (djathtas)	89
Tabela 69:	Importi sipas vendeve të BE-së, në '000 €.....	89
Tabela 70:	Importi dhe Importi nga Vendet e Treta	90
Tabela 71:	Eksporti i produkteve bujqësore 2016-2020, në '000 €	92
Tabela 72:	Importi i produkteve bujqësore 2016-2020, në '000 €.....	93
Tabela 73:	Shpërndarja e vaksinave sipas sëmundjeve të kafshëve	94
Tabela 74:	Marrja e mostrave të gjakut për analiza laboratorike.....	94
Tabela 75:	Asgjësimi i kafshëve sipas sëmundjeve infektive dhe shuma e kompensimit të fermerëve	94
Tabela 76:	Lëshimi i lejeve të importit.....	95
Tabela 77:	Licencimi i subjekteve afariste.....	95
Tabela 78:	Analizat për testimin e produkteve të importuara dhe nr. i mostrave	95
Tabela 79:	Tabela e aktiviteteve të sektorit Fitosanitar kufitar.....	96

Tabela 80:	Marrja e mostrave dhe dërgimi i tyre në Laborator	96
Tabela 81:	Aktivitetet e kryera nga Sektori i Mikrobiologjisë së Ushqimit	96
Tabela 82:	Mostrat e testuara në Kiminë Ushqimore	97
Tabela 83:	Parametrat e testuar sipas aparaturave	97
Tabela 84:	Lloji dhe numri i analizave të sektorit të patologjisë	97
Tabela 85:	Numri i mostrave të testuara, 2021	98
Tabela 86:	Emetimet e përgjithshme të gazrave të serrës në Kosovë sipas sektorëve, 2019.....	99
Tabela 87:	Burimet kryesore të emetimeve të gazrave serrë në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokave sipas sektorëve dhe nën sektorëve për vitin 2019.....	101
Tabela 88:	Buxheti i planifikuar për pagesa direkte, 2021	103
Tabela 89:	Pagesat direkte 2017-2021, në €	105
Tabela 90:	Pagesat direkte sipas gjinisë në vitin 2021, në €	107
Tabela 91:	Pagesat direkte sipas tipit të fermerit në vitin 2021, në €	108
Tabela 92:	Pagesat direkte sipas sektorëve, 2017-2021	110
Tabela 93:	Pagesat direkte sipas sektorëve, 2017-2021	114
Tabela 94:	Pagesat direkte për fidanë sipas regjionit, 2021.....	117
Tabela 95:	Agrokreditë 2017 - 2021	119
Tabela 96:	Shpërndarja rajonale e kredive të miratuara, 2021.....	123
Tabela 97:	Produktet e Sigurimit Indeks për Kosovë për vitin 2021	124
Tabela 98:	Dëmet e raportuara nga fermerët në periudhën 2017-2021, në €	126
Tabela 99:	Buxheti i paraparë i PZhR-së, 2020-2021	129
Tabela 100:	Projektet e autorizuar në kuadër të PZhR-ës, 2020-2021	130
Tabela 101:	Pjesëmarrja në trajnime për analizat e dheut.....	132
Tabela 102:	Aktivitetet e zhvilluara në qendrat këshilluese informative	132
Tabela 103:	Aktivitetet e zhvilluara në terren nga këshilltarët	132
Tabela 104:	Kompanitë e licencuara për ofrimin e këshillave për bujqësi dhe zhvillim rural.....	133
Tabela 105:	Moti në Prishtinë, numri i ditëve me shi dhe borë sipas muaji dhe vitit	135
Tabela 106:	Gjatësia e lumenjve kryesore brenda territorit të Kosovës	136
Tabela 107:	Pyjet e Kosovës sipas llojit dhe pronësisë, ha	136
Tabela 108:	Liqejt kryesor në Kosovë, sipërfaqja në km	136
Tabela 109:	Përdorimi i internetit sipas grup moshave, 2018-2022* (%).....	136
Tabela 110:	Lloji i qasjes në internet në ekonomitë familjare sipas lloji i qasjes dhe viti (%)	136

Lista e figurave

Figura 1:	Pjesëmarrja e bujqësisë në Bruto Produktin Vendor 2010-2021, (në %)	14
Figura 2:	Indikatorët kryesor të tregut të punës, 2017-2021 (%)	16
Figura 3:	Prodhimet bimore dhe blegtorale në mil. €, 2017-2021	17
Figura 4:	Pjesëmarrja e kulturave bujqësore në gjithsej prodhimin bimor, 2021	18
Figura 5:	Shitja e mishit sipas kategorisë (majtas) dhe e produkteve blegtorale (djathtas), 2021	18
Figura 6:	Prodhimet bimore në mil. €, 2017-2021	19
Figura 7:	Blegtoria në mil. €, 2017-2021	19
Figura 8:	Produktet blegtorale në mil. €, 2017-2021	20
Figura 9:	Prodhimi bujqësor, konsumi i ndërmjetëm dhe bruto vlera e shtuar në mil. €, 2017-2021	20
Figura 10:	Të hyrat e agreguara në bujqësi në mil. €, 2017-2021	21
Figura 11:	Struktura e konsumit të ndërmjetëm, 2021	22
Figura 12:	Inputet në bujqësi sipas kategorive, 2021	22
Figura 13:	Indeksi vjetor i çmimeve të inpueteve bujqësore 2015-2021, (2015=100)	23
Figura 14:	Çmimi mesatar për sipërfaqet e shitura të tokave bujqësore dhe vlera totale e shitjeve, 2005-2021	33
Figura 15:	Shitja e tokave bujqësore në ha, 2005-2021	33
Figura 16:	Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike, 2017-2021	36
Figura 17:	Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari (%), ndaj aktiviteteve tjera ekonomike, në vitin 2021	36
Figura 18:	Qarkullimi monetar i ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari, 2017-2021, ('000 €)	37
Figura 19:	Numri i të punësuarve në agrobiznese, 2017-2021	38
Figura 20:	Numri i bizneseve aktive, 2017-2021	38
Figura 21:	Qarkullimi (mil. €), sipas aktiviteteve bujqësore, 2021	39
Figura 22:	Numri i të punësuarve sipas aktiviteteve bujqësore, 2021	40
Figura 23:	Numri i bizneseve aktive në vitin, 2021	40
Figura 24:	Qarkullimi, numri i të punësuarve dhe numri i bizneseve aktive në sektorin e bujqësisë sipas regjioneve (%), 2021	41
Figura 25:	Tokë e punueshme-ara dhe livadhe e kullosa	43
Figura 26:	Perime, kopshte dhe fidanishte, plantacione të pemëve dhe vreshtave	44
Figura 27:	Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, 2021	44
Figura 28:	Sipërfaqja e vreshtave në ha, 2017-2021	60
Figura 29:	Prodhimi i rrushit në tonë, 2017-2021	60
Figura 30:	Prodhimi i verës 2017-2021, '000 litra	64
Figura 31:	Harta e shtrirjes të pyjeve dhe pyjet sipas origjinës	76
Figura 32:	Fidanët e përdorura për pyllëzime vjeshtore, 2021	82
Figura 33:	Eksporti sipas grupeve të shteteve (majtas), Importi sipas grupeve të shteteve (djathtas), 2021 në %	85
Figura 34:	Pjesëmarrja e CEFTA-s në eksportin bujqësor (majtas), Pjesëmarrja e CEFTA-s në importin bujqësor (djathtas)	86
Figura 35:	Eksporti sipas vendeve të CEFTA-s (majtas), Importi sipas vendeve të CEFTA-s (djathtas), 2020	87

Figura 36: Pjesëmarrja e BE-së në eksportin bujqësor (majtas), Pjesëmarrja e BE-së në importin bujqësor (djathtas).....	88
Figura 37: Eksporti në Vendet e Treta, (majtas) dhe Importi nga Vendet e Treta, në % (djathtas)	91
Figura 38: Emetimi i GHG sipas sektorëve, 2019 (%).....	99
Figura 39: Trendi i emetimeve totale të gazrave të serrës nga sektori i bujqësisë 2007-2019.....	101
Figura 40: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve në vitin 2021	104
Figura 41: Pagesat direkte 2017-2021, në 1000 €.....	104
Figura 42: Pagesat direkte sipas sektorëve 2021, në mil. €	106
Figura 43: Numri i aplikuesve dhe përfituesve sipas gjinisë në vitin 2021	106
Figura 44: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve sipas gjinisë në vitin 2021	107
Figura 45: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve sipas tipit të fermerit në vitin 2021	108
Figura 46: Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2021	112
Figura 47: Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2021	112
Figura 48: Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2021	116
Figura 49: Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2021	116
Figura 50: Shuma totale dhe numri i agrokredive të disbursuara (mil. € dhe '000).....	119
Figura 51: Shuma e agrokredive nga Bankat dhe IMF, mil. €	120
Figura 52: Numri agrokredive nga Bankat dhe IMF, '000 €	121
Figura 53: Norma e interesit në kredi bujqësore nga Bankat dhe IMF, %	121
Figura 54: Proporcioni i shpërndarjes së kredive, %	123
Figura 55: Sipërfaqja totale e siguruar në ha dhe nr. i fermerëve të siguruar	125
Figura 56: Moti në Prishtinë, numri i ditëve me shi dhe borë 2010-2021.....	135

Lista e shkurtesave

ADIS	Sistemi Informativ për Shëndetin e Kafshëve
AEB	Anketa Ekonomive Bujqësore
AFK	Agjencia për Financim në Kosovë
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
APK	Agjencia Pyjore e Kosovës
APPK	Asociacioni i Pronarëve të Pyjeve të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
AZhB	Agjencia për zhvillimin e Bujqësisë
BE	Bashkimi Evropian
BKT	Banka Kombëtare Tregtare
BPB	Banka Private për Biznes
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja për tregti të lirë me vendet e Evropës Qendrore
DAESB	Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore
DK	Drejtoritë Koordinuese
DP	Depratamenti i Pyjeve
DPBT	Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve
DShKT	Departamenti i Shërbimeve Këshillimore Teknike
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
Gg	Giga gram
GHG	Emetimi i gazrave serrë
GLV	Grupe Lokale të Veprimit
IFP	Institucione Financiare Partnere
IMF	Institucionet Mikro Financiare
INP	Inventarizimi Nacional i Pyjeve
IPCC	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
KE	Komisioni Evropian
KEP	Programi i Ndërmarrjeve të Kosovës
KRK	Kreditimi Rural i Kosovës
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
NEET	As në Arsim, Punësim e as në Aftësim
NIF	Numri identifikues i fermës
NLB	NLB Banka
NSH	Ndërmarrja Shoqërore
NjMP	Njësi menaxhuese pyjore
OIE	Organizata e Shëndetit të Kafshëve
PBZHR	Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
PCB	Procredit Bank
PM	Plane Menaxhuese
PPD	Programi i Pagesave Direkte
PPJD	Produkte pyjore jo drusore
PRE	Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike
PT	PT Testi i Aftësisë (Proficiencës)
PZhR	Programi i Zhvillimit Rural
QKI	Qendra Këshilluese Informative
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
RASFF	Sistemi i Alarmimit Rapid për Ushqim dhe Ushqyerje
RBKO	Raiffeisen Bank
SBSH	Sipërfaqja Bujqësore e Shfrytëzuar
SKKBZhR	Strategjia Kombëtare e Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
SShK	Sektori i Shëndetit të Kafshëve
TBC	Sëmundja e Tuberkulozit
TEB	Banka Ekonomike Turke
TM1	Tremujori i parë
UA	Udhëzim Administrativ
UHT	Temperaturë Ultra e Lartë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
UTB	Ujitja e tokave bujqësore

1 Mjedisi i përgjithshëm ekonomik

Ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje të lartë gjatë vitit 2021, pas tkurrjes me të cilën u karakterizua në vitin 2020 për shkak të efektit të pandemisë COVID 19. Vlerësimet preliminare të ASK-së tregojnë se ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 10.5% në vitin 2021. Rritja e lartë e aktivitetit ekonomik iu atribuua përmirësimit të krizës shëndetësore dhe politikave mbështetëse financiare dhe fiskale. Komponentët që kontribuan në rritjen e lartë të aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2021 ishin rritja e konsumit prej 7.8%, rritja e investimeve prej 10.2% por edhe rritja më e ngadalësuar e deficitit të eksporteve neto (1.9%). Rritja e kërkesës së përgjithshme si rezultat i rikuperimit ekonomik, si dhe dinamikat në çmimet e mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare u reflektuan në presione inflacioniste në Kosovë. Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2021, e shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit, ishte 3.4%, ku shpenzimet e transportit dhe çmimet e ushqimit kishin kontributin kryesor. Si rezultat i rritjes së lartë të aktivitetit ekonomik, sektori fiskal u karakterizua me rritje më të lartë të të hyrave buxhetore krahasuar me shpenzimet. Të hyrat buxhetore në vitin 2021 arritën vlerën neto prej 2.20 miliardë €, që paraqet një rritje vjetore prej 27.1%, përderisa shpenzimet buxhetore arritën vlerën prej 2.27 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 2.3 %¹.

BPV me çmime aktuale në vitin 2021 ishte 7,957.8 mil. €. Rritja reale në vitin 2021, në krahasim me vitin 2020 ishte 10.75%. BPV për kokë banori për vitin 2021 ishte 4,486 €.

Rritje reale për vitin 2021 kishte në këto aktivitete ekonomike: Hotele dhe restorante (34.7%), Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i automjeteve dhe motoçikletave (18.8%), Transport dhe magazinim (14.3%), Industri përpunuese (10.6%), Ndërtimtari (8.8%), Aktivitete administrative dhe mbështetëse (8.5%), Art, zbavitje dhe rekreacion (8.0%), Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike (6.7%), Edukim (6.6%), Aktivitete financiare dhe të sigurimit (6.2%), Furnizim me ujë (6.1%), Informim dhe komunikim (4.3%), Industri nxjerrëse (4.3%), Shërbime të tjera (3.6%), Afarizëm me pasuri të patundshme (2.5%), Shëndetësi dhe aktivitete të punës sociale (1.1%).

Ndërsa, rënie kishte në këto aktivitete: Administrim publik dhe i mbrojtjes, sigurim i detyrueshëm social (0.9%), Furnizim me energji elektrike dhe me gaz (2.1%), Bujqësi, gjueti, pylltaria dhe peshkim (2.5%).

Ndërkaq, rritje reale sipas komponentëve kryesorë të BPV-së me qasjen e shpenzimeve për vitin 2021 ishte tek: Eksporti i shërbimeve (88.8%), Eksporti i mallrave (51.6%), Importi i shërbimeve (44.3%), Importi i mallrave (28.8%), Formimi i bruto kapitalit (10.7%), Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (9.0%) dhe Shpenzimet e konsumit final (7.5%).

¹ BQK-Raporti Vjetor 2021


Tabela 1: Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale (në '000 €)

Aktiviteti	2017	2018	2019	2020	2021
A Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi	470,932	435,728	510,773	498,526	550,948
B Industria nxjerrëse	140,949	145,613	141,292	134,574	148,345
C Industria përpunuese	812,663	875,803	907,614	904,149	1,025,892
D Furnizimi me energji elektrike, me gaz	230,777	233,085	238,927	264,917	288,349
E Furnizimi me ujë	47,710	47,734	46,478	43,089	45,905
F Ndërtimtaria	517,679	559,677	577,092	519,420	675,879
G Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	797,251	833,724	900,211	867,439	1,084,213
H Transporti dhe magazinimi	283,367	298,045	309,376	262,999	341,917
I Hotelet dhe restorantet	116,839	129,050	146,705	110,855	163,847
J Informimi dhe komunikimi	113,331	124,441	130,784	134,577	150,124
K Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	196,229	237,273	272,558	277,337	294,751
L Afarizmi me pasuri të patundshme	456,679	474,820	490,441	493,438	512,555
M Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	96,606	97,762	99,929	107,358	113,918
N Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	45,070	49,338	52,125	49,589	54,486
O Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	355,515	386,556	419,183	444,284	436,988
P Edukimi	244,820	254,655	258,019	257,380	270,776
Q Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	129,496	143,698	154,599	180,459	184,884
R Art, zbavitje dhe rekreacion	27,157	28,855	17,284	13,228	14,228
S Shërbime tjera	22,904	23,935	25,245	26,905	27,760
T Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës	-	-	-	-	-
BVSH me çmime bazë	5,105,974	5,379,793	5,698,635	5,590,522	6,385,766
Tatimet në produkte	1,300,192	1,341,373	1,419,039	1,278,134	1,654,901
Subvencionet në produkte	(49,710)	(49,644)	(61,502)	(97,055)	(82,791)
Bruto Produkti Vendor	6,356,456	6,671,522	7,056,172	6,771,601	7,957,876

Burimi: ASK - Bruto Produkti Vendor 2017-2021

Bazuar në publikimin e përgatitur nga ASK "Bruto produkti vendor sipas aktiviteteve ekonomike 2008 – 2021", vërejmë se pjesëmarrja më e madhe e bujqësisë në Bruto Produktin Vendor ishte në vitin 2010 (9.5%), pasuar nga viti 2013 që ishte 8.4%, ndërsa pjesëmarrje më e ulët paraqitet në vitin 2018 me 6.5%. Bazuar në të dhënat e shfaqura në tabelë rrjedh se në vitin 2021 kjo pjesëmarrje ishte 6.9%.

Figura 1: Pjesëmarrja e bujqësisë në Bruto Produktin Vendor 2010-2021, (në %)



Burimi: ASK - Bruto Produkti Vendor 2017-2021

1.1 Niveli i zhvillimit socio-ekonomik

Duke pasur parasysh rritjen e kërkesës globale për ushqim, bujqësia paraqet një sektor shumë të rëndësishëm strategjik të ekonomisë së Kosovës që kontribuon në BPV me pjesëmarrje prej 6.9%. Përkundër rëndësisë së madhe që ka zhvillimi i bujqësisë për sigurimin e ushqimit në vendin tonë dhe zhvillimin e zonave rurale, për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori paraqiten pengesa të shumta që ndër të tjera mund të numërohen: infrastrukturë jo e zhvilluar, qasje e pamjaftueshme në tregje, aplikimi jo i mjaftueshëm i teknologjisë dhe cilësia e arsimit dhe shërbimit social. Niveli i zhvillimit rural është procesi i përmirësimit të cilësisë së jetës dhe mirëqenies ekonomike të njerëzve që jetojnë në zonat rurale, përmes shfrytëzimit të burimeve natyrore, si bujqësia dhe pylltaria si dhe aktivitetet tjera. Bujqësia e Kosovës karakterizohet me ferma me madhësi mesatare të vogla, ku rreth 90% të fermave kanë sipërfaqe më të vogël se 5 ha, faktor kyç që po ndikon drejtpërdrejtë në prodhimtari të ulët dhe rritjen e kostos së prodhimit. Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2021 ishte 420,327 ha. Sipas kategorive të shfrytëzimit, Toka e punueshme - ara, përfshirë këtu edhe perimet në fushë të hapur dhe perime në serra ka pjesëmarrje prej (44.8%), Plantacionet e pemëve 2.4%, Vreshta 0.8%, livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët) 51.7% dhe kopshtet 0.3%.

MBPZHR synon një përafrim gradual të politikave tona bujqësore me Politikën e Përbashkëta Bujqësore të BE-së, përmes hartimit të politikave bujqësore siç është Programi vjetor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në të cilin janë caktuar objektivat dhe përparësitë për bujqësi dhe zhvillim rural. Në vitin 2021 totali i mbështetjes përmes pagesave direkte ishte 28.9 mil € dhe u mbështetën gjithsej 27 sektorë. Në vitin 2021 në kuadër të PPD-së aplikuan gjithsej 25,742 fermerë, prej të cilëve përfitues u shpallën 24,958 (97%), ndërsa 3% e aplikuesve u refuzuan për mosplotësim të kriterëve apo mungesë të dokumenteve. Pjesë e programit të pagesave direkte kanë qenë sektorët: drithërat, bimët industriale, vreshtat dhe pemishtet ekzistuese,

verërat, mjedra, fidanet, perimet, bimët mjekuese aromatike, blegtoria, therjet e raportuara të gjedhit, akuakultura, primi i sigurimit bujqësor dhe viqa për majmëri.

Ndërsa sa i përket Programit për Zhvillim Rural 2020-2021, janë autorizuar gjithsej 304 projekte në shumë totale prej 9.75 mil. €.

Bujqësia vazhdon të ketë qasje të ulët në financimin e përgjithshëm bankar me vetëm 2.1% për vitin 2021 (0.1 pikë përqindje më e ulët se viti paraprak) pra, sektor që më së paku është kredituar nga institucionet financiare në Kosovë. Te Institucionet Mikrofinanciare (IMF) gjendja është më ndryshe, pjesëmarrja e agrokredive është 19.5% për vitin 2021.

Për ruajtjen e shëndetit të njeriut dhe të kafshëve Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës si autoritet me i lartë për Ushqim dhe Veterinari ka kryer aktivitetet që ndikojnë në mbrojtjen, në jetën dhe shëndetin e njerëzve duke siguruar nivel të lartë të sigurisë së ushqimit, përfshirë edhe ushqimin e kafshëve, shëndetin e kafshëve, shëndetin e bimëve, përkujdesjen ndaj kafshëve si edhe cilësinë e ushqimit me prejardhje bimore dhe shtazore.

Sa i përket shkëmbimit tregtar të Kosovës me vendet tjera në vitin 2021 vlera e eksportit të produkteve bujqësore ishte 92.6 mil. €, që del të jetë një rritje prej 18.7% në krahasim me vitin 2020, ndërsa vlera e importit të produkteve bujqësore arriti në 965.6 mil. €, që shfaqet rritje për 26.2% në krahasim me vitin 2020.

1.2 Puna dhe punësimi

Sipas rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore, dy të tretat e popullsisë në Kosovë janë popullsi në moshë pune². Në kuadër të popullsisë në moshë të punës, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 39.5%.

Shkalla e punësimit për tremujorin e parë (TM1) 2021 është 29.3%. Punësimi me i lartë ishte te meshkujt (42.8%), ndërsa punësimi te femrat ishte 15.9%. Femrat janë të punësuar, kryesisht në sektorët e arsimit, tregtisë dhe kujdesit shëndetësor, 53.0% e tyre, ndërsa meshkujt janë kryesisht të punësuar në sektorët e ndërtimitarisë, tregtisë dhe prodhimit, 43.1% e tyre.

Sektorët ekonomik që prijnë me punësim, vazhdojnë të jenë: tregtia me 16.8%; prodhimi me 12.4%; arsimit me 11.1%; dhe ndërtimtaria me 9.4%. Ndërsa, sektorët e tjerë marrin pjesë me përqindje më të vogël në punësim.

Sa i përket të punësuarve me kontrata, del se 44.0% e personave të punësuar kanë kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, ndërkohë që 56.0% kanë kontratë të përkohshme.

² Popullsia në moshë pune (mosha 15 deri 64 vjeç), që angazhohet në mënyrë aktive në tregun e punës (të punësuar apo të papunësuar).

Sipas rezultateve të AFP-së, në TM1 2021, shkalla e papunësisë është 25.8%. Papunësia më e theksuar është te femrat me 29.7%, krahasuar me meshkujt, 24.2%. Shkalla më e theksuar e papunësisë është te grupmoshat 15-24 vjeçare me 48.6%.

Sipas rezultateve të AFP-së, në TM1 2021, fuqia joaktive është mjaft e lartë (60.5%), me fokus të veçantë te femrat me 77.3 %, krahasuar me meshkujt, 43.5%.


Tabela 2: Indikatorët kryesor të tregut të punës sipas variablave, 2017-2021 (%)

Indikatorët kryesorë të tregut të punës sipas variablave	TM1 '17	TM1 '18	TM1 '19	TM1 '20	TM1 '21
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (15-64 vjeç)	41.7	39.2	38.7	38.8	39.5
Raporti punësim ndaj popullsisë - shkalla e punësimit (15-64 vjeç)	28.9	28.8	28.2	29.1	29.3
Shkalla e papunësisë (15-64 vjeç)	30.5	26.5	26.9	25	25.8
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	50.5	54	50.6	46.4	48.6
Pjesëmarrja e të rinjve NEET në popullsinë e re (15-24 vjeç)	27.8	31.1	29	29	29.8
Pjesëmarrja e punësimit të paqëndrueshëm në punësimin e përgjithshëm (15-64 vjeç)	24.1	19.8	16.7	16.5	14.3

Burimi: ASK - Anketa e Fuqisë Punëtore, TM1 '17, TM1 '18, TM1 '19, TM1 '20, TM1 '21

Kur analizojmë të dhënat e indikatorëve kryesor të tregut të punës për tre mujorin e parë vërehet se shkalla e punësimit më e lartë ishte në TM1 të vitit 2021 dhe 2022 (29.1% respektivisht 29.3%). Sa i përket indikatorit tjetër, që ka të bëjë me shkallën e papunësisë del se në TM1 të vitit 2021 ishte 25.8%, ndërsa shkalla më e ulët e papunësisë është shënuar në tremujorin e parë të vitit 2020, e që ishte 25.0%. Shkalla e papunësisë në dy vitet e fundit ka qenë më e ulët krahasuar me TM1 të viteve tjera.

Figura 2: Indikatorët kryesor të tregut të punës, 2017-2021 (%)



Burimi: ASK - Anketa e Fuqisë Punëtore, TM1 '17, TM1 '18, TM1 '19, TM1 '20, TM1 '21

1.3 Llogaritë ekonomike në bujqësi

Publikimi përfshinë të dhënat e Llogarive Ekonomike në Bujqësi për vitin 2021. Burimet kryesore të të dhënave për përpilimin e Llogarive Ekonomike për Bujqësi janë dy anketat e kryera në ASK: Anketa e Ekonomive Bujqësore dhe Statistikat e Çmimeve në Bujqësi. Burime tjera të të dhënave janë: të dhënat administrative nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës. Në mungesë të burimeve të të dhënave për artikuj të caktuar, janë përdorur vlerësimet e ekspertëve.


1.3.1 Prodhimet bujqësore

Në vitin 2021, prodhimet bimore kanë shënuar rritje për 11.5%, krahasuar me vitin 2020. Rritja në vlerën e prodhimeve bimore mund të shpjegohet kryesisht me rritjen e vlerës së prodhimit të drithërave, bimëve foragjere, perimeve dhe prodhimeve të kopshtit, pemëve si dhe patates. Kurse, prodhimet blegtorale kanë shënuar rënie për 8.4% në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020. Kjo mund të shpjegohet me rënien e vlerës së produkteve blegtorale.

Ndërkaq, gjithsej prodhimet bimore dhe blegtorale kanë shënuar rritje për 3.8% në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020. Konsumi i ndërmjetëm gjithsej është vlerësuar rreth 339.7 mil. € në vitin 2021, që paraqet një rritje prej 7.4%, në krahasim me vitin 2020.

Figura në vijim paraqet vlerën e prodhimeve bimore dhe blegtorale me çmime aktuale për periudhën 2017-2021, ku vërehet se vlera e prodhimeve bimore është rritur vazhdimisht nga viti 2018. Viti 2021 paraqitet me vlerën më të lartë të prodhimeve bimore për periudhën në fjalë. Prodhimtaria blegtorale ka pasur një trend më ndryshe nga prodhimtaria bimore duke u shfaqur me rritje dhe rënie ndër vite krahasuar me prodhimitarinë bimore.


Figura 3: Prodhimet bimore dhe blegtorale në mil. €, 2017-2021



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '17,'18,'19, '20, '21, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Në figurën në vijim është paraqitur pjesëmarrja e kulturave bujqësore në gjithsej prodhimin bimor për vitin 2021, ku bimët foragjere prijnë me përqindjen më të lartë, pasuar nga drithërat, perimet, pemët dhe të tjera.


Figura 4: Pjesëmarrja e kulturave bujqësore në gjithsej prodhimin bimor, 2021



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2021, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Në figurën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat lidhur me shitjen nga kategoritë e ndryshme blegtorale duke përmendur mishin nga gjedhet, derrat, delet, dhitë, shpezët dhe kafshët tjera si dhe të dhënat për produktet blegtorale siç janë: qumështi dhe vezët dhe të tjera me vlerë shumë më të vogël. Krahasuar me vitin 2020, në vitin 2021 është zvogëluar shitja e mishit të gjedheve, deleve e dhive dhe shpezëve, ndërsa është rritur për derra. Sa i përket produkteve blegtorale, krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2021 prodhimi i vezëve është rritur, i qumështit është zvogëluar ndërsa për produkte të tjera nuk ka pasur ndryshim.

Figura 5: Shitja e mishit sipas kategorisë (majtas) dhe e produkteve blegtorale (djathtas), 2021




Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2021, përpunuar nga DAESB - MBPZHR

Gjatë analizimit të të dhënave për prodhimet bimore për periudhën 2017-2021, rrjedh se ka pasur lëvizje të lehta në vlerë të tyre gjatë këtyre viteve. Mund të thuhet se në vitin 2021

shumica e kategorive shënuan rritje përveç prodhimeve tjera bimore të cilat krahasuar me vitin paraprak, pësuan rënie për 1%. Drithërat në vitin 2021, krahasim me vitin 2020 shënuan rritje të vlerës për 10%, bimët foragjere për 13%, perimet dhe prodhimet e kopshtit 13%, patatet 13% dhe pemët 7%.


Figura 6: Prodhimet bimore në mil. €, 2017-2021



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '17,'18,'19,'20,'21, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Vlera e prodhimeve blegtorale në vitin 2021 në shumicën e kategorive, ka pasur rënie krahasuar me vitin 2020, përveç kategorisë së derrave që ka shënuar rritje për 2.7%.


Figura 7: Blegtoria në mil. €, 2017-2021



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '17,'18,'19,'20,'21 përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Në figurën në vijim është paraqitur vlera e produkteve blegtorale me çmime aktuale. Krahasuar me vitin paraprak, në vitin 2021, qumështi ka pasur rënie në vlerë për 4.5%, ndërsa vezët shënuan rritje për 4.3%.

Figura 8: Produktet blegtorale në mil. €, 2017-2021



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '17/'18,'19/'20/'21, përpunuar nga DAESB - MBPZhR


1.3.2 Të ardhurat sipërmarrëse

Në figurën në vijim janë të paraqitura të dhënat për prodhimet e industrisë bujqësore, konsumin e ndërmjetëm dhe vlerën e shtuar bruto për periudhën 2017-2021 .

Vlera e prodhimit të industrisë bujqësore në vitin 2021 ishte më e lartë gjatë periudhës në fjalë, e në krahasim me vitin paraprak shënoi rritje për 3.4%, përderisa konsumi i ndërmjetëm shënoi rënie për 3.5%.

Vlera e shtuar bruto e cila paraqet ndryshimin në mes të vlerës së prodhimit të industrisë bujqësore dhe vlerës së konsumit të ndërmjetëm, në vitin 2021 kishte vlerën 453 mil. €, ku krahasuar me vitin paraprak shënoi rënie për 9.4%.

Figura 9: Prodhimi bujqësor, konsumi i ndërmjetëm dhe bruto vlera e shtuar në mil. €, 2017-2021




Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '17/'18,'19/'20/'21 përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Figura në vijim përmban të dhëna për vlerën e shtuar bruto, vlerën e shtuar neto si dhe të ardhurat sipërmarrëse. Vlera e shtuar neto paraqet prodhimin e përgjithshëm të industrisë

bujqësore minus shpenzimet e konsumit të ndërmjetëm dhe konsumi i kapitalit fiks. Të ardhurat sipërmarrëse paraqesin shumën e vlerës së shtuar neto, plus subvencionet në prodhim, minus kompensimi për punëtorët, taksat mbi prodhimin, qiratë dhe interesi i kredive.

Vlera e të ardhurave në bujqësi në vitin 2021, të ardhurat sipërmarrëse ishin -13.5% më të ulëta se sa në vitin paraprak. Vlera e shtuar bruto dhe vlera e shtuar neto shënuan rënie për 9.4% dhe 13.5% respektivisht.

Figura 10: Të hyrat e agreguara në bujqësi në mil. €, 2017-2021




Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi '17,'18,'19,'20,'21 përpunuar nga DAESB - MBPZhR

1.3.3 Inputet në bujqësi

Në figurën në vijim janë paraqitur të dhëna lidhur me strukturën e konsumit të ndërmjetëm bujqësor për vitin 2021, shprehur në përqindje. Pjesëmarrje më të madhe në këtë strukturë paraqet kategoria e ushqimit të kafshëve e cila përfshinë materialin ushqyes të cilin fermeri e blen nga fermerët tjerë apo lëndën e parë dhe ushqimin për kafshë që fermeri e prodhon në fermë, kontribuon me 51%, që paraqet gjysmën e konsumit të ndërmjetëm. Plehurat, përmirësuesit e tokës kanë pjesëmarrje prej 12%, shërbimet bujqësore 7%, mallrat dhe shërbimet tjera 9%, shpenzimet e energjisë 8%, farërat dhe materiali mbëltues 4%, shpenzimet veterinare 3%, mirëmbajtja e materialeve 3%, ndërsa produktet për mbrojtjen e bimëve, pesticidet dhe mirëmbajtja e ndërtesave janë me pjesëmarrje më të ulët.


Figura 11: Struktura e konsumit të ndërmjetëm, 2021



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2021, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

Sa i përket inputeve në bujqësi, sipas figurës së mëposhtme, në vitin 2021, konsumi i ndërmjetëm ka pjesëmarrje 70.8% pasuar nga konsumi i kapitalit fiks me pjesëmarrje 26.6%, kompensimi i punëtorëve 1.2%, qiratë dhe shpenzimet tjera për shfrytëzimin e tokës dhe ndërtesave 1% si dhe interesi i paguar 0.5%.

Figura 12: Inputet në bujqësi sipas kategorive, 2021



Burimi: ASK - Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2021, përpunuar nga DAESB - MBPZhR

1.4 Çmimet e inputeve dhe prodhimeve bujqësore

1.4.1 Çmimet e inputeve bujqësore

Indekset e çmimeve të inputeve bujqësore matin ndryshimet e çmimeve në kostot aktuale të prodhimit brenda ekonomisë. Përkatësisht, një indeks i çmimeve të inputeve matë ndryshimet në koston e shportës së blerjeve që hyjnë si inpute në procesin e prodhimit, por këtu nuk hyjnë inputet primare si toka, puna dhe kapitali. Tabela e mëposhtme e indeksit vjetor të çmimeve të inputeve bujqësore përfshinë të dhëna për indeksin e çmimeve në Kosovë për periudhën 2015-2021. Çmimet e inputeve bujqësore janë mbledhur nga ASK në barnatore bujqësore, barnatore veterinerë, nga kompanitë, tregjet dhe vendet tjera ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion. Disa çmime të inputeve bujqësore janë marrë nga çmimet e konsumit nga ASK. Produktet që përbëjnë bazën e indeksit të çmimeve të inputeve marrin pjesë në njërin nga dy grupet kryesore: Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (konsumi i ndërmjetëm) si dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore (formimi i kapitalit). Të gjitha kategoritë e paraqitura në tabelën e mëposhtme kanë shënuar rritje të çmimit në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, e që më së shumti rritje në çmim kishin plehrat e përbëra (30.1%), pasuar nga plehrat e thjeshta (29.4%), që të dyja nënkategori të kategorisë “Plehrat dhe përmirësuesit e tokës”. Gjithashtu rritje të theksuar kishin lëndët djegëse (19.1%) në kuadër të kategorisë “Energjia; Lubrifikantët” dhe lëndët e thjeshta të ushqimit (9.7%) e lëndët e përbëra të ushqimit (8.6%) në kuadër të kategorisë “Lëndë për ushqim kafshësh”. Rritje të ulët, nën 2% kishin: Mirëmbajtja e materialeve (0.3%), Energjia elektrike (0.7%), Farat dhe materiali mbëltues (1.0%) si dhe inputet e paraqitura si “Tjera” me 1.6%.

Indeksi vjetor i inputeve në vitin 2021 ka shënuar rritje për 11.5% për Input 1, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, ndërsa indeksi për Input 2 kishte rritje për 5.0%. Indeksi i çmimeve të inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) krahasuar me vitin e 2020, në vitin 2021 është rritur për 8.3%.

Figura 13: Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2015-2021, (2015=100)



Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi 2015-2021, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tabela 3: Indeksi vjetor i çmimeve të inputeve bujqësore 2015-2021, (2015=100)

Përshkrimi	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020 në %
Mallrat dhe shërbimet e konsumuara aktualisht në bujqësi (Input 1)	100.0	98.1	95.4	94.0	95.8	92.5	103.1	11.5
Farërat dhe materiali mbëltues	100.0	98.9	87.2	78.1	83.7	82.7	83.5	1.0
Energji; lubrifikant	100.0	93.7	100.9	106.5	106.3	92.0	105.2	14.4
-Energjia elektrike	100.0	98.8	106.1	97.6	95.7	95.7	96.3	0.7
-Lëndë djegëse	100.0	92.3	100.2	109.9	110.2	90.5	107.8	19.1
-Lubrifikant	100.0	93.8	92.7	92.7	92.8	99.0	102.1	3.1
Plehrat dhe përmirësuesit e tokës	100.0	97.6	89.5	85.9	88.5	87.3	113.4	29.9
-Plehrat e thjeshtë	100.0	94.0	87.7	83.5	85.1	84.2	109.0	29.4
-Plehrat e përbëra	100.0	99.7	90.7	87.3	90.5	89.2	116.1	30.1
Produktet për mbrojtjen e bimëve dhe pesticidet	100.0	104.2	103.8	105.4	106.3	103.5	105.9	2.4
Shpenzimet veterinare	100.0	98.7	98.0	97.5	99.3	98.0	100.7	2.8
Lëndë për ushqim kafshësh	100.0	109.5	103.6	103.2	107.6	110.1	120.5	9.4
-Lëndë të thjeshta ushqimi	100.0	111.5	103.4	103.0	107.9	108.9	119.4	9.7
-Lëndë të përbëra ushqimi	100.0	97.9	104.9	104.7	105.7	117.0	127.1	8.6
Mirëmbajtja e materialeve	100.0	100.1	99.9	99.8	99.5	99.2	99.5	0.3
Mirëmbajtja e ndërtesave	100.0	98.2	98.8	98.6	99.3	101.5	104.8	3.2
Mallrat dhe shërbimet tjera	100.0	99.9	100.8	100.9	101.4	101.3	105.0	3.6
Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore (Input 2)	100.0	102.5	103.5	102.6	109.9	111.2	116.8	5.0
Traktor	100.0	106.9	107.7	105.2	119.0	120.5	130.6	8.3
Tjera	100.0	98.5	99.8	100.3	101.8	103.0	104.6	1.6
Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)	100.0	100.0	99.0	97.8	102.1	100.8	109.2	8.3

Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi 2015-2021, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tabela në vijim përmban të dhëna lidhur me çmimet vjetore të energjisë elektrike dhe naftës për periudhën 2016-2021. Sa i përket çmimit të energjisë elektrike, për dallim nga vitet 2019 dhe 2020 që çmimi ka qenë i njëjtë, në vitin 2021 ky çmim ka shënuar rritje për 1.8%, ndërsa çmimi i naftës pas rënies që pësoi në vitin 2020, në vitin 2021 ka shënuar rritje për 19.0%.

Tabela 4: Çmimet vjetore për energji elektrike dhe naftë në €, 2016-2021

Energjia dhe Lubrifikantët	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020 në %
Energjia elektrike çmimi për 100 kwh	6.1	6.4	5.8	5.6	5.6	5.7	1.8
Nafta - çmimi për 100 litra	93.5	102.1	112.7	113.0	92.6	110.2	19.0

Burimi: ASK - Indeksi i çmimeve të inputeve dhe çmimet në bujqësi 2016-2021

1.4.2 Çmimet e prodhimeve bujqësore

Zhvillimin e sektorit të bujqësisë, MBPZhR vazhdon ta përkrah përmes granteve dhe subvencioneve, duke ndikuar në rritjen e prodhimit dhe kualitetit si dhe reduktimin e importit, i cili ndikon direkt në çmimet e prodhimeve vendore.

Përkundër përkrahjes së vazhdueshme, prodhimtaria vendore në bujqësi nuk po arrin t'i plotësoj gjitha nevojat për konsum. Nisur nga ky fakt, për plotësimin e nevojave për konsum pjesa më e madhe e prodhimeve importohen, edhe pse çdo vit eksporti po shënon rritje, sasia e lartë e importit vazhdon të ndikoj në thellimin e mëtutjeshëm të bilancit negativ tregtar.

Me qëllim që të hartojmë analiza, programe dhe strategji të ndryshme për sektorin e bujqësisë, MBPZhR ka të angazhuar kompaninë "Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime - SIT" për mbledhjen e çmimeve të prodhimeve bujqësore për vite me radhë, ku merren çmimet e produkteve bujqësore nga 7 regjione dhe të njëjtat prezantohen në mesatare vjetore në nivel vendi.

Në vazhdim janë paraqitur çmimet e disa prodhimeve bujqësore të prodhuesit-fermerit, çmimet e konsumit me shumicë dhe pakicë, çmimet e importit si dhe vlera për njësi e produkteve të importuara për periudhën 2018-2021.

Çmimet e fermës të prodhimeve bujqësore

Në tabelën në vijim, janë paraqitur çmimet vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë. Bazuar në të dhënat nga tabela, çmimet në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, kanë pasur mjaft luhajtje. Ulje të dukshme të çmimit kanë pasur: rrushi i tryezës, mjalta, vezët, kungulli dhe misri ndërsa ngritje më të madhe në çmime nga prodhimet e listuara në tabelë, kanë shënuar: mjedra, trangulli, domatja, spinaqi, molla, etj.

Tabela 5: Çmimet mesatare vjetore të prodhimeve bujqësore në fermë, €/kg

Prodhime	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020 (%)
Grurë	0.23	0.18	0.19	0.20	5
Misër	0.26	0.22	0.25	0.24	-4
Domate	0.62	0.57	0.33	0.52	58
Fasule	2.27	2.03	2.31	2.38	3
Kungull *	0.90	0.81	0.17	0.16	-6
Kungull misiri *	0.84	0.81	0.22	0.29	32
Lakër	0.40	0.19	0.23	0.31	35
Patate	0.33	0.27	0.28	0.42	50
Qepë	0.37	0.46	0.37	0.41	11
Shalqi	0.23	0.19	0.18	0.21	17
Spec	0.91	0.76	0.54	0.62	15
Spinaq	0.94	0.94	0.76	1.16	53
Trangull	0.46	0.48	0.31	0.54	74
Arrë	2.72	2.16	2.06	2.13	3
Dardhë	0.79	0.81	0.72	0.91	26
Dredhëz	1.03	1.12	1.16	1.22	5
Kumbull	0.73	0.51	0.71	0.81	14
Mjedër	1.67	1.77	1.73	3.50	102
Mollë	0.40	0.39	0.31	0.44	42
Rrush tryeze	0.78	0.68	0.63	0.53	-16
Mëzet dhe Mëshqerra	2.14	1.97	2.21	2.53	14
Pulë ferme	1.80	1.68	1.72	1.89	10
Qumësht	0.25	0.21	0.23	0.31	35
Vezë **	2.10	2.07	2.26	2.12	-6
Mjaltë	9.20	11.85	13.60	11.50	-15

Burimi: DAESB - MBPZhR; *Çmimi për kungull dhe kungull misiri nga viti 2020 paraqitet për kg, ndërsa në vitet paraprake çmimi ka qenë për copë; ** njësia 30 copë; Çmimi për misër është për misër kokërr.

Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore

Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore janë prezantuar përmes çmimeve vjetore të tregut me shumicë dhe pakicë për vitet 2018-2021.

Bazuar në çmimet vjetore të tregut me shumicë të cilat janë të paraqitura në tabelën vijuese për disa prodhime bujqësore, vërejmë se gjatë vitit 2021 ka pasur lëvizje të çmimeve krahasuar me vitin 2020, ngritje në çmime kanë shënuar: mjedra, kumbulla, mjalta, qumështi dhe trangulli, ndërsa prodhimet që kanë shënuar rënie në çmim në krahasim me vitin paraprak janë: shalqiri, misri, kungulli, qepa etj.

Tabela 6: Çmimet mesatare vjetore të tregut me shumicë, €/kg

Prodhime	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020 (%)
Grurë	0.24	0.23	0.33	0.31	-6
Misër	0.39	0.48	0.53	0.39	-26
Domate	0.67	0.66	0.65	0.78	20
Fasule	2.42	2.35	2.44	2.50	2
Kungull *	0.96	0.95	0.31	0.27	-13
Kungull misiri *	0.96	1.15	0.38	0.46	21
Lakër	0.43	0.46	0.39	0.47	21
Patate	0.35	0.39	0.39	0.40	3
Qepë	0.38	0.53	0.54	0.48	-11
Shalqi	0.34	0.23	0.37	0.24	-35
Spec	0.97	0.92	0.97	0.94	-3
Spinaq	1.02	1.01	0.95	0.94	-1
Trangull	0.49	0.55	0.57	0.75	32
Arrë	2.79	2.33	2.38	2.71	14
Dardhë	0.83	0.96	1.20	1.32	10
Dredhëz	1.64	1.33	1.82	1.67	-8
Kumbull	0.78	0.59	0.69	1.09	58
Mjedër	2.09	2.17	2.07	4.00	93
Mollë	0.44	0.49	0.64	0.73	14
Rrush tryeze	0.89	0.79	0.99	1.02	3
Mëzet dhe Mëshqerra	3.25	3.31	2.93	2.65	-10
Pulë ferme	1.91	1.93	1.91	2.08	9
Qumësht	0.45	0.43	0.29	0.42	45
Veze **	2.26	2.19	2.36	2.29	-3
Mjaltë	6.95	6.85	7.22	10.51	46

Burimi: DAESB – MBPZhR; *Çmimi për kungull dhe kungull misiri nga viti 2020 paraqitet për kg, ndërsa në vitet paraprake çmimi ka qenë për copë; ** njësia 30 copë; Çmimi për misër është për misër kokërr.

Lidhur me çmimet vjetore të tregut me pakicë vërehet që ka pas zvogëlim tek gjysma e prodhimeve bujqësore gjatë vitit 2021, dukshëm ka pas zvogëlim të çmimeve te: shalqiri, misri, kungulli, mëzet dhe mëshqerrat dhe qepa ndërsa mjedra, kumbulla, mjalta, trangulli dhe domatja kanë shënuar rritje të çmimeve.

Tabela 7: Çmimet mesatare vjetore të tregut me pakicë, €/kg

Prodhimi	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020 (%)
Grurë	0.28	0.36	0.38	0.36	-5
Misër	0.48	0.54	0.62	0.46	-26
Domate	0.84	0.80	0.77	0.94	22
Fasule	2.64	2.66	2.60	2.67	3
Kungull *	1.19	1.16	0.42	0.34	-19
Kungull misiri *	1.26	1.22	0.45	0.51	13
Lakër	0.59	0.55	0.47	0.55	17
Patate	0.43	0.50	0.48	0.49	2
Qepë	0.47	0.65	0.64	0.57	-11
Shalqi	0.40	0.30	0.45	0.28	-38
Spec	1.17	1.06	1.08	1.08	0
Spinaq	1.12	1.18	1.07	1.08	1
Trangull	0.61	0.67	0.65	0.86	32
Arrë	2.89	2.61	2.56	2.96	16
Dardhë	0.94	1.13	1.35	1.45	7
Dredhëz	1.89	1.49	1.97	1.87	-5
Kumbull	0.84	0.75	0.79	1.48	87
Mjedër	2.60	2.44	2.26	4.25	88
Mollë	0.53	0.60	0.74	0.84	14
Rrush tryeze	1.09	0.98	1.09	1.20	10
Mëzet dhe Mëshqerra	3.80	3.75	3.02	2.49	-18
Pulë ferme	2.37	2.33	2.13	2.38	12
Qumësht	0.49	0.51	0.48	0.49	2
Vezë **	2.45	2.50	2.61	2.57	-2
Mjaltë	7.50	7.40	7.50	10.77	44

Burimi: DAESB - MBPZhR; *Çmimi për kungull dhe kungull misiri nga viti 2020 paraqitet për kg, ndërsa në vitet paraprake çmimi ka qenë për copë; ** njësia 30 copë; Çmimi për misër është për misër kokërr.

Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore

Në Kosovë zakonisht jashtë sezonës së prodhimeve bujqësore vendore, në tregun tonë hasim në prodhime të importuara tek të cilat edhe çmimet ndryshojnë dukshëm.

Çmimet e shitjes me shumicë, në të shumtën e rasteve janë më të larta se çmimet e prodhimit vendor, kurse në rastin e çmimeve të importit, për prodhimet me pjesëmarrje të lartë të importeve, kjo rregull mund të mos vlejë sepse disa produkte kanë kosto të lartë të prodhimit në vend, dhe si rrjedhojë çmimet e prodhimit në fermë mund të jenë më të larta sesa ato të importit.

Në tabelën vijuese janë të paraqitura çmimet e importit të prodhimeve bujqësore, ku çmimet të cilat kanë pësuar rënie në raport me vitin paraprak janë: patatja, lakra, domatja, trangulli etj., ndërsa rritje më të dukshme në çmim kanë shënuar: rrush tryeze, pulë ferme, arra, fasulja, etj.

Tabela 8: Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore, €/kg

Prodhime	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020 (%)
Grurë	0.31	0.38	0.38	0.36	-5
Misër	0.33	0.53	0.45	0.43	-4
Domate	0.91	0.97	1.19	0.97	-18
Fasule	2.03	1.97	2.01	2.36	17
Kungull *	1.18	1.12	0.28	0.31	11
Kungull misiri *	1.50	0.90	0.46	0.43	-7
Lakër	0.39	0.56	0.64	0.52	-19
Patate	0.66	0.55	0.84	0.56	-33
Qepë	0.39	0.52	0.61	0.55	-10
Shalqi	0.96	1.61	0.85	0.79	-7
Spec	1.18	1.46	1.50	1.23	-18
Spinaq	1.15	1.49	1.19	1.21	2
Trangull	0.94	1.08	1.21	1.00	-17
Arrë	2.44	2.40	2.06	2.42	17
Dardhë	1.28	1.34	1.47	1.48	1
Dredhëz	2.96	2.69	2.94	2.63	-11
Kumbull	2.83	3.49	2.34	2.19	-6
Mjedër	-	1.70	-	-	
Mollë	0.83	0.78	0.82	0.77	-6
Rrush tryeze	2.45	2.66	1.97	2.78	41
Mëzet dhe Mëshqerra	2.90	3.05	2.87	2.98	4
Pulë ferme	2.60	2.35	2.21	2.72	23
Qumësht	-	-	-	-	
Vezë **	2.10	2.35	2.15	2.21	3
Mjaltë	8.60	7.85	8.60	7.54	-12

Burimi: DAESB – MBPZhR; *Çmimi për kungull dhe kungull misiri nga viti 2020 paraqitet për kg, ndërsa në vitet paraprake çmimi ka qenë për copë; ** njësia 30 copë; Çmimi për misër është për misër kokërr.

Tabela më poshtë paraqet vlerën për njësi të importit të prodhimeve bujqësore. Shumica e prodhimeve kanë shënuar ngritje të dukshme krahasuar me vitin 2020 si: mjedra, dredhëza, misri, lakra, etj. ndërsa zvogëlim çmimesh krahasuar me vitin paraprak paraqitet tek: speci, fasulja, dardha dhe arra, ndërsa prodhimet tjera kanë dallime më të ulëta.

Tabela 9: Vlera për njësi e prodhimeve bujqësore të importuara, €/kg

Prodhimi	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020 (%)
Grurë	0.18	0.20	0.19	0.22	16
Misër	0.16	0.17	0.16	0.22	38
Domate	0.36	0.38	0.35	0.35	0
Fasule	0.86	0.88	0.93	0.86	-8
Kungull dhe Kungull misiri *	0.47	0.47	0.52	0.56	8
Lakër	0.18	0.26	0.16	0.22	38
Patate	0.27	0.30	0.20	0.23	15
Qepë	0.38	0.55	0.47	0.47	0
Shalqi	0.17	0.16	0.15	0.15	0
Spec	0.46	0.54	0.46	0.42	-9
Spinaq	0.41	0.48	0.50	0.57	14
Trangull	0.35	0.35	0.29	0.38	31
Arrë	1.85	1.42	1.52	1.45	-5
Dardhë	0.68	0.68	0.67	0.62	-7
Dredhëz	0.72	0.68	0.69	0.93	35
Kumbull	0.37	0.33	0.31	0.39	26
Mjedër	1.49	0.51	2.21	3.55	61
Mollë	0.38	0.35	0.32	0.30	-6
Rrush tryeze	0.49	0.50	0.46	0.46	0
Mëzet dhe Mëshqerra	1.24	1.33	1.32	1.37	4
Pulë ferme	2.00	1.99	1.99	1.99	0
Qumësht	0.54	0.57	0.55	0.55	0
Vezë **	3.11	-	1.11	1.35	22
Mjaltë	5.20	4.83	4.98	5.06	2

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB - MBPZhr; * Në të dhënat doganore, kungull dhe kungull misiri janë të përfshira në një kod doganor; ** njësia 30 copë

Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e regjionit dhe BE-së

Krahasimin e çmimeve të disa vende të Bashkimit Evropian dhe Kosovës, mund ta shohim në tabelën vijuese, ku janë të paraqitura çmimet e prodhimeve bujqësore për disa kultura siç janë: gruri, misri, lakra, patatja, molla, vezët dhe mjalti.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, mund të themi se Kosova ka çmime relativisht të larta në krahasim me vendet e BE-së. Prodhimet tek të cilat Kosova ka çmime më të larta janë: mjalta, misri dhe patatja, kurse çmimi i mollës dhe vezëve është më i ulëti. Gruri dhe lakra kanë çmime të përafërta në raport me vendet tjera.

Tabela 10: Çmimet e disa prodhimeve në Kosovë dhe disa vende të BE-së në vitin 2021, €/kg

Shtetet	Grurë	Misër *	Lakër	Patate	Mollë	Vezë **	Mjaltë
Bullgaria	0.20	0.21	0.24	0.20	0.28	7.06	3.26
Çekia	0.20	0.19	0.27	0.16	0.58	7.22	-
Greqia	0.23	0.28	0.40	0.49	0.67	19.10	5.82
Hungaria	0.20	0.20	0.33	0.26	0.36	5.82	3.48
Austria	0.17	0.20	-	0.18	0.90	15.01	10.60
Rumania	0.20	0.21	0.46	0.33	0.62	7.52	3.66
Kosova	0.20	0.24	0.31	0.42	0.44	7.07	11.50

Burimi: Eurostat; DAESB - MBPZhR, * misër kokërr, ** njësia për 100 copë

Importi në Kosovë vazhdon të jetë shumë i lartë, ndryshimet e çmimeve në tregun ndërkombëtar dhe në vendet e regjionit kanë ndikim në çmimet e tregut në vendin tonë dhe duke marrë parasysh të ardhurat e ulëta, rritja e çmimeve sidomos të prodhimeve bazike, ndikon negativisht në standardin jetësor të popullatës së Kosovës.

Si përfundim, duke parë çmimet e paraqitura më lartë, mund të themi se Kosova si treg i vogël me prodhim të ulët vendor është shumë e varur nga importi e si rezultat edhe çmimet diktohen nga importi dhe vazhdojnë të mbesin të larta duke pasur parasysh standardin e jetesës.

1.5 Privatizimi i tokave bujqësore

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur publik dhe ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. AKP bënë privatizimin e pronës shoqërore në territorin e Kosovës dhe ky mandat rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës. Duke u bazuar në objektivat e planit të punës për vitin 2021, AKP ka vazhduar me procesin e privatizimit të tokave dhe pronave shoqërore.

Nëse bëjmë krahasimin e të dhënave të tokave të privatizuara në vitin 2021, vërehet se kishte një rritje simbolike të shitjeve për vetëm 0.04% në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. Pjesëmarrje më të madhe në gjithsej totalin e shitjes së tokave bujqësore apo të privatizuara ka pasur në regjionin e Pejës 37.9%, pasuar nga Prizreni 21.6%, Mitrovica 20.6%, Gjilani 10.6% dhe Prishtina me 9.3%.

Gjithsej sipërfaqja e shitur e tokave bujqësore deri në vitin 2021 ishte 30,823 ha. Sipërfaqja më e madhe e tokave të shitura ishte në regjionin e Pejës (11,687 ha), me pjesëmarrje në tokat e përgjithshme të privatizuara prej 37.9%, Prizreni (6,672 ha) 21.6%, Mitrovica (6,349 ha) apo 20.6%, Gjilani (3,263 ha) 10.6% dhe Prishtina (2,852 ha) që kishte pjesëmarrje prej 9.3%.

Tabela 11: Shitjet e tokave bujqësore në Kosovë, sipas regjioneve, 2005-2021


Regjioni	Sipërfaqja në ari	Sipërfaqja në ha	Sipërfaqet e shitura (%)	Çmimi mesatar i shitjes €/ari	Çmimi mesatar i shitjes €/ha	Vlera totale e shitjeve €/ha	Vlera e shitjes (%)
Prishtinë	285,159	2,852	9.3	251	25,055	71,447,693	45%
Pejë	1,168,713	11,687	37.9	25	2,519	29,440,573	18%
Prizren	667,159	6,672	21.6	47	4,706	31,393,749	20%
Gjilan	326,317	3,263	10.6	55	5,539	18,074,990	11%
Mitrovicë	634,911	6,349	20.6	15	1,527	9,695,730	6%
Gjithsej	3,082,259	30,823	100.0	52	5,193	160,052,736	100%

Burimi: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Gjithsej vlera e shitjeve apo privatizimi i tokave bujqësore përmes procedurave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në periudhën 2005-2021 ishte 160,052,736 €.

Çmimi më i lartë mesatar i shitjes së një hektari të tokës bujqësore ishte në regjionin e Prishtinës 25,055 €, ndërsa regjionet tjera kanë pasur çmimin e shitjes së një hektari tokë shumë më të ulët. Rjedhimisht edhe në vlerën totale të shitjeve, regjioni i Prishtinës ka qenë prijësi që kishte vlerë 71,447,693 €/ha, duke vijuar nga regjionet tjera që kishin vlerë shumë më të ulët.


Figura 14: Çmimi mesatar për sipërfaqet e shitura të tokave bujqësore dhe vlera totale e shitjeve, 2005-2021



Burimi: Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Gjithsej sipërfaqe e tokës bujqësore e privatizuar nga AKP, nga viti 2005-2021 është 30,823 ha që janë shitur në gjithsej vlerë 160.05 mil. €. Në vitin 2005 janë privatizuar 1,436 ha të tokës bujqësore apo 4.8% të gjithsej tokave bujqësore të privatizuara, vijuar nga viti 2006 dhe 2007, ku numri i hektarëve të tokës së privatizuar ishte 5,372 ha dhe 5,440 ha, respektivisht, me pjesëmarrje prej 18% secila. Një shitje më e madhe e tokave bujqësore është realizuar në vitin 2009, ku u privatizuan 6,790 ha, me një pjesëmarrje më të madhe krahasuar me vitet tjera. Nga viti 2010, kur shitja e tokave bujqësore nga AKP-ja ishte 2,318 ha, vitet në vijim ka pasur më pak shitje të tokave bujqësore. Në vitin 2020 u privatizuan 592 ha apo 2% nga totali i tokave bujqësore të shitura nga AKP, ndërsa në vitin 2021 janë shitur vetëm 13.8 ha apo 0.04%.

Figura 15: Shitja e tokave bujqësore në ha, 2005-2021



Burimi: Departamenti i Koordinimit Rajonal - AKP

Në tabelën në vijim janë paraqitur komunat që kanë pasur shitje të pronave bujqësore nga AKP, numri i ha të shitur, gjithsej çmimi i shitjes dhe çmimi për ha në komunë.

Tokat bujqësore kanë pasur çmime të ndryshme varësisht nga kategoria, ku ky çmim determinohet nga shumë faktorë, e disa nga faktorët kryesor përcaktues kanë qenë: boniteti i tokës bujqësore, pozita, burimet ujore afër saj dhe infrastruktura rrugore.

Tabela 12: Shitja e tokave bujqësore në Kosovë, 2005-2021

Komuna	Hektar të shitur	Vlera e shitjes	Çmimi €/ari	Çmimi €/ha
Deçan	731	2,028,963	27.7	2,775
Dragash	-	-	-	-
Glllogoc	1,140	6,069,038	53.2	5,323
Ferizaj	1,241	8,529,043	68.7	6,872
Fushë Kosovë	566	4,431,496	78.3	7,831
Gjakovë	2,352	8,782,853	37.3	3,734
Gjilan	613	4,027,406	65.7	6,570
Graçanicë	299	17,450,158	582.9	58,293
Hani i Elezit	-	-	-	-
Istog	1,945	6,251,595	32.1	3,215
Junik	360	1,494,545	41.5	4,152
Kaçanik	514	2,153,004	41.9	4,192
Kamenicë	224	385,398	17.2	1,718
Klinë	4,193	6,340,098	15.1	1,512
Klllokot	25	635,555	253.6	25,361
Leposaviq	-	-	-	-
Lipjan	679	5,120,343	75.4	7,543
Malishevë	1,590	2,101,913	13.2	1,322
Mamushë	47	896,111	190.4	19,038
Mitrovica e Jugut	2,836	1,262,087	4.5	445
Mitrovica e Veriut	-	-	-	-
Novobërdë	3	505,555	2,022.2	202,222
Obiliq	480	3,470,832	72.4	7,236
Partesh	-	-	-	-
Pejë	2,106	4,540,020	21.6	2,155
Podujevë	284	1,267,282	44.7	4,469
Prishtinë	394	38,649,703	981.0	98,101
Prizren	888	14,229,422	160.3	16,029
Rahovec	2,338	6,079,794	26.0	2,601
Ranillug	33	155,555	46.8	4,684
Shtërpcë	94	708,365	75.1	7,506
Shtime	444	1,797,199	40.5	4,045
Skenderaj	1,937	1,604,936	8.3	828
Suharekë	1,384	6,424,098	46.4	4,642
Viti	647	1,900,701	29.4	2,936
Vushtrri	436	759,669	17.4	1,743
Zubin Potok	-	-	-	-
Zveçan	-	-	-	-
Gjithsej	30,823	160,052,736		

Burimi: Departamenti i Koordinimit Rajonal - AKP

1.6 Bizneset bujqësore – Agroindustria

Agrobiznes i referohet çdo biznesi që lidhet me bujqësinë dhe aktivitetet tregtare të lidhura me bujqësinë. Agrobiznesi përfshinë të gjithë hapat e nevojshëm deri te dërgimi i produktit bujqësor në treg, përkatësisht prodhimin, përpunimin dhe shpërndarjen. Prandaj kjo industri është segment i rëndësishëm i ekonomisë që ka vend të veçantë në politikat zhvillimore të vendit tonë, duke e vlerësuar si një sektor që siguron ushqim të sigurt në aspektin sasior dhe po ashtu në anën e sigurisë ushqimore. Gjithashtu bënë të mundur lidhjen e drejtpërdrejtë të fermerit me industrinë e përpunimit. Me zgjerimin e këtij sektori krijohen vende të reja pune, nga ku varen në mënyrë direkte ose indirekte numër i madh i të punësuarve.

Të dhënat për ndërmarrjet e regjistruara janë marrë nga Regjistri Statistikor i Bizneseve që është pjesë e ASK-së, i cili përmban informacionet themelore për të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitetin ekonomik në territorin e Republikës së Kosovës dhe si i tillë shërben për statistika dhe analiza të demografisë së bizneseve dhe analizave tjera.

Ndërmarrjet e regjistruara në bujqësi, pylltari dhe peshkatari, shkallë të pjesëmarrjes më të madhe në gjithsej ndërmarrjet e regjistruara sipas seksioneve të aktiviteteve ekonomike kishin në vitin 2017 me 8.9%, ndërsa pjesëmarrje shumë të vogël krahasuar me vitet tjera, ka pasur në vitin 2019 me vetëm 1.2%, ndërsa në vitin 2021 kjo pjesëmarrje ishte 2.5%.


Tabela 13: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike, 2017-2021

Viti	Ndërmarrjet e regjistruara në bujqësi, pylltari dhe peshkatari	Gjithsej ndërmarrjet e regjistruara sipas seksioneve të aktiviteteve ekonomike	Pjesëmarrja (%)
2017	822	9,223	8.9
2018	626	9,805	6.4
2019	121	10,004	1.2
2020	397	9,805	4.0
2021	269	10,649	2.5

Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Numër më të madh të gjithsej ndërmarrjeve të regjistruara sipas seksioneve të aktiviteteve ekonomike për këtë periudhë kohore ishte në vitin 2021 me 10,649 ndërmarrje. Sa i përket ndërmarrjeve të regjistruara në bujqësi, pylltari dhe peshkatari gjatë kësaj periudhe numri më i madh i tyre u regjistrua në vitin 2017 me 822 ndërmarrje, ndërsa numri më i vogël ishte në vitin 2019 me vetëm 121 ndërmarrje. Në vitin 2021, gjithsej ndërmarrjet e regjistruara sipas seksioneve të aktiviteteve ekonomike shënuan rritje për 8.6% në krahasim me vitin 2020, ndërsa numri i ndërmarrjeve të regjistruara në bujqësi, pylltari dhe peshkatari paraqitet me rënie prej 32.2% krahasuar me vitin 2020.


Figura 16: Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike, 2017-2021



Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në seksionin e aktiviteteve ekonomike të bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë në vitin 2021, ishin të regjistruara 269 ndërmarrje, ndërsa gjithsej ndërmarrje të regjistruara sipas seksioneve dhe aktiviteteve tjera ishin 10,649. Aktivitetet e regjistruara nga bujqësia kishin pjesëmarrje 2.5% në totalin e përgjithshëm të të gjitha aktiviteteve ekonomike të regjistruara gjatë këtij viti, ndërsa 97.5% ishin aktivitetet tjera ekonomike.

Figura 17: Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari (%), ndaj aktiviteteve tjera ekonomike, në vitin 2021



Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR


Tabela në vijim paraqet të dhënat mbi qarkullimin monetar vjetor, numrin e të punësuarve si dhe numrin e bizneseve aktive për ndërmarrjet e regjistruara të agrobizneseve për periudhën 2017-2021.

Tabela 14: Ndërmarrjet e regjistruara të agrobizneseve, 2017-2021

Viti	Qarkullimi ('000 €)	Numri i të punësuarve	Numri bizneseve aktive
2017	432,301	10,449	2,398
2018	461,626	13,156	2,942
2019	499,821	12,467	2,405
2020	562,980	14,996	2,780
2021	699,399	17,260	3,019

Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR


Qarkullimi në vitin 2017 ishte 432 mil. €, duke vazhduar me rritje nga viti në vit, përderisa në vitin 2021 qarkullimi në këtë sektor ishte 699 mil. €, që në krahasim me vitin 2020 kishte rritje për 24.2%.

Figura 18: Qarkullimi monetar i ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari, 2017-2021, ('000 €)

Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Numri i të punësuarve në biznese bujqësore në periudhën 2017-2021 ka shënuar rritje të vazhdueshme. Në vitin 2020, numri i të punësuarve në agrobiznese ishte gjithsej 14,996 të punësuar apo 15.1% më i ulët krahasuar me vitin 2021, ku gjithsej numri i të punësuarve ishte 17,260.


Figura 19: Numri i të punësuarve në agrobiznese, 2017-2021



Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Numri i bizneseve aktive që kanë si lëndë të parë produktet bujqësore dhe ato pyjore ka pasur rënie dhe ngritje të lehtë ndër vite. Numër më i madh i bizneseve aktive ishte në vitin 2018 ku paraqiten aktive 2,942 biznese, ndërsa numër më i vogël paraqitet në vitin 2019 me 2,405 sosh. Në vitin 2021 numri i bizneseve ka shënuar rritje për 8.6% krahasuar me vitin 2020.

Figura 20: Numri i bizneseve aktive, 2017-2021



Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në kuadër të aktiviteteve të bizneseve bujqësore në vitin 2021, qarkullim më të madh ka pasur në përpunimin e produkteve ushqimore me vlerë prej 365.5 mil. €, përcjellur nga aktivitetet tjera të agro-industrisë që janë të prezantuara në tabelë. Prodhimi i pijeve ka pasur qarkullim prej 150.9 mil. € si dhe aktivitetet tjera vlera e të cilave është shfaqur në tabelën në vijim.


Tabela 15: Pjesëmarrja e ndërmarrjeve të regjistruara në aktivitetet bujqësi, pylltari dhe peshkatari, 2021

Aktiviteti	Qarkullimi, ('000 €)	Numri i të Punësuarve	Numri i bizneseve aktive
Prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to	74,509	2,436	814
Pylltaria dhe prerja e drunjëve	6,626	134	46
Peshkimi dhe Akuakultura	1,926	90	16
Përpunimi i produkteve ushqimore	365,463	9,219	1,419
Prodhimi i pijeve	150,871	2,333	95
Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës	7,958	442	40
Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve	58,557	1,994	486
Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	33,487	612	103
Gjithsej	699,399	17,260	3,019

Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Qarkullim më i vogël u karakterizua tek prodhimi drurit dhe produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve në vlerë prej 58.6 mil. €, prodhimi i letrës dhe produkteve të letrës me 33.5 mil. €, prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës me 8.0 mil. €, ndërsa pylltaria dhe prerja e drunjëve me 6.6 mil. €. Qarkullim shumë më i vogël, vërehet tek aktiviteti ekonomik i peshkimit dhe akuakulturës që ishte 1.9 mil. €.


Figura 21: Qarkullimi (mil. €), sipas aktiviteteve bujqësore, 2021



Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Numri i të punësuarve në aktivitetet bujqësore në vitin 2021 ishte 17,260 ku vërehet një rritje e numrit të të punësuarve në krahasim me vitin 2020 për 15.1%. Nga ky numër në sektorin e përpunimit të produkteve ushqimore ishin të angazhuar 9,219 të punësuar, pastaj radhitet sektori i prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to 2,436, sektori i prodhimit të pijeve 2,333 punëtor, si dhe prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit me 1,994 të punësuar. Aktivitete tjera të shfaqura në tabelë paraqiten me numër më të vogël të të punësuarve.


Figura 22: Numri i të punësuarve sipas aktiviteteve bujqësore, 2021



Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Numri i bizneseve aktive në vitin 2021 ishte 3,019 apo rritje për 8.6% në krahasim me vitin 2020. Nga gjithsej këto biznese në numër më të madh paraqiten biznese që merren me përpunimin e produkteve ushqimore 1,419, prodhimi bimor dhe shtazor, gjuetia dhe shërbimet e lidhura me to 814 si dhe prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit 486 biznese aktive. Numër më i vogël i bizneseve aktive ishte edhe në aktivitete tjera që janë të paraqitura në figurën në vijim.

Figura 23: Numri i bizneseve aktive në vitin, 2021




Burimi: ASK -Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Qarkullimi më i madh nga industria agro-ushqimore në vitin 2021 ishte në regionin e Prishtinës me 27%, pasuar nga regjioni i Prizrenit 24%, Pejës 16% si dhe pjesa tjetër në regionet tjera.

Numër më i madh i të punësuarve në këtë sektor del të jetë në regionin e Prishtinës 27%, pasuar nga Prizreni 22%, Peja 13%, Gjakova 10%, Gjilani 11%, Mitrovica 8% dhe regjioni i Ferizajit me 9%.

Numri më i lartë i bizneseve aktive në vitin 2021 ishte në regjionin e Prishtinës 26%, pasuar nga regjioni i Prizrenit 20%, Gjakovës dhe Pejës me nga 12% si dhe regjionet e tjera që kishin pjesëmarrje më të vogël.

Figura 24: Qarkullimi, numri i të punësuarve dhe numri i bizneseve aktive në sektorin e bujqësisë sipas regjioneve (%), 2021



Burimi: ASK-Regjistri Statistikor i Bizneseve, përpunuar nga DAESB-MBPZhr

2 Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij

2.1 Përdorimi i tokës bujqësore

Trendet e fundit të zhvillimit ekonomik të Kosovës kanë prekur edhe tokat e punueshme bujqësore, ku sipërfaqeve të konsiderueshme të tokës bujqësore u është ndërruar destinimi nga toka bujqësore në atë ndërtimore. Në përgjithsi në këtë periudhë të zhvillimit ekonomik gradualisht fermat edhe ashtu të vogla siç ishin, kanë vazhduar të fragmentohen edhe më tutje, duke ndikuar në zvogëlimin e madhësisë mesatare të fermës. Faktorët kryesor në këtë drejtim mund të thuhet që janë ndërrimi i destinimit të tokës në vazhdimësi për shkak të rritjes së popullsisë rurale si dhe faktorë të tjerë. Nga tabela e paraqitur në vijim vërehet se ekzistojnë dy kategori kryesore të përdorimit të tokës bujqësore: tokë e punueshme (e cila është tokë e dedikuar për rritjen e kulturave bujqësore) dhe kategoria që përfshinë livadhet dhe kullotat e që përdoret për kullotjen e bagëtive.

Të dhënat për përdorimin e tokës bujqësore merren nga Anketa e Ekonomive Bujqësore, dhe bazuar në të dhënat e kësaj ankete, gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ka pasur një trend të përafërt të shfrytëzimit në periudhën kohore 2017-2021. Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2021 ishte 420,327 ha, që ishte sipërfaqe e përafërt me atë të vitit 2020.

Tabela 16: Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, ha

	2017	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020 në %	Pjesëmarrja në % 2021
Tokë e punueshme - ara	186,954	188,359	188,365	188,372	188,375	0.0	44.8
-Nga e cila me perime në fushë të hapur (kulturë e parë)	8,033	7,818	8,319	8,435	8,491	0.7	
-Nga e cila me perime në serra (kulturë e parë)	467	468	518	547	562	2.8	
Kopshte	1,199	1,003	1,122	1,133	1,089	-3.8	0.3
Plantacione të pemëve	6,247	7,687	9,244	10,029	10,144	1.1	2.4
Plantacione të vreshtave	3,199	3,272	3,367	3,437	3,471	1.0	0.8
Fidanishte	159	109	111	137	140	2.4	0.0
Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët)	218,314	218,152	217,932	217,102	217,107	0.0	51.7
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore	416,072	418,582	420,141	420,210	420,327	0.03	100.0


Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('17/'18,'19,'20,'21)

*Statistikat e prezantuara në këtë tabelë paraqiten në bazë të grupimit si në AEB të ASK-së dhe ka ndryshime me të dhënat e prezantuara në nënkapitujt 2.3.2 dhe 2.3.3 për arsye të ndryshimit në grupim (p.sh dredhëza tek nënkapitulli 2.1 sipas grupimit të ASK-së është e kategorizuar në perime ndërsa tek nënkapitulli 2.3.3 është e paraqitur tek pemët).

Pjesëmarrje më të madhe kanë livadhet dhe kullosat (përfshirë tokën e përbashkët) që në vitin 2021 kishte sipërfaqe prej 217,107 ha, që përbën 51.7% të gjithsej sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore. Bazuar në të dhënat e shfaqura në tabelën më lartë vërehet se nuk ka pasur ndryshime të theksuara në këtë kategori.

Sipërfaqe më të madhe, përveç livadheve dhe kullosave ka kategoria e tokës së punueshme-ara, me pjesëmarrje prej 44.8%, që paraqet sipërfaqen prej 188,375 ha, ku përfshihet edhe sipërfaqja e perimeve në fushë të hapur (si kulturë e parë) (8,491 ha) dhe perimet në serra po ashtu si kulturë e parë (562 ha), pra gjithsej 9,053 ha me perime.

Figura 25: Tokë e punueshme-ara dhe livadhe e kullosa




Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('17,'18,'19,'20,'21)

Sipërfaqja e perimeve në fushë të hapur në vitin 2021 ka shënuar rritje të lehtë në krahasim me vitet tjera, kështu që në krahasim me vitin 2020 kjo sipërfaqe është rritur për 0.7%, ndërsa sipërfaqja me serra ka pasur rritje për 2.8%. Kopshtet paraqiten me sipërfaqe prej 1,089 ha, që shfaqet një rënie për 1% krahasuar me vitin 2020.

Sipërfaqja e plantacioneve të pemëve në vitin 2021 ishte 10,144 ha, ku kishte një rritje për 1.1% ndërsa sa i përket sipërfaqes së vreshtave edhe te kjo kategori ka pasur rritje për 1%.


Figura 26: Perime, kopshte dhe fidanishte, plantacione të pemëve dhe vreshtave



Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('17,'18,'19,'20,'21)

Shfrytëzimi i tokës bujqësore në vitin 2020 sipas kategorive ka këtë shpërndarje: Livadhe dhe kullosa (përfshirë tokën e përbashkët) me pjesëmarrje prej 52%, Tokë e punueshme-ara 43%, Perime (në fushë të hapur dhe serra si kulturë e parë), kopshte dhe fidanishte 2%, Plantacione të pemëve 2% si dhe Plantacione të vreshtave 1%.

Figura 27: Përdorimi i tokës bujqësore sipas kategorive, 2021



Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore, 2021

2.2 Prodhimtaria bimore

2.2.1 Drithërat

Në vitin 2021 në Kosovë janë kultivuar 124,477 ha me drithëra, 237 ha më pak krahasuar me vitin paraprak. Nga gjithsej sipërfaqja me drithëra prin kultura e grurit, sipërfaqja e të cilës në vitin 2021 pësoi rënie për 0.6%, pasuar nga kultura e misrit që kishte rritje në sipërfaqe për 0.1%, elbi sipërfaqja e të cilit u rrit për 3.9%, tërshëra me rritje 1.1%, thekra 30.7% (130 ha) dhe drithërat e tjera kokërr me rritje 8.4%.

Prodhimi i drithërave në vitin 2021 kishte rënie tek të gjitha kulturat me përjashtim të thekrës e cila kishte rritje për 22.2% dhe drithërave të tjera kokërr 3.3%, të cilat përkundër asaj se në rendiment kanë shënuar rënie, rritja e sipërfaqes ndikoi në rritjen e gjithsej prodhimit.

Tabela 17: Sipërfaqja, prodhimi dhe rendimenti i drithërave, 2017-2021

Kultura	2017	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020 në %
Sipërfaqja	ha					
Drithëra	120,746	123,869	124,199	124,714	124,477	-0.2
Grurë	80,519	81,123	80,273	80,473	79,970	-0.6
Misër	35,951	38,453	39,441	39,684	39,710	0.1
Elb	1,605	1,948	1,954	1,982	2,060	3.9
Thekër	318	434	420	425	555	30.7
Tërshërë	2,320	1,797	1,975	2,009	2,030	1.1
Drithëra të tjera kokërr	33	113	136	141	153	8.4
Prodhimi	t					
Drithëra	477,880	441,757	459,404	529,112	504,371	-4.7
Grurë	320,136	280,616	284,999	341,818	322,018	-5.8
Misër	147,200	151,921	163,930	175,180	170,393	-2.7
Elb	4,687	5,124	5,159	5,764	5,610	-2.7
Thekër	866	1,049	1,010	1,153	1,409	22.2
Tërshërë	4,862	2,751	3,954	4,769	4,500	-5.7
Drithëra të tjera kokërr	129	296	352	427	441	3.3
Rendimenti	t/ha					
Grurë	3.98	3.46	3.55	4.25	4.03	-5.2
Misër	4.09	3.95	4.16	4.41	4.29	-2.8
Elb	2.92	2.63	2.64	2.91	2.72	-6.3
Thekër	2.72	2.41	2.41	2.71	2.54	-6.5
Tërshërë	2.10	1.53	2.00	2.37	2.22	-6.6
Drithëra të tjera kokërr	3.87	2.62	2.59	3.03	2.89	-4.7

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('17/'18/'19/'20/'21)

Kultura e grurit përbënë 64.2% të gjithsej sipërfaqes së kultivuar me drithëra në vitin 2021. Prodhimi i përgjithshëm vendor ishte 322,018 tonë i cili mbulon 69.6% të nevojave vendore për konsum dhe pjesa tjetër mbulohet nga importi. Në Kosovë pjesa më e madhe e grurit është përdorur për konsum njerëzor dhe pjesa tjetër është shitur dhe përdorur për ushqim të

kafshëve. Vlera e prodhimit vendor të grurit ishte 64.4 mil. €, ndërsa bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ, dhe vlera e tij është rritur për shkak të ngritjes së çmimeve në tregun ndërkombëtar por edhe asaj se sasia e importuar e grurit dhe produkteve të grurit është rritur në vitin 2021.

Në vitin 2021, konsumi mesatar për kokë banori për grurë, duke përfshirë edhe produktet me përmbajtje gruri e që përmes koeficientëve të konvertimit janë konvertuar në grurë, ishte 207 kg.

Tabela 18: Bilanci i furnizimit për grurin, 2017-2021

	Njësia	2017	2018	2019	2020	2021
Sipërfaqja me drithëra	ha	120,746	123,869	124,199	124,714	124,477
Sipërfaqja me grurë	ha	80,519	81,123	80,273	80,473	79,970
Pjesëmarrja e grurit	%	66.7	65.5	64.6	64.5	64.2
Rendimenti	t/ha	4.0	3.5	3.6	4.2	4.0
Prodhimi	t	320,136	280,616	284,999	341,818	322,018
Importi i grurit dhe eku. të grurit*	t (p.e)	179,983	175,252	220,208	132,952	148,825
Importi i farës së grurit	t	7,850	6,535	5,288	8,724	7,736
Importi i grurit	t	120,402	116,045	149,947	74,491	93,365
Importi i miellit të grurit	t	22,990	20,677	29,388	20,130	16,599
Importi i produkteve tjera të grurit	t	31,044	28,409	27,131	27,352	30,645
Furnizimi	t	500,119	455,868	505,207	474,770	470,843
Eksporti i grurit dhe eku. të grurit*	t (p.e)	22,700	10,326	5,093	8,364	8,395
Eksporti i farës së grurit	t	328	130	75	298	546
Eksporti i grurit	t	0	0	0	0	0
Eksporti i miellit të grurit	t	15,809	7,157	3,389	5,536	5,294
Eksporti i produkteve tjera të grurit	t	1,039	684	813	856	1,029
Përdorimi vendor	t	477,419	445,542	500,114	466,406	462,448
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	67.1	63.0	57.0	73.3	69.6
Farë gruri	t	24,156	24,337	24,082	24,142	23,991
Humbjet	t	9,604	8,418	8,550	10,255	9,661
Ushqimi për kafshë	t	51,510	45,151	45,856	54,999	51,813
Përdorimi industrial	t	8,895	7,914	8,371	10,182	9,307
Procesimi	t	232,041	225,176	270,938	193,729	209,452
Konsumi njerëzor	t	151,213	134,546	142,316	173,100	158,225
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.21	0.23	0.18	0.19	0.20
Vlera e prodhimit	mil. EUR	67.2	64.5	51.3	64.9	64.4
Bilanci tregtar i grurit dhe eku. të grurit	mil. EUR	-76.6	-73.1	-81.0	-70.6	-91.9
Bilanci tregtar për farë gruri	mil. EUR	-2.4	-2.1	-1.8	-2.8	-2.6
Bilanci tregtar për grurë	mil. EUR	-20.4	-23.4	-29.0	-15.0	-25.4
Bilanci tregtar për miell gruri	mil. EUR	-2.2	-4.2	-8.0	-4.3	-4.8
Bilanci tregtar për produkte tjera të grurit	mil. EUR	-51.6	-43.5	-42.2	-48.5	-59.1
Konsumi për kokë banori	kg	213	200	232	204	207

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('17,'18,'19,'20,'21); ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB – MBPZHR

Sqarim: Për të gjitha të dhënat e tregtisë (eksporti dhe importit) viti i prezantuar në tabelë përfshinë periudhën korrik-dhjetor të atij viti dhe janar-qershor të vitit pasues; p.e - nënkupton ekuivalentët e produktit, d.m.th çdo produkt me përmbajtje gruri i konvertuar në grurë; *Importi i grurit dhe eku. të grurit dhe Eksporti i grurit dhe eku. të grurit, nënkupton eksportin ose importin e sasisë së grurit si dhe të të gjitha produkteve tjera që përmbajnë grurë e që përmes koeficientëve të konvertimit janë të konvertuara në grurë.

Në vitin 2021, 31.9% e sipërfaqes së përgjithshme të mbjellë me drithëra është e mbjellë me misër. Me sasinë e prodhuar prej 170,393 tonë Kosova mbulon 78% të nevojave të saj, ku pjesa më e madhe është përdorur si ushqim i kafshëve. Për të përmbushur nevojat e përgjithshme, misër edhe importohet dhe bilanci tregtar vazhdon të mbetet negativ në vlerë prej 15.6 mil. €, e që u thellua për shkak të çmimeve më të larta në vitin 2021 përkundër faktit se sasia e importuar ishte më e ulët krahasuar me vitin 2020. Konsumi mesatar për kokë banori për misër, duke përfshirë edhe produktet me përmbajtje misri në vitin 2021 ishte 44 kg.

Tabela 19: Bilanci i furnizimit për misrin, 2017-2021

	Njësia	2017	2018	2019	2020	2021
Sipërfaqja me drithëra	ha	120,746	123,869	124,199	124,714	124,477
Sipërfaqja me misër	ha	35,951	38,453	39,441	39,684	39,710
Pjesëmarrja e misrit	%	29.8	31.0	31.8	31.8	31.9
Rendimenti	t/ha	4.09	3.95	4.16	4.41	4.29
Prodhimi	t	147,200	151,921	163,930	175,180	170,393
Importi i misrit dhe eku. të misrit*	t (p.e)	58,329	54,071	55,498	58,741	48,595
Importi i farës së misrit	t	661	589	635	571	521
Importi i misrit	t	51,146	48,770	50,796	51,540	40,700
Importi i miellit të misrit	t	2,019	796	32	1,365	1,547
Importi i produkteve tjera të misrit	t	2,559	2,346	2,697	3,076	3,363
Furnizimi	t	205,529	205,992	219,428	233,921	218,988
Eksporti i misrit dhe eku. të misrit*	t (p.e)	277	303	328	555	445
Eksporti i farës së misrit	t	91	28	81	157	54
Eksporti i misrit	t	-	63	48	111	1
Eksporti i miellit të misrit	t	28	25	43	71	48
Eksporti i produkteve tjera të misrit	t	69	83	66	90	154
Përdorimi vendor	t	205,252	205,689	219,100	233,366	218,543
Shkalla e vetë-mjaftueshmërisë	%	71.7	73.9	74.8	75.1	78.0
Farë misri	t	719	769	789	794	794
Humbjet	t	4,416	4,558	4,918	5,255	5,112
Ushqimi për kafshë	t	113,652	117,275	126,579	135,305	131,590
Përdorimi industrial	t	3,110	2,904	2,990	3,157	2,648
Procesimi	t	13,201	13,749	15,145	16,065	15,431
Konsumi njerëzor	t	70,154	66,434	68,679	72,790	62,968
Çmimet e prodhuesit (në fermë)	€/kg	0.23	0.25	0.24	0.25	0.28
Vlera e prodhimit	mil. EUR	33.9	38.0	39.3	43.8	47.7
Bilanci tregtar i misrit dhe eku. të misrit	mil. EUR	-11.9	-10.8	-11.6	-13.2	-15.6
Bilanci tregtar për farë misri	mil. EUR	-1.5	-1.0	-1.4	-1.1	-1.6
Bilanci tregtar për misër	mil. EUR	-8.5	-7.8	-8.2	-9.3	-10.3
Bilanci tregtar për miell misri	mil. EUR	-0.4	-0.2	0.0	-0.3	-0.4
Bilanci tregtar për produkte tjera të misrit	mil. EUR	-1.5	-1.8	-2.1	-2.5	-3.3
Konsumi për kokë banori	kg	46	45	47	49	44

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('17,'18,'19,'20,'21); ASK - Statistikat e Tregtisë së Jashtme; kalkulime nga DAESB – MBPZHR

Sqarim: Për të gjitha të dhënat e tregtisë (eksporti dhe importit) viti i prezantuar në tabelë përfshinë periudhën korrik-dhjetor të atij viti dhe janar-qershor të vitit pasues; p.e - nënkupton ekuivalentët e produktit, d.m.th çdo produkt me përmbajtje misri i konvertuar në misër; *Importi i misrit dhe eku. të misrit dhe Eksporti i misrit dhe eku. të misrit, nënkupton eksportin ose importin e sasisë së misrit si dhe të të gjitha produkteve tjera që përmbajnë misër e që përmes koeficientëve të konvertimit janë të konvertuara në misër.

2.2.2 Perimet

Gjatë vitit 2021, sipërfaqet me perime në Kosovë të kultivuara në fushë të hapur, në serra dhe në kopshte llogariten të jenë gjithsej 19,399 ha. Kulturat të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të kësaj sipërfaqe janë: patatja (3,854 ha), speci (3,146 ha), kungulli (2,612 ha), fasulja (2,914 ha), qepa (1,369 ha), shalqiri (1,309 ha), lakra (923 ha), kungulli i misirit (918 ha), domatja (800 ha), pjepri (321 ha), trangulli (305 ha) dhe kulturat tjera perimore të cilat ndajnë një sipërfaqe më të vogël krahasuar me kulturat e prezantuara më lartë.

Nëse analizohet ndryshimi mes vitit 2020 dhe 2021, në sipërfaqet me kultura perimore vërehet se pothuajse të gjitha kulturat kanë shënuar rritje të lehtë në sipërfaqe, përpos trangullit, domates dhe hudhrës të cilat kanë shënuar zvogëlim të sipërfaqeve. Shikuar në aspektin e përgjithshëm totali i përgjithshëm i sipërfaqeve me perime është rritur për 0.8% krahasuar me vitin 2020.

Tabela 20: Sipërfaqja me perime, 2017 - 2021

Kultura	2017	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020 në %
Sipërfaqja	ha					
Perime	19,643	17,886	18,911	19,243	19,399	0.8
Patate	4,290	3,606	3,688	3,771	3,854	2.2
Domate	862	757	794	815	800	-1.8
Patëllxhan i zi	8	6	8	7	8	11.7
Spec	3,035	3,038	3,108	3,134	3,146	0.4
Kungull	2,270	2,255	2,502	2,577	2,612	1.4
Kungull misiri	684	810	898	913	918	0.5
Trangull	305	273	304	313	305	-2.7
Shalqi	1,201	1,182	1,216	1,303	1,309	0.4
Pjepër	388	298	313	318	321	0.9
Lakër	917	832	906	918	923	0.5
Lulelakër	47	46	53	50	52	3.8
Spinaq	161	160	197	150	154	2.8
Sallatë	92	78	88	79	82	3.7
Panxhar i kuq	-	9	9	7	7	2.1
Rrepkë (rillkë)	-	5	5	5	5	2.7
Majdanoz	10	11	11	11	12	8.9
Presh (purri)	73	72	75	76	78	2.7
Qepë	1,465	1,185	1,354	1,367	1,369	0.1
Hudhër	138	146	234	264	263	-0.6
Fasule	3,406	2,845	2,888	2,904	2,914	0.3
Bizele	99	55	67	68	69	1.6
Bishtajoret tjera	54	69	42	43	46	5.4
Karota	107	112	121	126	129	2.6
Perime tjera	32	37	29	22	23	5.3

Burimi: ASK – Anketa e ekonomive bujqësore ('17,'18,'19,'20,'21)

Në vitin 2021, gjithsej prodhimit i vezëve vlerësohet të jetë 419.9 mil. vezë. Në vitin 2021 janë importuar 4.4 mil. vezë në vlerë prej 429,377 €. Sasia e importuar e vezëve në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 ka shënuar rritje prej 8.7%. Nga gjithsej importi i vezëve, 99% është importuar nga shtetet në vijim: 46.0% nga Maqedonia, 32.9% nga Shqipëria, 12.6% nga Sllovenia, 6.0% nga Bullgaria dhe 1.7% nga Greqia. Sasia e eksportuar është shumë më e vogël sesa sasia e importuar dhe e tëra është eksportuar në Mal të Zi. Në vitin 2021, konsumi mesatar për kokë banori llogaritet të jetë rreth 239 vezë/vit dhe mund të themi se Kosova plotëson rreth 99% të nevojave për konsum të vezëve.

Në vitin 2021, prodhimi i mishit të pulës vlerësohet të jetë rreth 3,007 tonë. Në këtë vit importi i mishit të pulës ishte 40,502 tonë me vlerë prej 51.1 mil. €. Nga sasia e përgjithshme e importuar, 33.9% është importuar nga Brazili, 15.3% nga Mbretëria e Bashkuar, 14.0% nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 6.5% nga Polonia, 5.1% nga Turqia, 5.0% nga Gjermania dhe 20.2% nga vendet e tjera. Konsumi mesatar për kokë banori në Kosovë vlerësohet rreth 24.5 kg/vit dhe me prodhimtarinë aktuale, Kosova arrin të mbulojë vetëm 6.9% të nevojave për konsum.

2.4.5 Bletaria

Sektori i bletarisë në vitin 2021 shënoi një ulje prej 16.6% në numrin e koshereve krahasuar me vitin 2020, përderisa në periudhën paraprake '17-'20 shënoi rritje të vazhdueshme. Nga gjithsej numri i koshereve në Kosovë, në vitin 2021 87.9% janë subvencionuar në kuadër të mbështetjes përmes programit të pagesave direkte e që në periudhën '17-'20 mesatarja e përqindjes së pjesëmarrjes së koshereve të subvencionuara në raport me gjithsej numrin e koshereve ishte 91.4%.

Tabela 48: Numri i koshereve të bletëve, 2017-2021

Numri i koshereve	2017	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020 në %
Koshere bletësh	163,717	182,476	219,831	262,541	219,077	-16.6

Burimi: ASK - Anketa e ekonomive bujqësore ('17,'18,'19,'20,'21)

Në vitin 2021, prodhimi i mjaltit në Kosovë ishte rreth 7.5 kg për koshere që rezulton me një prodhimtari totale të mjaltit prej 1,634 tonë. Importi i mjaltit në vitin 2021 ishte 289 tonë, ndërsa eksport nuk kishte fare. Konsumi vendor rezulton të jetë rreth 1.1 kg për kokë banori dhe prodhimi vendor plotëson 85% të nevojave për konsum, ndërsa pjesa tjetër plotësohet nga importi. Nga gjithsej sasia e importuar e mjaltit, 35.6% është importuar nga Maqedonia e Veriut, 18.7% nga Turqia, 17.6% nga Kroacia, 9.8% nga Sllovenia, 9.1% nga Gjermania dhe pjesa tjetër prej 9.2% nga vendet e tjera.

3 Pylltaria


Pyjet janë një prej resurseve të rëndësishme me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ndërsa me Ligjin Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës konsiderohen resurse kombëtare me interes të përgjithshëm. Për shkak të ndryshimeve klimatike, rritjes së temperaturave deri në ekstrem, vendet e Bashkimit Evropian kanë filluar të tregojnë interes të shtuar në ruajtjen, përkujdesjen dhe rritjen e vigjilencës në menaxhimin e qëndrueshëm apo përdorimin e pyjeve përmes sensibilizimit në funksionin shumëdimensional duke u përqendruar në shërbimet shumë qëllimore të pyjeve. Prandaj, politikat e ardhshme do të përqendrohen mbi këtë bazë me qëllim të ruajtjes, shtimit dhe përdorimit sa më të arsyeshëm të këtyre resurseve ndër breza.

Në fund të vitit 2021 është miratuar strategjia e re për pylltarinë si sektor. Kjo strategji merr në konsideratë sfidat mjedisore në aspektin e ndryshimeve klimatike, humbjen e diversitetit dhe degradimin e tokës bazuar në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. Gjithashtu, bazohet në Strategjinë e BE-së për pyje të vitit 2021, e cila për synim ka maksimizimin e kontributit të sektorit pyjor në përmbushjen e qëllimit që ndërlidhet me neutralitetin ndaj karbonit. Tashmë është e njohur se pyjet në Kosovë kanë një potencial të konsiderueshëm për të kontribuar në masë të madhe në përmirësimin e mirëqenies së banorëve në zonat rurale duke gjeneruar vende pune dhe të ardhura përmes zhvillimit të aktiviteteve, prandaj është nevojë e kohës mbrojtja e pyjeve për ekosisteme të qëndrueshme dhe të shëndetshme. Kjo Strategji në vete ngërthen pesë objektiva strategjike:

1. Përmirësimi i gjendjes së resurseve pyjore;
2. Mbrojtja e resurseve pyjore;
3. Përdorimi i qëndrueshëm dhe shumë funksional i resurseve pyjore;
4. Zhvillimi i kapaciteteve të sektorit të pylltarisë;
5. Digjitalizimi dhe përmirësimi i komunikimit;

Statistikat e Inventarizimit Kombëtar të Pyjeve/IKP të vitit 2012, tregojnë se në Kosovë pyjet shtrihen në sipërfaqe rreth 45%, të cilat konsiderohen potencial i qëndrueshëm në ngritjen e kapaciteteve për zhvillim të vendit. Pyjet publike shtrihen në një sipërfaqe rreth 62% të sipërfaqes së përgjithshme pyjore, nga të cilat 12% e tyre janë shpallur zona të mbrojtura me Ligjin për Parkun Kombëtar “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”, ndërsa rreth 38% konsiderohen pyje privat.

Figura 31: Harta e shtrirjes të pyjeve dhe pyjet sipas originës



Burimi: Inventarizimi Nacional i Pyjeve, INP 2012

Gjuetia

Është një nga sektorët që ka ngecur dhe është në zhvillim e sipër. Dhënia në menaxhim e vend gjuetive të përbashkëta dhe menaxhimi i tyre me Plane menaxhuese afatgjata 10 vjeçare dhe vjetore është në proces e sipër. Faktikisht kjo arrihet pasi komunat kanë arritur të themelojnë vend gjuetitë e tyre pas marrjes të pëlqimit nga MBPZHR, me ç'rast Asambleja komunale është përgjegjëse për nxjerrjen e vendimit për themelimin.

Tabela 49: Pëlqimet për themelim, dhënie në menaxhim dhe miratimi i PM

Emri i vend gjuetisë	Statusi	Komuna	Sipërfaqja në ha
Themelimi			
Sharr	Refuzuar	Dragash (rithemelim)	10,131.00
Gmica	Refuzuar	Kamenicë (private)	16.00
Podguri	Miratuar	Pejë (rithemelim)	13,672.50
Duboçk	Miratuar	Pejë (rithemelim)	13,616.50
Dhënia në menaxhim			
Kalaja	Refuzim	Novobërdë	16,000.00
Kriva reka	Refuzim	Ranillug	7,761.80
Lojza	Miratim	Deçan	11,645.00
Planet menaxhuese afatgjata 10 vjeçare			
Bjeshka 2021-2031	Miratuar	Fushë Kosovë	4,725.00
Qyqavica 2021-2031	Refuzuar	Obiliq	10,482.00
Karadaku	Refuzuar	Gjilan	8,495.00
Maja e gjelbër	Refuzuar	Gjilan	16,680.00
Zhegoci	Refuzuar	Gjilan	15,300.00
Planet vjetore menaxhuese			
Bjeshka 2021/2022	Miratuar	Fushë Kosovë	4,725.00
Karadaku 2021/2022	Refuzuar	Gjilan	8,495.00
Maja e gjelbër 2021/2022	Refuzuar	Gjilan	16,680.00
Zhegoci 2021/2022	Refuzuar	Gjilan	15,300.00

Burimi: Departamenti i Pylltarisë

Licencimi

Procesi i licencimit për vitin 2021 është ndjekur me vështirësi të shumta si shkak i Pandemisë COVID 19, të cilat kryesisht kishin të bënin me kufizimet e lëvizjes të personelit përgjegjës që ndërlikojnë me mos realizimin e vizitave në terren. Megjithatë edhe pse në kushte kufizuese janë paraqitur gjithsej 64 kërkesa për kryerjen e aktiviteteve të ndryshme në pyje dhe toka pyjore si: kultivim, pyllëzime 3 copë, shfrytëzim i qëndrueshëm i pyjeve 19 copë, grumbullim të PPJD-ve 19 copë dhe përpunim primar të drurit sharrë 23 copë kërkesa.

Aktivitetet e licencimit janë ndjekur nga Komisioni i DP, përmes shqyrtimit të kërkesave, vizitave në terren të subjekteve, dhe zhvillimit të procedurës për lëshimin e licencave dhe të dhënat për numrin e licencave të lëshuara janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 50: Licencat e lëshuara

Emërtimi i licencave	Nr. licencave të lëshuara	
	Të reja	Vazhdim
Për shfrytëzim të qëndrueshëm të pyjeve	2	15
Për grumbullim të prodhimeve jo drunore (fruta malore)	2	15
Për përpunim të drurit	5	10
Pyllëzime	2	0
Për projektme në fushën e pylltarisë	0	0
Gjithsej	11	40

Burimi: Departamenti i Pylltarisë

Menaxhimi i pyjeve

Menaxhimi i pyjeve në Kosovë bëhet në mbështetje të Ligjit Nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-153, rregullore, një mori aktesh nënligjore, normave, standardeve dhe udhëzuesve profesional. Përveç këtyre dokumenteve menaxhimi, përdorimi dhe trajtimi i pyjeve realizohet mbi bazën e planifikimit pyjor për Njësi menaxhuese pyjore/NjMP.

Sipas raportit të Agjencisë të Pyjeve, deri më tani janë hartuar mbi 80% të Planeve menaxhuese nga 84 njësi menaxhuese evidente të pyjeve. Agjencia Pyjore e Kosovës/APK përgjatë vitit 2021 nuk ka të zhvilluara aktivitete për hartimin e PM edhe pse ishte paraparë realizimi i hartimit të tyre në sipërfaqe rreth 28,624 ha, që si pasojë e shkurtimeve buxhetore, kryerjen e aktiviteteve me staf të shkurtuar si shkak i pandemisë COVID19, vonesave në zhvillimin e procedurave, është ndikuar në anulimin e të gjitha procedurave për hartim të këtyre PM.

Pyjet shtetërore

Vëllimi bruto i paraparë me planin për prerje në pyjet shtetërore për vitin 2021 ishte 67,972 m³, prej të cilave vëllimi neto ishte 63,680 m³ dhe mbetjet pyjore 4,292 m³

Tabela 51: Plani i prerjeve në pyjet shtetërore

Asortimentet	Vëllimi m ³
Dru teknik	8,481
Dru zjarri	55,199
Vëllimi neto	63,680
Mbetje pyjore	4,292
Vëllimi bruto	67,972

Burimi: APK

Në vitin 2021 u arrit të përmbushet vetëm 40% e planit të prerjeve apo 27,221 m³ të materialit drunor të planifikuar përmes prerjes gjatë trajtimit të grumbujve pyjor në pyjet shtetërore.

Tabela 52: Realizimi i planit të prerjeve në pyjet shtetërore

Asortimentet	Plani m ³	Realizimi m ³	Realizimi i planit %
Dru teknik	8,481	4,322	51
Dru zjarri	55,199	22,542	41
Mbetje pyjore	4,292	357	8
Gjithsej	67,972	27,221	40

Burimi: APK

Raporti i Inventarit Kombëtar të Pyjeve (2012), tregon se mesatarja e prerjeve vjetore në këto pyje sillet rreth 619,000 m³. Në rast konkret për vitin 2021 tregohet se vetëm 11% e kësaj mesatare është arritur të planifikohet, ndërsa rreth 4.4% të kësaj mesatare është arritur të realizohet.

Pyjet private

Plani për pyjet private parasheh kryerjen e aktiviteteve në ngritje e pyjeve të reja me pyllëzime me 59 ha, kultivimin e pyjeve në rreth 2,779 ha, pranim të kërkesave për trajtim të pyjeve (4,235 copë) të parashtruara nga pronarët e pyjeve dhe prerjen e një vëllimi drunor rreth 192,290 m³ me qëllim të përmbushjes së nevojave të tyre për dru për djegie dhe industri.

Tabela 53: Plani në kultivimi dhe shfrytëzimin e pyjeve private dhe punët tekniko-profesionale

Plani në kultivimi dhe shfrytëzimin e pyjeve private	Njësia	Total
Ngritja e pyjeve të reja - pyllëzime	ha	59
Përtëritja e pyjeve - meliorim	ha	14
Kultivimi i pyjeve	ha	2,779
Shfrytëzimi i pyjeve	ha	4,240
Punët tekniko-profesionale		
Kërkesa të parashtruara	copë	4,235
Planifikimi i prerjeve në pyjet private	m ³	192,290
Dru zjarri	m ³	182,270
Dru teknik	m ³	10,020

Burimi: APK

Aktivitete në pyjet private janë shënuar duke u angazhuar në përmbushjen e planit për vitin 2021, përmes realizimit të kërkesave të parashtruara nga pronarët e pyjeve. Plani i pyllëzimeve është realizuar në bashkëpunim me Asociacionin e Pronarëve të Pyjeve të Kosovës/ APPK.

Tabela 54: Të dhënat mbi përdorimin e pyjeve private

Drejtoria	Plani m ³	Realizimi m ³	Realizimi i planit %
Prishtinë	43,450	21,881	50
Mitrovicë	83,850	49,509	59
Pejë	4,580	3,758	82
Prizren	3,960	2,530	64
Ferizaj	10,900	5,220	48
Gjilan	44,800	57,396	128
Blinajë/MKFE	750	295	39
Gjithsej	192,290	140,589	73

Burimi: APK

Referuar këtyre të dhënave tregohet se në pyjet private realizimi i planit ka qenë dukshëm më i qëndrueshëm si rrjedhojë e angazhimeve të vet pronarëve të pyjeve, kërkesave të parashtruara dhe nevojave të tyre për furnizim me dru për ngrohje dhe përpunim. Tabela e mësipërme tregon se janë vjelë rreth 140,589 m³ apo 73% të vëllimit drunor të planifikuar.

Mesatarja e prerjes vjetore në pyjet private për fletor dhe halorë sillet diku rreth 338,000 m³ në vit (INP 2012). Analizat tregojnë se për vitin 2021 me planifikim është paraparë të vjelët rreth 56.9% e kësaj mesatare vjetore, ndërsa rreth 41.6% e saj është arritur të realizohet në përmbushje të nevojave me asortimente drunore.

Mbrojtja e pyjeve

Aktivitetet në mbrojtjen e pyjeve kryesisht janë përqendruar në mbrojtjen e pyjeve nga faktori njeri përmes prerjeve të pa rregullta. Autoritetet komunale kanë zhvilluar një mori aktivitete në mbrojtje të pyjeve dhe luftimin e informalitetit në pyje. Këtu mund të përmendim angazhimet përmes monitorimit, vrojtimit të pyjeve, inspektimit të tregjeve, rrugëve, depove, vend grumbullimit, konfiskimeve etj. Janë raportuar se janë ngritur rreth 2,592 kallëzime penale dhe kundërvajtëse, nga të cilat 441 penale dhe 2,151 kundërvajtëse. Sasia e materialit drusor të raportuar si dëm pyjor është llogaritur të jetë rreth 5,549.82 m³ në vlerë rreth 743,769.53 €. Konstatohet se gjatë vitit që lamë pas janë konfiskuar 1,524.26 m³ lëndë drusore nga e cila janë shitur 464.72 m³, ndërsa stoqet e bartura nga viti i kaluar arrijnë sasinë 2,350.65 m³.

Tabela 55: Kallëzimet apo fletëparaqitjet, 2021

Kallëzimet	Copë	m³	Vlera në €
Kundërvajtje	2,151	3,610	479,276
Penale	441	1,940	264,520
Gjithsej	2,592	5,550	743,796

Burimi: APK

Më poshtë është paraqitur gjendja e stoqeve të lëndëve drusore të konfiskuara gjatë vitit 2021 dhe gjendja ekzistuese e tyre pas shitjes dhe shpërndarjes së asortimenteve drusore nga komunat.

Tabela 56: Konfiskimi i materialit drunor

Lënda drusore	m³
Stoqet nga viti 2020	1,460
Sasia e drusore e konfiskuar 2021	1,524
Sasia e shitur	465
Shpërndarja/Memorandum bashkëpunimi	169
Gjendja e tanishme e stoqeve	2,350

Burimi: APK

Zjarret pyjore

Mbrojtja e pyjeve nga zjarret sidomos në periudhën kur mbizotërojnë thatësira, paraqet sfidën më të madhe të institucioneve tona të cilat merren me menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore, por është një sfidë edhe për institucionet e emergjencave. Statistikat tregojnë

se në pjesën dërrmuese burim i zjarreve është faktori njeri ndërsa të rrallë janë shkaktarë të tjerë abiotik.

Gjatë periudhës me thatësira të verës të vitit 2021, numri i rasteve dhe përfshirja e sipërfaqeve pyjore nga zjarret pyjore ka shënuar një rritje të vazhdueshme. Kjo si shkak i temperaturave të larta dhe nga pakujdesia e njerëzve, si dhe aktivitetet në pastrimin e tokave bujqësore. Në vitin 2021 janë evidentuar 87 raste të zjarreve në pyje publike dhe private, të cilat kanë përfshirë një sipërfaqe pyjore rreth 2,653 ha.

Tabela 57: Numri i rasteve të zjarreve pyjore dhe sipërfaqja, 2021

Rajonet	Nr. i rasteve	Sip. në ha		Gjithsej ha
		Publike	Private	
Prishtinë	20	62	59	121
Mitrovicë	9	1,777	367	2,143
Pejë	2	6	0	6
Prizren	37	91	116	208
Ferizaj	9	83	2	84
Gjilan	10	61	29	91
Gjithsej	87	2,080	573	2,653

Burimi: APK

Prodhimtaria e fidanëve pyjor

Fidanishtja e Institutit të Pejës për vitit 2021, përveç çështjes në monitorimin e shëndetit të pyjeve përmes pikave bioindikative, është marrë edhe me kultivimin e fidanëve pyjor. Fidanët e prodhuar në fidanishte, kryesisht përdoren për pyllëzime dhe ripyllëzime në pyje dhe toka pyjore të moshës 2+0. Në këtë fidanishte për vitin 2021 janë prodhuar rreth 1,289,975 fidanë pyjor.

Tabela 58: Prodhimtaria e fidanëve, 2021

Lloji	Kultivimi	Nr. i fidanëve
Halorë	Klasik	634,582
Halorë	Industrial	495,000
Fletorë	Klasik	102,000
Fletorë	Industrial	58,393
Gjithsej		1,289,975

Burimi: APK

Pyllëzimet

Pyllëzimi i tokave pyjore është shumë i rëndësishëm me qëllim të rritjes së kualitetit të pyjeve, rregullimit të përbërjes, rritjes së qëndrueshmërisë në aspektin e shëndetit etj. Në kuadër të këtij objektivit me Planin vjetor për menaxhim të pyjeve 2021, janë realizuar pyllëzime vjeshtore të bazuara në programin e prodhimit të fidanëve. Këto aktivitete


kryesisht janë realizuar për dhënien në kryerjen e shërbimeve të pyllëzimeve përmes kontraktimit të ndërmarrjeve të licencuara në zbatimin e projekteve në pyllëzimin e rreth 309.30 ha.

Tabela 59: Pyllëzimet vjeshtore, 2021

Fidanët	Prishtinë	Mitrovicë	Pejë	Prizren	Ferizaj	Gjilan	Gjithsej	%
Industrial	60,750	5,500	0	55,531	95,000	90,536	307,317	39
Klasik	74,250	83,250	5,000	144,504	80,000	84,500	471,504	61
Gjithsej	135,000	88,750	5,000	200,035	175,000	175,036	778,821	100

Burimi: APK

Figura 32: Fidanët e përdorura për pyllëzime vjeshtore, 2021



Burimi: APK

4 Tregtia

4.1 Tregtia e përgjithshme

Shkëmbimi tregtar i Kosovës për periudhën 2017-2019, ka qenë i përafërt në vlerë. Në vitin 2021, eksporti i përgjithshëm (kapitujt 01-98), shfaqet në vlerë prej 749.7 mil. €, që kishte rritje 57.8% krahasuar me vitin 2020. Vlera e importit në periudhën 2017-2020 ishte mbi 3 mld. €, ndërsa në vitin 2021 është rritur në mbi 4.5 mld. €, që paraqet rritje në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 për 41.2%. Mbulueshmëria e Importit me Eksport ishte 16.1%.

Tabela 60: Eksporti-Importi i përgjithshëm

Vitet	Eksporti (1-98), në '000 €	Importi (1-98), në '000 €	Bilanci tregtar, në '000 €	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2017	378,010	3,047,018	-2,669,007	12.4
2018	367,500	3,347,007	-2,979,507	11.0
2019	383,491	3,496,431	-3,112,940	11.0
2020	474,959	3,296,323	-2,821,364	14.4
2021	749,720	4,653,050	-3,903,330	16.1

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.2 Tregtia e produkteve bujqësore

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore në vitin 2021 ishte 92.6 mil. €, që kishte rritje për 18.7% në krahasim me vitin 2020. Në vitin 2021 vlera e importit të produkteve bujqësore ishte 965.6 mil. €, që paraqet rritje për 26.2% në krahasim me vitin 2020.


Tabela 61: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore

Viti	Eksporti (1-24), në '000 €	Importi (1-24), në '000 €	Bilanci tregtar, në '000 €	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2017	61,336	694,517	-633,180	8.8
2018	63,950	712,314	-648,364	9.0
2019	65,510	759,359	-693,849	8.6
2020	78,076	765,357	-687,281	10.2
2021	92,642	965,569	-872,927	9.6

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ ashtu si edhe viteve tjera, në këtë rast në vitin 2021 bilanci negativ është shfaqur në vlerë prej 872.9 mil. €, ndërsa mbulueshmëria e importit me eksport është në shkallë prej 9.6%.

Tabela 62: Eksporti, Importi dhe Bilanci tregtar i produkteve bujqësore (1-24), në '000




Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Pjesëmarrja më e madhe e eksportit të produkteve bujqësore (01-24) në eksportin e përgjithshëm (1-98) ishte në vitin 2018 dhe 2019 me 17%. Pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm në vitin 2021 ishte 12%.

Pjesëmarrja më e ulët e importit të produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm ishte në vitin 2018 dhe 2021 me pjesëmarrje prej 21%, ndërsa pjesëmarrja më e lartë ishte në vitin 2017 dhe në vitin 2020 me 23%.

Tabela 63: Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm (majtas), Pjesëmarrja e produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm (djathtas)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.2.1 Tregtia sipas grupeve të shteteve

Eksporti i produkteve bujqësore në vitin 2021 kishte vlerë 92.6 mil. €, nga e cila 51.6 mil. € ishin nga vendet e CEFTA-s, 31.7 mil. € nga vendet e BE-së dhe 9.3 mil. € nga vendet e tjera. Vlera më e madhe e importit ishte nga vendet e BE-së (467.0 mil. €), pasuar nga vendet e CEFTA-s (266.6 mil. €) dhe vendet e tjera 232.0 mil. €. Sipas të dhënave të paraqitura më lartë del se në vitin 2021 bilanci tregtar ishte negativ në vlerë prej 872.9 mil.€.


Tabela 64: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve, 2021 në mil. €

	CEFTA	Vendet e BE-së	Vendet tjera	Gjithsej
Eksporti (1-24), në '000 €	51.6	31.7	9.3	92.6
Importi (1-24), në '000 €	266.6	467.0	232.0	965.6
Bilanci tregtar, në '000 €	-215.0	-435.3	-222.6	-872.9
Eksporti/Pjesëmarrja në %	55.7	34.2	10.1	100.0
Importi/Pjesëmarrja në %	27.6	48.4	24.0	100.0
Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)	19.4	6.8	4.0	9.6

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në dy figurat në vijim është paraqitur pjesëmarrja e eksportit dhe importit sipas grupeve të shteteve në vitin 2021. Vlerë më e madhe e eksportit është realizuar në vendet e CEFTA-s që kishte pjesëmarrje prej 55.7%, vendet e BE-së 34.2% dhe vendet tjera 10.1%. Importi më i madh ishte nga vendet e BE-së me pjesëmarrje prej 48.4%, nga vendet e CEFTA-s 27.6% dhe vendet tjera 24.0%.

Figura 33: Eksporti sipas grupeve të shteteve (majtas), Importi sipas grupeve të shteteve (djathtas), 2021 në %



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Tregtia me vendet e CEFTA-s

Vlera e eksportit në vendet e CEFTA-s ka pasur një rritje të lehtë për periudhën 2017-2020 dhe në vitin 2021 arriti vlerën prej 51.6 mil. €, që për dallim nga viti 2021 kishte rritje për

25.4%. Importi në vitin 2021 ishte 266.6 mil. €, ku është shënuar rritje në krahasim me vitin 2020 për 45.4%. Mbulueshmëria e importit me eksport ishte 19.4%.

Tabela 65: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore me vendet e CEFTA-s


Vitet	Eksporti (1-24), në '000 €	Importi (1-24), në '000 €	Bilanci tregtar, në '000 €	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2017	36,697	258,444	-221,747	14.2
2018	38,762	239,244	-200,482	16.2
2019	38,386	113,072	-74,686	33.9
2020	41,135	183,381	-142,246	22.4
2021	51,594	266,571	-214,977	19.4

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Pjesëmarrja më e madhe e eksportit në vendet e CEFTA-s paraqitet në vitin 2018 me 60.6%, ndërsa pjesëmarrja më e vogël e eksportit të produkteve bujqësore ishte në vitin 2020 (52.7%).

Importi nga vendet e CEFTA-s kishte pjesëmarrje më të madhe në vitin 2017 me 37.2%, ndërsa pjesëmarrje më e vogël ishte në vitin 2019 me 14.9%, që del të jetë edhe pjesëmarrje më e vogël e importit për këto vite nga vendet e CEFTA-s. Në vitin 2021, kjo pjesëmarrje është rritur në shkallë prej 27.6%.

Figura 34: Pjesëmarrja e CEFTA-s në eksportin bujqësor (majtas), Pjesëmarrja e CEFTA-s në importin bujqësor (djathtas)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore në shtetet e CEFTA-s në vitin 2021 paraqitet me rritje prej 25.4% për dallim nga viti 2020. Rritje të eksportit ka pasur në Serbi për 48.3%, Mali i Zi me rritje prej 42.3 %, Maqedonia e Veriut 32.1%, B. Hercegovina 16.1% dhe Shqipëria 15.9 %.

Vlera e importit të produkteve bujqësore nga shtetet e CEFTA-s në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, ka pasur rritje për 45.4%. Importi nga Serbia pati një rritje prej 89.3%, B.

Hercegovina 85.1%, vijuar nga Mali i Zi për 26.2 % dhe Shqipëria 18.7%. Rënie në vlerë të importit kishte nga Maqedonia e Veriut për 4.1% dhe Moldavia 55.9%.


Tabela 66: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore në vendet CEFTA-s, në '000 €

Vendet	Eksport			Import		
	2020	2021	Ndryshimi '21/'20, (%)	2020	2021	Ndryshimi '21/'20, (%)
B. Hercegovina	1,373	1,593	16.0	9,363	17,325	85.0
Mali i Zi	1,504	2,140	42.3	4,484	5,657	26.2
Maqedonia	9,428	12,452	32.1	61,207	58,715	-4.1
R. e Moldavisë	0	3	0.0	324	143	-58.2
Serbia	6,149	9,117	48.3	80,129	151,668	89.3
Shqipëria	22,680	26,289	15.9	27,857	33,062	18.7
Gjithsej	41,135	51,594	25.4	183,381	266,571	45.4

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Pjesëmarrje më të madhe në eksportin e vendeve të CEFTA-s ka pasur Shqipëria me 51.0%, Maqedonia e Veriut 24.1%, Serbia 17.7%, B. Hercegovina 3.1% dhe Mali i Zi 4.1%. Në vlerën e importit të produkteve bujqësore pjesëmarrje më të madhe kishin Serbia (56.9%), Maqedonia e Veriut (22.0%), Shqipëria (12.4%), B. Hercegovina (6.5%), Mali i Zi (2.1%), dhe Moldavia (0.1%).

Figura 35: Eksporti sipas vendeve të CEFTA-s (majtas), Importi sipas vendeve të CEFTA-s (djathtas), 2020



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Tregtia me vendet e BE-së

Nga viti 2017 vërehet një rritje e eksportit në vendet e BE-së, e kjo rritje ka vazhduar edhe në vitin 2021, ku u arrit vlera e eksportit prej 31.7 mil. €, që është vlera më e lartë e eksportit në vendet e BE-së, me një rritje prej 8.0% në krahasim me vitin 2020.

Në vitin 2021, vlera e importit nga vendet e BE-së ishte 467.0 mil. €, ku vërehet një rritje e vlerës së importit krahasuar me vitin 2020 për 15.4%.

Tabela 67: Eksporti-Importi i produkteve bujqësore me vendet e BE-së

Vitet	Eksporti (1-24), në '000 €	Importi (1-24), në '000 €	Bilanci tregtar, në '000 €	Mbulueshmëria e Importit me Eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2017	19,419	269,662	-250,243	7.2
2018	19,987	294,748	-274,761	6.8
2019	20,377	441,580	-421,203	4.6
2020	29,360	404,641	-375,282	7.3
2021	31,711	466,997	-435,286	6.8


Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

*Të dhënat e shkëmbimit tregtar për periudhën 2017-2021 janë për 27 shtete dhe dallojnë nga vitet tjera pasi që janë të prezantuara pa Britaninë e Madhe pas Brex-it nga BE në vitin 2020

Pjesëmarrja më e madhe e eksportit në vendet e BE-së në eksportin e përgjithshëm për kapitujt 01-24 ishte në vitin 2020 (37.6%), ndërsa pjesëmarrja në shkallë të ngjashme apo 31% ishte në periudhën 2017-2019. Në vitin 2021 kjo pjesëmarrje ishte 34.2%.

Pjesëmarrja më e lartë e importit nga vendet e BE-së në importin e përgjithshëm për kapitujt 01-24 ka qenë në vitin 2019 (58.2%), ndërsa ajo më e ulët paraqitet në vitin 2017 (38.8%). Në vitin 2021 kjo pjesëmarrje paraqitet me 48.4%.

Figura 36: Pjesëmarrja e BE-së në eksportin bujqësor (majtas), Pjesëmarrja e BE-së në importin bujqësor (djathtas)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR


*Të dhënat e shkëmbimit tregtar për periudhën 2017-2021 janë për 27 shtete dhe dallojnë nga vitet tjera pasi që janë të prezantuara pa Britaninë e Madhe pas Brex-it nga BE në vitin 2020

Rritje në vlerë të eksportit në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, më shumë vërehet tek shtetet siç janë: Austria për 46.1%, Kroacia 28.5%, Holanda 27.0%, Hungaria 20.4%, si dhe vende tjera që kishin ndryshime më të vogla. Rënie kishte vlera e eksportit në Rumani për 19.2% dhe në Itali 11.7%.

Tabela 68: Eksporti sipas vendeve të BE-së në '000 € (majtas) dhe Eksporti sipas vendeve të BE-së në % (djathtas)

	2020	2021	Ndryshimi '21/'20, (%)	Pjesëmarrja në %
Austri	1,363	1,992	46.1	6.3
Bulgari	2,758	2,923	6.0	9.2
Gjermani	11,603	11,910	2.6	37.6
Holandë	2,557	3,248	27.0	10.2
Hungari	335	403	20.4	1.3
Itali	3,140	2,772	-11.7	8.7
Kroacia	1,953	2,510	28.5	7.9
Rumani	1,178	952	-19.2	3.0
Suedi	1,653	1,803	9.1	5.7
Të tjera	2,821	3,198	13.4	10.1
Gjithsej BE 27	29,360	31,711	8.0	100.0

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR




Në vitin 2021, shtetet e prezantuara në tabelë përbejnë 89.9% të vlerës së eksportit të produkteve bujqësore në BE, ndërsa vendet tjera të BE-së kishin pjesëmarrje në vlerën e eksportit në shkallë prej 10.1%, ashtu siç mund të shihen në figurën e mësipërme: Gjermania kishte pjesëmarrje prej 37.6%, Holanda 10.2%, Bullgaria 9.2% si edhe shtetet tjera të paraqitura në këtë figurë.

Shtetet e paraqitura në tabelën e mëposhtme përbëjnë 90.73% të vlerës së importit të produkteve bujqësore nga vendet e BE-së dhe pjesa tjetër e importit prej 9.27% vjen nga shtetet tjera të BE-së. Përqindje më e madhe e rritjes së vlerës së importit në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 shfaqet tek këto shtete: Holanda ka pasur rritje për 46%, Gjermania 31% dhe Italia 22%. Rënie në vlerë për 34% të importit ka pasur nga Bullgaria si dhe nga vendet tjera të BE-së për 1%.

Tabela 69: Importi sipas vendeve të BE-së, në '000 €

	2020	2021	Ndryshimi '21/'20, (%)	Pjesëmarrja në %
Gjermani	56,248	73,460	31	16
Poloni	52,199	66,288	27	14
Itali	48,245	58,679	22	13
Kroaci	50,313	57,522	14	12
Sloveni	34,295	38,207	11	8
Austri	19,628	24,766	26	5
Bullgari	36,033	23,805	-34	5
Greqi	18,819	23,805	26	5
Holandë	16,268	23,770	46	5
Hungari	28,869	33,415	16	7
Të tjera	43,723	43,282	-1	9
Gjithsej BE 27	404,641	466,997	15	100

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR



Në figurën e mësipërme janë shfaqur shtetet dhe pjesëmarrja e tyre në importin që Kosova ka pasur nga vendet e BE-së në vitin 2021, ku mund të vërehet se Gjermania kishte pjesëmarrje më të madhe nga të gjitha shtetet e BE-së në shkallë prej 16%, Polonia 14%, Kroacia dhe Italia me pjesëmarrje prej 13% si dhe vendet tjera si në figurë.

Tregtia me vendet e treta

Kosova në vitin 2021 ka pasur shkëmbinim tregtar për produktet bujqësore edhe nga vendet e treta. Duke shikuar trendin e eksportit dhe importit nga këto vende, vërehet se Kosova ka rritje të importit dhe rritje të lehtë edhe të eksportit nga viti në vit. Në vitin 2021 eksporti në vendet e tjera ishte 9.3 mil.€ dhe kishte rritje për 23.2% krahasuar me vitin 2020.

Tabela 70: Importi dhe Importi nga Vendet e Treta

Viti	Eksport (01/24), në '000 €	Import (01/24), në '000 €	Bilanci tregtar në '000 €	Mbulushnëria e importit me eksport (%)
	1	2	3=1-2	4=1/2
2017	5,220	166,411	-161,191	3.1
2018	5,202	178,322	-173,121	2.9
2019	6,747	204,707	-197,960	3.3
2020	7,581	177,334	-169,753	4.3
2021	9,337	232,001	-222,663	4.0


Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

*Të dhënat e shkëmbimit tregtar të Kosovës me Vendet tjera për periudhën 2017-2021 dallojnë nga vitet tjera pasi që janë të prezantuara me Britaninë e Madhe pas Brex-it nga BE në vitin 2020

Eksporti i produkteve bujqësore në vitin 2021 i realizuar në Vendet e Treta ishte 9.3 mil. €. Shtetet me pjesëmarrje më të madhe në eksport në këtë grup të shteteve ishin: Zvicra 29%, Mbretëria e Bashkuar 23%, Turqia 12% dhe SHBA me 14%, si dhe të tjera me pjesëmarrje prej 22%.

Importi i produkteve bujqësore nga Vendet e Treta në vitin 2021 ishte 232.0 mil €, që në krahasim me vitin 2020 ka pasur rritje për 30.8%. Shtetet me pjesëmarrje më të madhe janë: Turqia me 35%, vijuar nga Brazili 21%, Argjentina 5%, Sri Lanka 4%, Mbretëria e Bashkuar 4% dhe të tjera vende nga ky grupim i shteteve që kishin pjesëmarrje 31%.

Figura 37: Eksporti në Vendet e Treta, (majtas) dhe Importi nga Vendet e Treta, në % (djathtas)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.2.2 Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)

Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)

Eksporti i produkteve bujqësore për kapitujt 01-24 në vitin 2021 ishte 92.6 mil. € dhe për dallim nga viti 2020 kishte një rritje prej 18.7%. Ndryshim më të madh pozitiv të vlerës së eksportit në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 kanë pasur kapitujt: 05, 24, 16, 03, 02 dhe 21. Kapitujt të cilët kanë shënuar rënie të vlerës së eksportit janë: 07, 06, 12 dhe 10. Kapitujt e tjerë të paspecifikuar kishin rritje nën 100%.

Tabela 71: Eksporti i produkteve bujqësore 2016-2020, në '000 €

Kodi	Përshkrimi	2017	2018	2019	2020	2021
01	Kafshët e gjalla	-	17	-	-	0
02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve	183	127	333	337	654
03	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore	172	110	106	111	216
04	Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore,	492	471	758	841	1,211
05	Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	-	-	134	4	118
06	Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative	165	226	1,170	1,641	1,468
07	Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve	4,899	5,636	5,307	8,869	6,415
08	Pemët dhe aroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit	8,616	8,781	7,675	9,681	11,391
09	Kafe, çaj, krem dhe erëza	3,677	3,971	4,319	5,890	6,147
10	Drithërat	262	386	118	513	505
11	Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri	4,254	2,411	913	1,133	1,872
12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere	1,558	2,414	3,481	4,064	3,648
13	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale	-	-	0	-	-
14	Materialet vegjetale që përdoren për thurje; produktet vegjetale të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	-	1	5	-	8
15	Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to; yndyrat e ngrënshme të përgatitura; dyllet bimore apo shtazore	179	343	1,363	1,433	1,695
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, molusqeve apo kafshëve të tjera jokurrizore ujore	618	776	872	1,817	4,037
17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	652	712	696	846	990
18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	1,909	1,763	1,821	1,449	1,987
19	Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pasticërisë	1,925	1,893	1,785	1,667	2,130
20	Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve apo pjesëve të tjera të bimëve	6,171	4,507	4,556	6,378	8,798
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	352	612	601	638	1,229
22	Pijet, alkoolet dhe uthulla	24,194	27,565	28,666	29,667	36,638
23	Mbetjet nga industritë ushqimore; ushqim foragjer i përgatitur për kafshë	1,060	1,228	709	1,093	1,452
24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	-	-	122	5	32
Gjithsej (01-24)		61,336	63,950	65,510	78,076	92,642

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24)

Importi i përgjithshëm i produkteve bujqësore për kapitujt 01-24 në vitin 2021 ishte në vlerë prej 965.6 mil. €, që krahasuar me vitin 2020 kishte rritje për 26.2%. Rënie në vlerë të importit për 8% ka pasur në produktet e kapitullit 10 (drithërat) si dhe kapitullin 11 (Produktet e industrisë bluajtëse, maja e elbit apo drithërave tjera, niseshte, inulinë, gluten gruri), që kishte rënie për 23%. Në gjithë kapitujt e tjerë kishte rritje të vlerës së importit.

Tabela 72: Importi i produkteve bujqësore 2016-2020, në '000 €

Kodi	Përshkrimi	2017	2018	2019	2020	2021
01	Kafshët e gjalla	10,873	15,502	19,673	30,236	49,285
02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve	61,986	64,878	74,391	60,824	82,618
03	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore	2,640	2,999	3,603	4,236	5,227
04	Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecificuara diku tjetër	45,069	47,672	49,793	50,800	58,504
05	Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecificuara diku tjetër	915	986	1,313	1,098	1,745
06	Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative	4,847	4,566	4,813	5,926	6,757
07	Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve	22,934	24,742	28,171	24,957	31,150
08	Pemët dhe aroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit	35,069	34,415	36,464	39,185	43,365
09	Kafe, çaj, krem dhe erëza	33,629	31,163	30,051	27,839	32,053
10	Drithërat	31,697	36,434	39,275	41,893	38,645
11	Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri	10,822	9,187	10,559	13,689	10,588
12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere	9,409	10,703	10,434	9,852	11,195
13	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegetale	368	534	447	386	405
14	Materialet vegetale që përdoren për thurje; produktet vegetale të pa përfshira dhe të paspecificuara diku tjetër	7	10	8	14	31
15	Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to; yndyrat e ngrënshme të përgatitura; dyllet bimore apo shtazore	28,362	27,930	30,054	32,135	41,398
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, molusqeve apo kafshëve të tjera jokurrizore ujore	27,338	26,677	29,853	31,754	36,631
17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	35,568	28,296	30,377	30,795	38,063
18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	23,485	23,888	24,648	25,509	30,221
19	Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pastičerisë apo prej brumërave	62,925	64,618	66,239	69,975	88,803
20	Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroveve apo pjesëve të tjera të bimëve	26,373	27,321	28,847	28,130	36,892
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	64,124	68,105	74,635	75,852	90,955
22	Pijet, alkoolet dhe uthulla	75,220	77,152	80,667	76,266	115,123
23	Mbetjet nga industritë ushqimore; ushqim foragjer i përgatitur për kafshë	18,736	19,688	16,251	20,903	29,391
24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	62,122	64,848	68,793	63,101	86,522
Gjithsej (1-24)		694,517	712,314	759,359	765,357	965,569

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

5 Siguria, standardet dhe cilësia e ushqimit

Nga Drejtoria e Shëndetit publik dhe mirëqenies së kafshëve - Sektori i Shëndetit të Kafshëve (SShK) janë realizuar këto aktivitete: Është përcjellë situata Epizootologjike në lidhje me prezencën e sëmundjeve të kafshëve për gripin e shpezëve dhe sëmundjet tjera duke u bazuar në informatat dhe raportet e OIE-së dhe ADIS. Është bërë shpërndarja, monitorimi dhe realizimi i programeve për vaksinimin e kafshëve në terren. Në vitin 2021 janë realizuar 18,492 teste për sëmundjen e TBC-së në gjithë territorin e Kosovës si dhe janë realizuar aktivitete tjera që janë paraqitur në tabelat në vijim:

Tabela 73: Shpërndarja e vaksinave sipas sëmundjeve të kafshëve

Emërtimi	Sëmundjet e kafshëve				
Lloji i vaksinimit	Brucelozë	Tërbim	MKD/CSF	Anthrax	Vaksinimi Tërbim kafshët e egra nga ajri
Emri i vaksinës	Ocurev/Rev1	Biocan/Bioveta	Pestisen /Bioveta	Romvac	Biocan/Bioveta
Sasia e vaksinës së shpërndarë	90,000 doza	19,000 doza	20,500 doza	0	500,000 karem vaksina nga ajri dhe 250 karem vaksina me dorë
Lloji i kafshëve të vaksinuara	Dele & dhi	Qen	Derra	Gjedhe, Dele, dhi	Kafshët e egra dhelprat
Numri i kafshëve të vaksinuara	57,887	14,200	7,337	0	500,000 karrem vaksina

Burimi: AUV

Tabela 74: Marrja e mostrave të gjakut për analiza laboratorike

Emërtimi i analizave laboratorike	Lloji i kafshëve	Nr. mostrave të marra
Analizat patologjike	Gjedhe, dele, dhi, shpezë	43
Analizat serologjike, dyshimi për sëmundjen e kafshëve në terren	Gjedhe, dele, dhi	364
Karantina	Gjedhe	222
Analiza për New castle	Pula	74
Analiza për Avian Influenza	Pula	106
Analizat bakteriologjike	Bletë, kafshë tjera	25
Analizat Tërbim	Dhelpra	2
Analizat ASF	Derra të egër	4
Pesta Amerikane	Bletë	405
PNMSK -Bruceloza, IBR, BVD Bluetonguae	Gjedhe, dele, dhi	5,796

Burimi: AUV

Tabela 75: Asgjësimi i kafshëve sipas sëmundjeve infektive dhe shuma e kompensimit të fermerëve

Emërtimi i sëmundjes	Lloji i kafshës	Të asgjësuar/krerë	Kompensimi i fermerëve/ €
Brucela abortus	Gjedhe	66	99,000
Bruceloze	Dele	32	3,200
TBC	Gjedhe	121	181,500
Pesta Amerikane	Bletë	73	7,300
Gripi i shpezëve	Pula	80,304	240,912

Burimi: AUV

Tabela 76: Lëshimi i lejeve të importit

Lloji i lejeve të importit	Gjithsej
Importi i kafshëve të gjalla për therrje	313
Importi i ushqimit për kafshë	205
Importi i materialit gjenetik	11
Importi i gjedheve për reproduksion	13
Importi i zogjëve një ditor	46
Importi i derrave për therje	5
Importi i derrave për reproduksion / majmëri	1
Importi i bletëve	1
Importi i kuajve për rekreacion	1
Importi viçave për majmëri	15
Gjithsej	613

Burimi: AUV

Tabela 77: Licencimi i subjekteve afariste

Nr.	Lloji i licencave	Gjithsej
1	Licencimi i ambullantave veterinare, vazhdimi i licencave	15
2	Licencimi i depove të lëkurave	1

Burimi: AUV

Nga Sektori i Inspektoratit Veterinar Kufitar janë marrë 333 mostra për të testuar produktet e importuara në parametra sipas planit të kontrolleve zyrtare sa i përket analizave mikrobiologjike, fiziko-kimike, përcaktimi i metaleve të rënda, mostër për analiza radiologjike, mostër për testim në aflatoksinë si dhe analiza tjera që janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 78: Analizat për testimin e produkteve të importuara dhe nr. i mostrave

Lloji i analizave të kërkuara	Numri i mostrave
Analiza mikrobiologjike	135
Analiza fiziko-kimike	97
Përcaktimi i metaleve të rënda	3
Mostër për analiza radiologjike	1
Mostër për testim në aflatoksinë	28
Histamin	20
Përcaktimi i prezencës së qumështit pluhur në UHT	22
Prezenca e padeklaruar e yndyrës bimore	24
Përcaktimi i authencitetit	3
Gjithsej	333

Burimi: AUV

Sektori i Fitosanitar Kufitar gjatë periudhës raportues ka kryer kontrollet inspektuese të cilat janë realizuar bazuar në Planin Kombëtarë Vjetor të Kontrolleve Zyrtare 2021, aktivitetet sipas rasteve të identifikuar ndërkohë, pranim të informatave nga Njësia e Përbashkët për Inteligjencë, Analizë të Rrezikut dhe Kërcënimeve, pranimi i notifikimeve dhe gjurmueshmëria e rasteve në kuadër të RASFF (Rapid Alert System for Food and Feed).

Tabela 79: Tabela e aktiviteteve të sektorit Fitosanitar kufitar

			Importi			Analiza			Refuzuar				
Nr. Lëndëve-Importe	Leje importi për cigare edhe duhan	Europaleta copë	T/L	Masa drunore / m ³	Bimë / copë	Nr. i lëndëve në analizë	Rez. negative	Rez. pozitive	Nr. i lëndëve të refuzuara	T/L	Masa drunore / m ³	Bimë / copë	Nr. i lëndëve tranzit

Burimi: AUV

Drejtoria e laboratorit të ushqimit dhe veterinarisë, ka pasur aktivitete të cilat janë të paraqitura në tabelën në vijim:

Tabela 80: Marrja e mostrave dhe dërgimi i tyre në Laborator

Mostra të testuara - parametrat sipas tremujorve T1-T4 (Janar -Dhjetor) 2021				
Parametrat e analizuar	Nr. i Mostrave			
	T1-2021	T2-2021	T3-2021	T4-2021
Analiza fitopatologjike	87	46	59	98
Analiza entomologjike	12	31	23	4
Analiza fiziko-kimike	241	229	279	306
Analiza mikrobiologjike	9	22	11	15
Analiza në metale të rënda	11	16	22	14
Analiza në mbetje të pesticideve	25	78	21	/
Analiza në radioaktivitet	/	1	/	/
Analiza në aflatoksinë	12	30	31	19
Gjithsej	398	453	446	456

Burimi: AUV

Gjatë këtij viti nga Sektori i Mikrobiologjisë së Ushqimit janë përfshirë për testim 387 mostra, (produkte të mishit-232, produkte të qumështit-129, vezë-21, PT-5) në parametrat mikrobiologjik Salmonella spp., Listeria monocytogenes, Escherichia coli, Enterobacteriaceae, Total i mikroorganizmave aerob në 2,327 teste.

Tabela 81: Aktivitetet e kryera nga Sektori i Mikrobiologjisë së Ushqimit

Mostrat	Gjithsej
Të pranuar	387
Të futura për testim	387
Të testuara	386
Të bartura nga viti paraprak	63
Të bartura në vitin në vijim	1
Jashtë kriterit të pranueshmërisë	46

Burimi: AUV

Në Sektorin e Kimisë Ushqimore janë kryer aktivitete si në tabelën në vijim:

Tabela 82: Mostrat e testuara në Kiminë Ushqimore

Lloji i mostrës sipas matriksit për testim	Nr. i mostrave të testuara
Drithëra, kikirik, ushqim për kafshë	177
Qumësht dhe produkte të qumështit	176
Vezë	80
Peshk	25
Urinë	2
Mish gjedhi	9
Mish pule	2
Mjaltë	7
Gjithsej	478

Burimi: AUV

Tabela 83: Parametrat e testuar sipas aparaturave

Viti 2021	Raporti - sipas aparaturave			
	Bactoskan	Milkoscan	Fosomatik	Gjithsej
Gjithsej	20,200	15,269	18,594	54,063

Burimi: AUV

Sektori i patologjisë ka analizuar në aspektin e patologjisë mostrat e pranuar, e të cilat janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela 84: Lloji dhe numri i analizave të sektorit të patologjisë

Ekzaminimet në laboratorin e patologjisë	Nr. i mostrave të testuara
Ekzaminimi anatomopatologjik dhen/qengja/dhi dhe keca	7
Ekzaminimi anatomopatologjik dhi dhe keca	6
Ekzaminimi anatomopatologjik në shpendë (pula/zogj pule, gjeldeti, thellëza, pata, shota)	380
Ekzaminim anatomopatologjik derr i egër	5
Ekzaminim anatomopatologjik dhelpra	2
Gjithsej	400

Burimi: AUV

Sektori i Serologjisë dhe Diagnostikës Molekulare gjatë vitit 2021 ka kryer këto aktivitete: janë pranuar gjithsej 6,865 mostra, ku kanë qenë 4,231 mostra të gjedhit dhe 77 nga qenët. Nga tereni dhe karantina kanë ardhur gjithsej 2,119 mostra.

Numri i testeve të kryera janë gjithsej 9,109 teste, ku një numër i mostrave janë testuar për më shumë se një parametër. Pjesa më e madhe e mostrave janë testuar për brucelozë (5,638 mostra gjedhi). Kanë marrë pjesë në 5 teste të proficiencës me gjithsej 15 metoda.

Tabela 85: Numri i mostrave të testuara, 2021

Ardhja e mostrave		Gjithsej
Plani nacional	Gjedhe	4,231
	Dele dhi	
	Titri vaksinal bruceलोze	
	Qen	77
Tereni		1,472
Karantina		647
Autenticitet		10
Nekropsi		302
PT		126
Gjithsej		6,865

Burimi: AUV

5.1 Emetimi i gazrave serrë

Ndryshimet klimatike i referohen ndryshimeve afatgjata të temperaturave dhe motit në globin tokësor në përgjithësi. Disa nga këto ndërrime mund të jenë të natyrshme, por që nga vitet 1800, aktivitetet njerëzore kanë qenë shtytësi kryesor i ndryshimeve klimatike, kryesisht për shkak të djegies së lëndëve djegëse fosile si qymyri, nafta dhe gazi.

Djegia e lëndëve djegëse fosile vazhdimisht është duke rritur emetime të gazrave serrë të cilat po veprojnë si një mbështjellës rreth Tokës, duke bllokuar nxehtësinë e diellit, duke rritur temperaturat dhe duke shkaktuar ndryshime klimatike. Faktorët kryesor që mund të përmenden janë: përdorimi i karburanteve dhe qymyrit, pastrimi i tokës dhe pyjeve gjithashtu mund të çlirojnë dioksid karboni, deponitë e mbeturinave që po ashtu janë burim kryesor i emetimeve të metanit. Energjia, industria, transporti, ndërtesat, bujqësia dhe përdorimi i tokës janë ndër emetuesit kryesor.

Deri sa emetimet vazhdojnë të rriten, si rezultat, Toka tani është rreth 1.1°C më e ngrohtë se sa ishte në fund të viteve 1800. Dekada e fundit (2011-2020) ishte më e ngrohta e regjistruar³.

Pasojat e ndryshimit të klimës tani përfshijnë, ndër të tjera, thatësira intensive, mungesë uji, zjarre të rënda, rritje të nivelit të detit, përmblyje, shkrirje të akullit polar, stuhi katastrofike dhe rënie të biodiversitetit. Emetimet që shkaktojnë ndryshimet klimatike vijnë nga çdo pjesë e botës dhe prekin të gjithë, por disa vende prodhojnë shumë më tepër se të tjerët, kështu që 100 vendet me më pak emetim gjenerojnë 3% të totalit të emetimeve, derisa 10 vendet me emetimet më të mëdha kontribuojnë me 68%.

Sistemi i menaxhimit të gazrave serrë (GHG) në Kosovë udhëhiqet nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), ajo i raporton institucioneve vendore dhe të jashtme për politikën e zhvillimit dhe politikën e mbikëqyrjes.

Emetimet e përgjithshme vjetore të gazrave serrë në Kosovë për vitin 2019 janë vlerësuar rreth 9,613 Gg (Giga gram) CO₂ eq, (equivalent) ose rreth 9.6 milion tonë CO₂ eq. Burimi

³ <https://www.un.org/en/climatechange/what-is-climate-change>

kryesor i emetimeve të gazrave serrë është sektori i energjisë me pjesëmarrje prej 86% të totalit të emetimeve. Sektori i dytë është ai i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës me 8%. Sektori i mbeturinave përfaqëson 5% të totalit të emetimeve kurse sektori i proceseve industriale dhe përdorimit të produkteve me rreth 1%.

Tabela 86: Emetimet e përgjithshme të gazrave të serrës në Kosovë sipas sektorëve, 2019


Emetimet e GHG	Gg CO2 eq.
Energjia	8,624
Proceset industriale dhe përdorimi i produkteve	130
Bujqësia, pylltaria dhe përdorimi i tokave	773
Mbeturinat	457
Totali i emetimeve	9,613

Burimi: Raport, Emetimi i Gazrave Serrë në Kosovë 2019

Totali i emetimeve të gazrave serrë në Kosovë është i varur shumë nga sasia e energjisë së prodhuar nga thëngjilli që është burimi kryesor i emetimeve të gazrave të serrës në vendin tonë. Trendi i emetimeve totale të gazrave në Kosovë në periudhën 2014-2019 krahasuar me shtetet tjera në Evropë, është më i ulët (5 ton CO2 ekuivalent), për kokë banori se sa mesatarja e Bashkimit Evropian, por më i lartë se në disa nga vendet e rajonit. Ndërsa sa i përket emetimeve të CO2 për njësi të BPV (Bruto Prodhimi Vendor), Kosova me 0.5 kg CO2 ka emetime më të larta se mesatarja e Bashkimit Evropian dhe më të larta se sa vendet tjera të regjionit përjashtuar Bosnje dhe Hercegovinën.

Sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokave, përfshin rreth 8% të emetimit të përgjithshëm të gazeve serrë në Kosovë. Në vitin 2019, janë regjistruar rreth 706 Gg CO2 eq., përkatësisht 706 mijë tonë CO2 eq.

Figura 38: Emetimi i GHG sipas sektorëve, 2019 (%)



Burimi: Raport, Emetimi i Gazrave Serrë në Kosovë 2019

Sektor i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokave i takon kategorisë së tretë (3) të emetimeve të gazrave të serrës sipas IPCC dhe përbëhet nga tri nën sektorë (kategori) tjera.

Nën sektori i parë 3A përfshinë emetimin nga bagëtia. Këtu bëjnë pjesë kryesisht emetimet nga fermentimi enterik (procesi digjestiv i kafshëve) dhe emetimet nga menaxhimi i plehrave të kafshëve. Nga ky nën sektor vijnë rreth 545 Gg CO₂ eq. në vit ose 77% e totalit të emetimeve. Emetimet e gazrave serrë për këtë nën sektor janë kalkuluar sipas metodologjisë IPCC, duke zbatuar faktorët e emisionit sipas metodologjisë përkatëse.

Nën sektori i dytë 3B trajton akumulimin e CO₂ nga tokat pyjore dhe tokat tjera, si dhe emetimet që rrjedhin nga konvertimi i tokës nga një kategori tek tjetra. Është i vetmi sektor që bënë reduktimin (akumulimin) e emetimeve të CO₂ me rreth -39 Gg CO₂ të kalkuluar gjatë vitit 2019. Emetimet dhe akumulimet e CO₂ për këtë kategori janë kalkuluar sipas metodologjisë IPCC 2006, duke zbatuar faktorët e emisionit relevant, duke llogaritur ndërrimet në stoqet e karbonit sipas kategorive të shfrytëzimit të tokave, dhe përmes zbatimit të matricës së konvertimit të tokave sipas kategorive.

Nën sektori 3C trajton emetimet nga fertilizimi i tokës dhe nga djegia e biomasës. Kategoritë më të rëndësishme të këtij nën sektori janë emetimet indirekte të oksidit të azotit që lidhen me menaxhimin e plehrave dhe fertilizimin e drithërave. Gjithsej, ky nën sektor emeton rreth 156 Gg CO₂ eq. në vit, ose rreth 22% të totalit të emetimeve. Emetimet e gazrave serrë për këtë sektorë janë kalkuluar sipas metodologjisë IPCC, duke zbatuar faktorët e emisionit sipas metodologjisë përkatëse.

Sipas nën kategorive, fermentimi enterik (procesi digjestiv i kafshëve), përbën 67% të emetimeve ose 476 Gg CO₂ eq., i pasuar nga emetimet direkte të N₂O nga menaxhimi i tokës (dheut) me 12% (89 Gg CO₂ eq.), si dhe emetimet nga menaxhimi i plehut të kafshëve me rreth 10% (69 Gg CO₂ eq.). Në tabelën më poshtë janë dhënë detaje të emetimeve sipas nën kategorive të këtij sektori.

Metani (CH₄) me pjesëmarrje prej rreth 86% të totalit, është gazi kryesor i emetuar që vjen kryesisht nga nën kategoria e fermentimit enterik, menaxhimi i plehut të kafshëve dhe djegia e biomasës, i pasur nga Oksidi i Dyazotit (N₂O) me 11%, që emetohet nga nën kategoritë që kanë të bëjnë me menaxhimin e plehut të kafshëve dhe menaxhimin e tokës dhe Dioksidi i Karbonit (CO₂) me 3%, që emetohet kryesisht nga përdorimi i UREA-s.


Tabela 87: Burimet kryesore të emetimeve të gazrave serrë në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokave sipas sektorëve dhe nën sektorëve për vitin 2019

Kategoritë e emetimeve	Nën kategoritë e emetimeve	CO2 Gg eq	%	Gazat e emetuara sipas kategorive		
				CO2	CH4	N2O
3. A- Bagëtia	Fermentimi Enterik (procesi digjestiv i kafshëve)	476	67	-	+	-
	Menaxhimi i plehut te kafshëve	69	10	-	+	+
3. B-Toka	Tokat pyjore	-39				
	Tokat tjera (bujqësore, kullotat, etj)	5	1	+	-	-
3. C -Burimet e agreguara dhe burimet e emetimit të jo-CO2 në tokë	Emisionet direkte të N2O nga menaxhimi i tokës (dheut)	89	12	-	-	+
	Emisionet indirekte të N2O nga menaxhimi i tokës (dheut)	33	5	-	-	+
	Emisionet indirekte të N2O nga menaxhimi i plehut të kafshëve	9	1	-	-	+
	Aplikimi i UREA-s	19.5	3	+	-	-
	Djegia e biomasës	5.5	1	-	+	+
Totali i emetimeve		706	100	3%	86%	11%

Burimi: Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Inventari i Emetimeve të Gazrave Serrë në Kosovë

Bazuar në të dhënat e paraqitura në figurën në vijim vërejmë se trendi i emetimeve për periudhën 2007-2019, ka pasur ndryshime mes periudhave kohore. Prirje e përafërt e rritjes së emetimeve të gazrave të serrës nga sektori i bujqësisë ishte nga viti 2007 deri në vitin 2012, pasuar me një rënie në vitin 2013. Rritje paraqitet nga viti 2014, duke vazhduar me trend të ngjashëm përgjatë periudhës 2014-2019.

Figura 39: Trendi i emetimeve totale të gazrave të serrës nga sektori i bujqësisë 2007-2019



Burimi: Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Inventari i Emetimeve të Gazrave Serrë në Kosovë

6 Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural

6.1 Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2021 ka vazhduar të mbështes sektorin e bujqësisë përmes programit të Pagesave Direkte.

Mbështetja përmes pagesave direkte është bërë për:

- Kultura bujqësore (mbështetja bëhet për hektarë, me përjashtim të mjedrës që është bërë në bazë të sasisë si dhe për grurin që përveç hektarëve mbështetja është bërë edhe për sasinë e grurit në kg);
- Krerë blegtoral (mbështetja bëhet për krerë, ndërsa tek qumështi në bazë të kategorisë së cilësisë mbështetja bëhet për litër);
- Inpute (fidanë të prodhuara të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit);
- Mbështetja për verë të prodhuar dhe sigurim bujqësor për mjedër, mollë, kumbull, rrush, dredhëz, spec dhe arrë.

Në kuadër të Programit të Zhvillimit Rural 2020/2021 ka qenë e paraparë që në vitin 2021 të realizohet thirrja e dytë për aplikim, thirrje e cila është mbyllur në muajin mars. Në muajin korrik 2021 me vendimin me ref. KM 609/21 është anuluar kjo thirrje për aplikim për shkak të prioritizimit të aktiviteteve tjera nga MBPZhR, nevojës për shpalljen e PPD 2021 dhe duke marrë për bazë edhe gjendjen e krijuar në sektorin e bujqësisë për shkak të pandemisë COVID 19 dhe humbjeve të vazhdueshme të shkaktuara nga dëmet natyrore në bujqësi.

Në vitin 2021, buxheti i planifikuar për pagesa direkte ka qenë 21.6 mil. €. Pjesë e programit të pagesave direkte kanë qenë sektorët e paraqitur në tabelën e mëposhtme së bashku me detajet e pagesave për njësi të subvencionuar.

Tabela 88: Buxheti i planifikuar për pagesa direkte, 2021


		Buxheti i planifikuar	Subvencionimi për njësi
1	Grurë	4,187,713.50	75 €/ha; 0.019 €/kg
2	Farë gruri	131,751.30	250 €/ha
3	Elb	39,108.60	150 €/ha
4	Thekër	17,361.00	150 €/ha
5	Tërshërë	117,509.40	150 €/ha
6	Misër	2,540,000.00	150 €/ha
7	Luledielli	3,610.80	150 €/ha
8	Vreshta ekzistuese	1,842,870.00	1000 €/ha; 700 €/ha; 500 €/ha; 400 €/ha
9	Verë	137,070.90	0.04 €/litër
10	Pemishte ekzistuese	1,119,719.90	400 €/ha
11	Mjedër	162,315.90	0.12 €/kg
12	Fidanë	47,508.12	0.20 €/copë 0.15 €/copë 0.10 €/copë
13	Perime	1,650,422.60	400 €/ha; 500 €/ha
14	Bimë mjekësore dhe aromatike	114,512.40	450 €/ha
15	Bujqësi organike	412,231.20	50 €/ha + subvencionimi bazë
16	Lopë dhe buallica qumështore	3,417,603.77	85 €/ krerë
17	Dele	1,914,960.00	20 €/ krerë
18	Dhi	206,112.00	20 €/ krerë
19	Bletë	2,076,237.00	15 €/ koshere; 30 €/koshere
20	Qumësht	758,792.20	0.06 €/litër; 0.04 €/litër; 0.02 €/litër
21	Pula vojse	333,175.61	0.50 €/pulë vojse; 0.40 €/pulë vojse
22	Thëllëza	7,103.40	0.50 €/thëllëzë
23	Dosa	23,340.00	20 €/ krerë
24	Therje të raportuara të gjedhit	14,580.40	50 €/ krerë
25	Akuakulturë	20,393.00	0.20 €/kg
26	Primi i sigurimit bujqësor	30,000.00	75%
27	Viça për majmëri	300,000.00	10 €/ krerë
Gjthsej		21,626,003.00	

Burimi: Programi për Pagesa Direkte 2021

6.2 Pagesat direkte/subvencionet

Në vitin 2021 në kuadër të PPD-së aplikuan gjithsej 25,742 fermerë, prej të cilëve përfitues u shpallën 24,958 (97%), ndërsa 3% e aplikuesve u refuzuan për mosplotësim të kriterëve apo mungesë të dokumenteve.


Figura 40: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve në vitin 2021



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Në vitin 2021 totali i mbështetjes përmes pagesave direkte ishte 28.9 mil € dhe u mbështetën gjithsej 27 sektorë.

Figura 41: Pagesat direkte 2017-2021, në 1000 €



Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR; Në vitin 2020 është e përfshirë edhe mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike.


Tabela 89: Pagesat direkte 2017-2021, në €

	2017	2018	2019	2020*	2021
Grurë	5,781,300	6,550,929	5,292,996	14,079,396	3,287,048
Farë gruri	122,003	114,204	140,395	434,540	131,913
Misër	3,311,579	3,227,784	4,122,464	8,547,885	2,840,082
Elb	38,662	77,688	73,194	132,645	308,040
Thekër	16,957	29,343	29,423	58,623	79,845
Tërshërë	-	-	139,161	396,261	249,689
Luledielli	7,946	749	14,621	12,036	2,946
Vreshta ekzistuese	2,266,235	2,580,250	2,988,810	6,160,400	2,520,246
Perime	2,244,228	2,693,021	2,488,506	5,525,712	2,764,378
Pemishte ekzistuese	1,599,496	1,905,548	1,656,812	3,805,736	1,814,448
Mjedra	-	-	71,883	168,854	103,766
Verë	55,024	190,774	389,375	228,452	731,900
Bimë mjekësore dhe aromatike	-	-	-	111,479	26,933
Bujqësi organike	35,373	277,578	524,900	1,672,210	81,150
Lopë qumështore	4,777,500	4,746,770	4,373,460	9,421,300	4,893,535
Buallica	-	-	17,920	48,580	2,635
Dele dhe dhi	2,112,810	2,298,615	2,411,520	5,129,550	2,995,680
Bletë	2,295,555	2,471,085	3,070,950	6,996,810	2,888,265
Pula Vojse	435,035	484,343	537,497	1,165,861	500,676
Thëllëza	29,013	18,280	14,044	23,678	8,123
Dosa	17,180	27,320	28,100	75,080	20,840
Qumësht	1,712,609	1,736,944	2,041,145	4,906,204	2,358,351
Therje të raportuara të gjedhit	18,350	48,900	48,550	70,600	35,050
Akuakulturë	84,053	86,068	89,598	154,010	110,314
Vica	-	-	-	-	79,380
Fidanë	68,459	82,046	69,600	155,495	92,477
Primi i sigurimit bujqësor	-	-	-	1,769	170
Gjithsej	27,029,367	29,648,239	30,634,922	69,483,164	28,927,879

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZHR; *Në vitin 2020 është e përfshirë edhe mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike; Totali i paraqitur për vitin 2020 dhe shumën për qumësht, therje dhe akuakulturë ndryshon nga RGJ 2021 sepse tani janë të përfshira edhe pagesat e realizura për gjashtë mujorin e dytë 2020.

Në vitin 2021, shpërndarja e pagesave direkte është si në figurën më poshtë. Sektorët në të cilët janë shpërndarë 91% e gjithsej shumës së pagesave direkte në vitin 2021 janë: lopët qumështore (17%), grurë (11%), dele dhe dhi, bletë, misër, perime (nga 10%), vreshta (9%), qumësht sipas cilësisë (8%) dhe pemishte (6%) ndërsa pjesa tjetër prej 9% tek sektorët e tjerë.


Figura 42: Pagesat direkte sipas sektorëve 2021, në mil. €



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga gjithsej numri i aplikuesve 95% janë meshkuj ndërsa vetëm 5% janë femra. E njëjtë është përqindja e pjesëmarrjes edhe pas shpalljes së përfituesve.


Figura 43: Numri i aplikuesve dhe përfituesve sipas gjinisë në vitin 2021



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga gjithsej 1,324 aplikues femra, 1,268 është numri i përfituesve, ndërsa janë refuzuar vetëm 4% apo 56 aplikuese. Tek meshkujt nga 24,418 aplikues, 728 apo 3% e tyre janë refuzuar duke rezultuar me një numër prej 23,690 meshkuj përfitues të pagesave direkte.

Figura 44: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve sipas gjinisë në vitin 2021



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Nga gjithsej shuma e pagesave direkte për vitin 2021 prej 28.9 mil. €, përqindja që u shpërnda tek përfituesit e gjinisë femërore ishte 7% (1.9 mil. €) ndërsa tek ata të gjinisë mashkullore 93% (27.0 mil. €). Përqindja ishte e ndryshme varësisht nga sektori dhe detajet mund të shihen në tabelën e mëposhtme.


Tabela 90: Pagesat direkte sipas gjinisë në vitin 2021, në €

	Femër	Mashkull	% e pjesëmarrjes së femrave	% e pjesëmarrjes së meshkujve
Grurë	77,924	3,209,123	2	98
Farë gruri	4,995	126,918	4	96
Misër	117,783	2,722,299	4	96
Elb	14,289	293,751	5	95
Thekër	2,793	77,052	3	97
Tërshërë	12,990	236,699	5	95
Luledielli	2,319	627	79	21
Vreshta ekzistuese	67,860	2,452,386	3	97
Perime	119,417	2,644,961	4	96
Pemishte ekzistuese	227,124	1,587,324	13	87
Mjedra	7,435	96,331	7	93
Verë	174,425	557,475	24	76
Bimë mjekësore dhe aromatike	2,862	24,071	11	89
Bujqësi organike	-	81,150	-	100
Lopë qumështore	271,915	4,621,620	6	94
Buallica	510	2,125	19	81
Dele dhe dhi	158,340	2,837,340	5	95
Bletë	325,965	2,562,300	11	89
Pula Vojse	51,260	449,417	10	90
Thëllëza	6,700	1,423	82	18
Dosa	60	20,780	0	100
Qumësht	232,641	2,125,710	10	90
Therje të raportuara të gjedhit	-	35,050	-	100
Akuakulturë	-	110,314	-	100
Vica	4,460	74,920	6	94
Fidanë	-	92,477	-	100
Primi i sigurimit bujqësor	-	170	-	100
Gjithsej	1,884,066	27,043,812	7	93

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Nga gjithsej numri i aplikuesve 97% kanë aplikuar si persona fizik dhe vetëm 3% si persona juridik. Përqindja e refuzimit ka qenë më e lartë tek aplikuesit si persona juridik (6%) në krahasim me aplikuesit si persona fizik, tek të cilët përqindja e refuzimit ishte 3%.

Figura 45: Numri i përfituesve dhe të refuzuarve sipas tipit të fermerit në vitin 2021



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhr

Në vitin 2021 prej 28.9 mil. €, përqindja që u shpërnda tek përfituesit që aplikuan si persona fizik ishte 86% (24.8 mil. €) ndërsa tek ata si persona juridik 14% (4.1 mil. €). Përqindja ishte e ndryshme varësisht nga sektori dhe detajet mund të shihen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 91: Pagesat direkte sipas tipit të fermerit në vitin 2021, në €

	Fizik	Juridik	% e pjesëmarrjes fizik	% e pjesëmarrjes juridik
Grurë	3,162,766	124,282	96	4
Farë gruri	51,228	80,685	39	61
Misër	2,699,511	140,571	95	5
Elb	297,470	10,571	97	3
Thekër	68,832	11,013	86	14
Tërshërë	231,213	18,476	93	7
Luledielli	2,946	-	100	-
Vreshta ekzistuese	1,977,620	542,626	78	22
Perime	2,634,648	129,730	95	5
Pemishte ekzistuese	1,459,576	354,872	80	20
Mjedra	101,380	2,386	98	2
Verë	-	731,900	-	100
Bimë mjekësore dhe aromatike	26,843	90	100	0
Bujqësi organike	32,350	48,800	40	60
Lopë qumështore	4,597,990	295,545	94	6
Buallica	2,635	-	100	-
Dele dhe dhi	2,949,200	46,480	98	2
Bletë	2,653,380	234,885	92	8
Pula Vojse	9,682	490,995	2	98
Thëllëza	6,398	1,725	79	21
Dosa	20,840	-	100	-
Qumësht	1,758,141	600,210	75	25
Therje të raportuara të gjedhit	-	35,050	-	100
Akuakulturë	-	110,314	-	100
Vica	74,370	5,010	94	6
Fidanë	19,760	72,717	21	79
Primi i sigurimit bujqësor	170	-	100	-
Gjithsej	24,838,947	4,088,932	86	14

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhr

Në skemën e mëposhtme është i paraqitur numri i njërive të subvencionuara përmes pagesave direkte në vitin 2021.



6.2.1 Pagesat direkte për kulturat bujqësore, verë dhe sigurim bujqësor

Shuma totale e pagesave direkte në vitin 2021 për kultura bujqësore ishte 14.9 mil. €, ku pjesëmarrje më të madhe në gjithsej pagesat direkte për kultura bujqësore kishin gruri, misri, perimet, vreshtat dhe pemishtet ekzistuese, ndërsa kategoritë e tjera marrin pjesë me 11% në totalin e pagesave direkte për kultura bujqësore.

Gruri për herë të parë në vitin 2021 është mbështetur në dy forma: për ha dhe për kg. Numri i aplikuesve për sasi të grurit ka qenë dukshëm më i vogël sesa për sipërfaqe të grurit sepse duke qenë një formë e re e mbështetjes fermerët kanë qenë më pak të përgatitur për të aplikuar për këtë formë, por edhe ajo se ata nuk kanë dorëzuar grurin në pika grumbulluese në kohën e korrjes për shkak të çmimit të ulët të shitjes.

Nga gjithsej mbështetja për perime prej 2.8 mil. €, 80.9 mijë € apo 3% janë për perime në serra ndërsa pjesa tjetër për perime në fushë të hapur. Sa i përket kulturave perimore ato që përbëjnë 91% të gjithsej shumës së pagesave direkte për perime janë: patatja, kungulli, speci, shalqiri, kungull misiri, qepa, lakra dhe fasulja monokulturë, ndërsa të gjitha perimet e tjera përfshirë edhe perimet në serra kanë pjesëmarrje prej 9%.

Tek mbështetja e vreshtave në vitin 2021 është bërë një përshkallëzim i pagesës varësisht numrit të hektarëve për të cilët aplikohet, kjo ka mundësuar që prodhuesit e mëdhenj që janë më të qëndrueshëm në treg të përfitojnë shumë mesatare më të vogël të mbështetjes për ha në raport me prodhuesit më të vegjël. Ata që kishin nga 0.10-20 ha u mbështetën me nga 1,000 €/ha, prej 20-50 ha me nga 700 €/ha për çdo hektarë mbi 20 ha, prej 50-100 ha me nga 500 €/ha për çdo hektarë mbi 50 ha dhe për çdo ha mbi 100 u mbështetën me nga 300 €/ha.

Nga gjithsej shuma prej 1.8 mil. € që u pagua për pemishte, kulturat pemëtare që kanë pjesëmarrje më të madhe në këtë total janë: molla, arra, kumbulla, lajthia, vishnja dhe dardha, të gjitha përbëjnë 91% të gjithsej mbështetjes për pemishte, ndërsa pjesa tjetër prej 9% është e shpërndarë tek kulturat tjera pemëtare.

Në kuadër të bujqësisë organike nga gjithsej shuma e paguar prej 81 mijë €, 90.5% kanë qenë për bimë mjekësore aromatike organike, 7.0% për grurë organik dhe 2.5% për pemishte organike. Tek kulturat e tjera për të cilat me program është planifikuar mbështetje nëse kultivohen si organike si për: farë gruri, misër, elb, thekër, tërshërë, luledielli dhe perime në fushë të hapur apo serra nuk ka pasur asnjë përfitues.

Tabela 92: Pagesat direkte sipas sektorëve, 2017-2021


		2017	2018	2019	2020*	2021
Grurë	Numri i aplikuesve	9,709	10,683	8,872	11,044	6,862
	Numri i përfituesve	9,216	10,311	8,698	10,729	6,553
	Numri i ha të paguar	38,542	43,673	35,287	46,931	27,860
	Pagesa për ha	150	150	150	300	75
	Shuma totale e paguar	5,781,300	6,550,929	5,292,996	14,079,396	2,089,499
Grurë	Numri i aplikuesve	-	-	-	-	3,801
	Numri i përfituesve	-	-	-	-	3,550
	Numri i kg të paguar	-	-	-	-	63,028,896
	Pagesa për kg	-	-	-	-	0.019
	Shuma totale e paguar	-	-	-	-	1,197,549
Farë gruri	Numri i aplikuesve	11	11	15	25	16
	Numri i përfituesve	11	11	15	24	14
	Numri i ha të paguar	508	458	562	869	528
	Pagesa për ha	250	250	250	500	250
	Shuma totale e paguar	122,003	114,204	140,395	434,540	131,913
Misër	Numri i aplikuesve	8,598	8,432	9,526	10,020	7,510
	Numri i përfituesve	8,231	8,165	9,370	9,808	7,224
	Numri i ha të paguar	22,077	21,519	27,483	28,493	18,934
	Pagesa për ha	150	150	150	300	150
	Shuma totale e paguar	3,311,579	3,227,784	4,122,464	8,547,885	2,840,082
Elb	Numri i aplikuesve	227	316	273	242	856
	Numri i përfituesve	208	306	267	233	820
	Numri i ha të paguar	387	518	488	442	2,054
	Pagesa për ha	100	150	150	300	150
	Shuma totale e paguar	38,662	77,688	73,194	132,645	308,040
Thekër	Numri i aplikuesve	78	83	70	59	182
	Numri i përfituesve	67	72	67	56	173
	Numri i ha të paguar	170	196	196	195	532
	Pagesa për ha	100	150	150	300	150
	Shuma totale e paguar	16,957	29,343	29,423	58,623	79,845
Tërshërë	Numri i aplikuesve	-	-	505	569	746
	Numri i përfituesve	-	-	485	538	706
	Numri i ha të paguar	-	-	928	1,321	1,665
	Pagesa për ha	-	-	150	300	150
	Shuma totale e paguar	-	-	139,161	396,261	249,689

Vreshta	Numri i aplikuesve	2,969	3,012	2,939	2,919	2,848
	Numri i përfituesve	2,909	2,949	2,900	2,880	2,826
	Numri i ha të paguar	2,508	2,580	2,989	3,080	3,039
	Pagesa për ha	1,000/500	1,000	1,000	2,000	1,000/700 500/400
	Shuma totale e paguar	2,266,235	2,580,250	2,988,810	6,160,400	2,520,246
Luledielli	Numri i aplikuesve	7	5	11	5	6
	Numri i përfituesve	6	4	11	3	6
	Numri i ha të paguar	53	5	97	40	20
	Pagesa për ha	150	150	150	300	150
	Shuma totale e paguar	7,946	749	14,621	12,036	2,946
Perime	Numri i aplikuesve	5,716	6,664	7,270	4,676	3,917
	Numri i përfituesve	5,550	6,435	7,099	4,481	3,802
	Numri i ha të paguar	7,481	8,977	8,295	9,210	6,870
	Pagesa për ha	300	300	300	600	400/500
	Shuma totale e paguar	2,244,228	2,693,021	2,488,506	5,525,712	2,764,378
Pemishte ekzistuese	Numri i aplikuesve	4,358	5,278	3,557	3,166	2,929
	Numri i përfituesve	4,110	5,097	3,488	3,034	2,774
	Numri i ha të paguar	3,999	4,764	4,142	4,757	4,536
	Pagesa për ha	400	400	400	800	400
	Shuma totale e paguar	1,599,496	1,905,548	1,656,812	3,805,736	1,814,448
Bujqësi organike	Numri i aplikuesve	10	37	27	48	35
	Numri i përfituesve	6	24	26	38	11
	Numri i ha të paguar	118	443	1,050	1,672	197
	Pagesa për ha	+300	+500	500	1,000	125/200 450/500
	Shuma totale e paguar	35,373	277,578	524,900	1,672,210	81,150
Bimë mjekësore dhe aromatike	Numri i aplikuesve	-	-	-	84	62
	Numri i përfituesve	-	-	-	70	56
	Numri i ha të paguar	-	-	-	248	60
	Pagesa për ha	-	-	-	450	450
	Shuma totale e paguar	-	-	-	111,479	26,933
Verë**	Numri i aplikuesve	18	16	15	18	17
	Numri i përfituesve	7	14	15	17	17
	Numri i litrave të paguara	1,375,607	4,769,358	9,734,385	5,711,290	9,148,751
	Pagesa për litër	0.04	0.04	0.04	0.04	0.08
	Shuma totale e paguar	55,024	190,774	389,375	228,452	731,900
Mjedër	Numri i aplikuesve	-	-	967	525	376
	Numri i përfituesve	-	-	594	386	320
	Numri i kg të paguara	-	-	898,547	1,055,337	864,717
	Pagesa për kg	-	-	0.08	0.16	0.12
	Shuma totale e paguar	-	-	71,883	168,854	103,766

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhr; *Në vitin 2020 është e përfshirë edhe mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike; **Pagesa për njësi për verë në vitin 2021 ka qenë e planifikuar 0.04 €/litër ndërsa pagesa është realizuar 0.08 €/litër sepse dyfishimi i pagesës për njësi në kuadër të PRE-së nuk është aplikuar për verë në vitin 2020.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur shuma mesatare e subvencioneve për një përfitues, ku shihet se mesatare më të lartë kishin përfituesit që kishin aplikuar për verë të prodhuar me 43.1 mijë €, pasuar nga përfituesit e farës së grurit me 9.4 mijë €, bujqësisë organike me 7.4 mijë €, ndërsa mesatare më të ulët për përfitues, përkatësisht nën 1,000 € kishin të gjitha kulturat e tjera.


Figura 46: Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2021



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në shumicën e rasteve ishte nën 5 ha, me përjashtim të farës së grurit dhe bujqësisë organike, ku sipërfaqja mesatare e subvencionuar ishte e lartë sepse numri i përfituesve ishte i vogël.

Figura 47: Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2021



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Primi i sigurimit bujqësor

Gjatë vitit 2021, MBPZhR vazhdoi subvencionimin e primit të sigurimit për polisat e sigurimit. Krahas mjedrës, mollës, kumbullës, rrushit, specit dhe dredhëzës që ishin përfshirë në PPD 2020, masa e subvencionimit të primit u zgjerua për të mbuluar edhe polisën e sigurimit të arrës. Përveç kësaj, shuma e mbulueshmërisë së polisës u rrit nga 50% në 75%. Pra, në kuadër të këtij programi, MBPZhR mbuloi 75% të kostos së policës së sigurimit (primit) për të gjithë fermerët që kanë blerë polisa të sigurimeve bujqësore në vitin 2021 dhe që kanë aplikuar në kuadër të PPD-së.

Zbatimi i kësaj mase subvencionimi është planifikuar si më poshtë: 1) fermerët blejnë polisat e sigurimit së pari dhe paguajnë vetë çmimin e plotë, 2) më pas ata aplikojnë për skemën e subvencionit për të marrë më vonë kompensimin e 75% të kostos së polisës nga MBPZhR.

Në kuadër të kësaj mase kanë përfituar 4 fermerë dhe nuk kishte të refuzuar. Këta fermerë kanë marrë një kompensim prej 75% për koston e sigurimit të tyre, ku MBPZhR ka shpërndarë gjithsej 170.45 €. Fermerët morën si subvencion mesatarisht 42.61 €, duke filluar nga minimumi prej 34.09 € deri në 68.18 €.

MBPZhR është e përkushtuar të mbështesë të gjithë fermerët që blejnë polisat e sigurimit, si një mënyrë për të zbutur rreziqet e tyre të prodhimit dhe për të siguruar vazhdimësinë e bizneseve bujqësore, por që numri i fermerëve që kanë siguruar kulturat e tyre vazhdon të mbetet i ulët.

6.2.2 Pagesat direkte për blegtori dhe qumësht

Shuma e pagesave direkte për sektorin e blegtorisë në vitin 2021 ishte 13.9 mil. €. Nga gjithsej pagesat direkte për blegtori, 35% ishin për lopë qumështore, 22% për dele dhe dhi, 21% për bletari, 17% për qumësht sipas cilësisë dhe 5% për kategoritë tjera të subvencionimit. Në vitin 2021, pjesëmarrja e pagesave direkte për blegtori në totalin e pagesave direkte është 48%.

Nga gjithsej shuma prej rreth 3 mil. € për dele dhe dhi, pjesëmarrja e subvencionimit për dele është 90% ndërsa për dhi vetëm 10%. Viçat për majmëri filluan të subvencionohen për herë të parë në vitin 2021 me nga 10 € për krerë dhe duke qenë se ishte subvencionim për herë të parë i aplikueshëm, numri i fermerëve të refuzuar ishte mjaft i lartë apo 37.9% e aplikuesve.

Tabela 93: Pagesat direkte sipas sektorëve, 2017-2021


		2017	2018	2019	2020	2021
Lopë qumështore	Numri i aplikuesve	7,778	7,595	6,775	7,027	6,210
	Numri i përfituesve	7,546	7,395	6,606	6,905	6,105
	Numri i krerëve të paguar	68,250	67,811	62,478	67,295	57,571
	Pagesa për krerë	70	70	70	140	85
	Shuma totale e paguar	4,777,500	4,746,770	4,373,460	9,421,300	4,893,535
Buallica	Numri i aplikuesve	-	-	6	5	5
	Numri i përfituesve	-	-	6	4	4
	Numri i krerëve të paguar	-	-	256	347	31
	Pagesa për krerë	-	-	70	140	85
	Shuma totale e paguar	-	-	17,920	48,580	2,635
Dele dhe dhi	Numri i aplikuesve	1,367	1,436	1,380	1,515	1,379
	Numri i përfituesve	1,334	1,378	1,355	1,469	1,329
	Numri i krerëve të paguar	140,854	153,241	160,768	170,985	149,784
	Pagesa për krerë	15	15	15	30	20
	Shuma totale e paguar	2,112,810	2,298,615	2,411,520	5,129,550	2,995,680
Dosa	Numri i aplikuesve	151	210	216	251	158
	Numri i përfituesve	130	202	211	235	133
	Numri i krerëve të paguar	859	1,366	1,405	1,877	1,042
	Pagesa për krerë	20	20	20	40	20
	Shuma totale e paguar	17,180	27,320	28,100	75,080	20,840
Bletë	Numri i aplikuesve	2,595	3,007	3,411	3,941	3,373
	Numri i përfituesve	2,467	2,764	3,238	3,634	3,133
	Numri i koshereve të paguara	153,037	164,739	204,730	233,227	192,551
	Pagesa për koshere	15	15	15	30	15
	Shuma totale e paguar	2,295,555	2,471,085	3,070,950	6,996,810	2,888,265
Pula vojse	Numri i aplikuesve	88	88	85	84	94
	Numri i përfituesve	80	81	82	84	77
	Numri i pulave vojse të paguara	960,955	1,023,671	1,181,829	1,310,235	1,120,349
	Pagesa për pulë vojse	0.50/0.40	0.50/0.40	0.50/0.40	1.00/ 0.80	0.50/ 0.40
	Shuma totale e paguar	435,035	484,343	537,497	1,165,861	500,676

Thëllëza	Numri i aplikuesve	13	13	13	11	12
	Numri i përfituesve	13	13	9	10	11
	Numri i thëllëzave të paguara	29,013	36,560	28,088	23,678	16,245
	Pagesa për thëllëzë	1.00	0.50	0.50	1.00	0.50
	Shuma totale e paguar	29,013	18,280	14,044	23,678	8,123
Qumësht	Numri i aplikuesve	2,700	3,116	1,836	1,282	1,197
	Numri i përfituesve	2,700	3,055	1,798	1,245	1,149
	Numri i litrave të paguara	-	34,522,414	38,664,480	47,515,642	44,835,136
	Pagesa për litër	0.06/0.04/ 0.02	0.06/0.04/ 0.02	0.06/0.04/ 0.02	0.12/ 0.08/ 0.04	0.06/ 0.04/ 0.02
	Shuma totale e paguar	1,712,609	1,736,944	2,041,145	4,906,204	2,358,351
Therje të raportuar të gjedhit	Numri i aplikuesve	6	28	14	12	8
	Numri i përfituesve	6	24	13	9	7
	Numri i krerëve të paguar	367	978	971	706	701
	Pagesa për krerë	50	50	50	100	50
	Shuma totale e paguar	18,350	48,900	48,550	70,600	35,050
Akuakulturë	Numri i aplikuesve	4	8	8	4	4
	Numri i përfituesve	4	5	8	4	4
	Numri i kg të paguar	420,264	430,341	447,990	385,024	551,571
	Pagesa për kg	0.20	0.20	0.20	0.40	0.20
	Shuma totale e paguar	84,053	86,068	89,598	154,010	110,314
Viça për majmëri	Numri i aplikuesve	-	-	-	-	744
	Numri i përfituesve	-	-	-	-	462
	Numri i krerëve të paguar	-	-	-	-	7,938
	Pagesa për krerë	-	-	-	-	10
	Shuma totale e paguar	-	-	-	-	79,380

Burimi: Raporti vjetor i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB); Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR; *Në vitin 2020 është e përfshirë edhe mbështetja që është bërë në kuadër të masës 4A të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike; Të dhënat e paraqitura paraqitur për vitin 2020 për Qumësht, Therje të raportuara të gjedhit dhe Akuakulturë ndryshojnë nga RGJ 2021 sepse tani janë të përfshira edhe pagesat e realizuara për gjashtë mujorin e dytë 2020.

Në figurën më poshtë është paraqitur shuma mesatare e subvencioneve për një përfitues, ku shihet se mesatare më të lartë kishin përfituesit për akuakulturë me 27.6 mijë € pasuar nga ata për pula vojse me 6.5 mijë €, therje të raportuara të gjedhit me 5 mijë €, ndërsa mesatare më të ulët për përfitues, përkatësisht nën 5 mijë € kishin përfituesit e deleve dhe dhive, qumështit, bletëve, lopëve qumështore, thëllëzave, buallicave, viçave për majmëri dhe dosave.


Figura 48: Shuma mesatare e subvencionimit për përfitues në vitin 2021



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhr

Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues është e paraqitur në figurën e mëposhtme ku shihet se sa i përket krerëve, mesatare më e lartë është në rastin e deleve dhe dhive, pasuar nga therjet e raportuara të gjedhit, viça për majmëri, lopët qumështore, dosat dhe buallica.

Figura 49: Mesatarja e njësive të subvencionuara për përfitues në vitin 2021



Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhr

6.2.3 Mbështetja e inpueteve në bujqësi

Mbështetja e fidanëve

Gjithsej shuma e pagesave direkte për fidanë në vitin 2021 ishte rreth 92.5 mijë €. Numri më i madh i fidanëve të subvencionuar është në regjionin e Gjakovës (48%), pasuar nga Gjilani (26%), Peja (16%) dhe Ferizaji (13%), ndërsa në regjionet e tjera nuk ka pasur fare përfitues.

Janë subvencionuar prodhuesit e fidanëve të pemëve drufrutore me nga 0.20 €/fidan për 40,000 fidanët e parë (duke filluar nga minimum prej 5,000 copë), dhe me nga 0.15 €/fidan për çdo fidan mbi këtë numër si dhe prodhuesit e fidanëve të hardhisë së rrushit me nga 0.10 €/fidanë për çdo fidanë mbi 5,000 copë.

Mesatarja e fidanëve për të cilat një fermer ka përfituar ishte rreth 43 mijë fidanë, më e ulëta ishte në regjionin e Ferizajit (20 mijë fidanë), ndërsa më e larta në regjionin e Gjakovës (67 mijë fidanë).

Tabela 94: Pagesat direkte për fidanë sipas regjionit, 2021

Nr.	Regjioni	Nr. i Aplikuesve	Nr. i fermerëve përfitues	Nr. i fidaneve të subvencionuara	Shuma e paguar në €
1	Prishtinë	0	0	-	-
2	Prizren	1	0		
3	Pejë	3	2	97,548	18,362
4	Mitrovicë	0	0		
5	Gjakovë	4	4	269,700	29,220
6	Ferizaj	4	4	80,200	16,040
7	Gjilan	5	4	159,900	28,855
	Gjithsej	17	14	607,348	92,477

Burimi: Të dhëna nga baza e të dhënave të Pagesave Direkte, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

6.3 Agro kreditë dhe fondi garantues

6.3.1 Agro Kreditë

Sektori bujqësor në Kosovë ka nevojë të madhe për financim e sidomos për agro-kredi. Zhvillimi i sektorit bujqësor edhe pas shumë vitesh, ende nuk është në nivelin e dëshiruar, pavarësisht përkrahjes së vazhdueshme nga ana e ministrisë me grante dhe subvencione.

Bujqësia vazhdon të ketë qasje të ulët në financimin e përgjithshëm bankar me vetëm 2.1% për vitin 2021 (0.1 pikë përqindje më e ulët se viti paraprak), pra sektor që më së paku është kredituar nga institucionet financiare në Kosovë. Te Institucionet Mikrofinanciare (IMF) gjendja është më ndryshe, pjesëmarrja e agrokredive është 19.5% për vitin 2021.

Agro kreditë njihen si kredi jopërformuese dhe për këtë arsye kreditimi ka një kosto të lartë për bankat dhe institucionet mikrofinanciare. Ky nivel i ulët i kreditimit vë në pah qasjen konservatore të sistemit bankar kundrejt sektorit të bujqësisë. Mungesa e sistemit adekuat të sigurimeve në bujqësi po ashtu ndikon mjaft në qasjen e fermerëve në kredi, respektivisht në kredi të volitshme. Ndihmesë të rëndësishme për garanci kreditore në bujqësi kanë dhënë USAID dhe FKGK.

Me qëllim të shtimit të efektivitetit në fermë, fermerët kanë nevojë të zgjerojnë më shumë nivelin e financimit të investimeve të tyre në: rritjen e fondit të bagëtive, rregullim dhe zgjerim të fermave me standarde evropiane, energji solare, blerje të pajisjeve dhe makinerive bujqësore të teknologjisë së re, blerje të inventarit, blerje të inputeve, krijimi i pikave grumbulluese, depo-frigo ruajtëse dhe shumë pajisje tjera bujqësore. Investimet e tilla në fermë, u mundësojnë fermerëve rritjen e produktivitetit dhe njëkohësisht përgatitjen për sezonin e ri bujqësor. Përmes investimeve të ndryshme në këtë sektor, do të mundësohet përmirësimi i mirëqenies në zonat rurale, shtimi i prodhimit vendor gjë që ndikon në zëvendësimin e produkteve të importit, krijimin e mundësive për eksport si dhe mbajtjen e fuqisë së re punëtore.

Bankat që mbështesin financiarisht me kredi sektorin e bujqësisë në Kosovë janë: Banka për Biznes, Banka Ekonomike, Raiffeisen Bank (RBKO), Procredit Bank (PCB), TEB Bank, NLB Prishtina dhe Banka Kombëtare Tregtare (BKT), ndërsa Institucionet Mikrofinanciare janë: Agjencioni për Financim në Kosovë (AFK), Finca, KosInvest World Vision, KEP Trust, KGMAMF, Kreditimi Rural i Kosovës (KRK), Qelim Kosovë dhe Start Finance.

Lider në shumën e Agrokredive të disbursuara është TEB, PCB, BPB, BKT dhe RBKO, pasuar nga IMF-të: KRK, AFK, Finca, KEP etj. Në tabelë shihet se më së shumti kredi janë disbursuar në vitin 2019. Shuma totale e kredive të disbursuara në vitin 2019 është mbi 115 mil. €. Numri i kredive të dhëna që nga viti 2017 deri në vitin 2021 është mbi 114 mijë kredi me një shumë totale prej 479.8 mil. €. Pra, për këto 5 vite, i bie që çdo muaj janë disbursuar mesatarisht rreth 1,907 kredi, me shumë mesatare mujore prej 8.0 mil. €.


Tabela 95: Agrokreditë 2017 – 2021

Agro Kredi 2017 - 2021	Numri i kredive të disbursuara	Shuma totale e kredive të disbursuara (mil. €)	Kohëzgjatja e kredisë (muaj)	Norma mesatare e interesit (%)	Pjesëmarrja e Agro Kredive në krahasim me kreditë tjera (%)
2017	24,940	91.3	17 - 39	7.3 - 26.7	0.3 - 43.0
2018	26,403	91.3	12 - 39	6.0 - 28.5	1.3 - 64.5
2019	21,622	115.1	18 - 42	6.4 - 28.4	0.7 - 43.5
2020	22,958	83.2	18 - 40	5.3 - 28.6	0.5 - 36.7
2021	18,477	98.9	18 - 41.5	5.2 - 24	0.4 - 33
Gjithsej	114,400	479.8			

Burimi: Bankat komerciale dhe IMF në Kosovë, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Nga të dhënat në tabelë dhe figurë, shihet qartë që viti 2020 dhe 2021, dallojnë mjaft me dhënie të kredive (rritje për 18.8%). Nëse krahasohet viti 2021 me vitin 2017, vërehet një rritje e ulët për vetëm 8.3%.

Figura 50: Shuma totale dhe numri i agrokredive të disbursuara (mil. € dhe '000)



Burimi: Bankat komerciale & IMF në Kosovë, BQK

Afati i dhënies së kredive bujqësore ndryshon nga 18 deri 41.5 muaj, varësisht prej destinimit të kredisë. Normat e interesit ndryshojnë nga 5.2% deri në 24%, bazuar në shumën e kredisë dhe afatin e kthimit. Prodhuesit bujqësor vazhdojnë të kenë pakënaqësi për normat e interesit, të cilat nuk ndikojnë në stimulimin e zhvillimit të këtij sektori.

Kolaterali zakonisht nuk kërkohet për shuma të vogla të kredisë. Për shuma mesatare dhe të mëdha, nga bankat dhe IMF-të kërkohet kolateral prej 100% deri në 388% të shumës së kredisë, ndërsa në vitet e fundit ka pasur normalizim të dukshëm. Në përgjithësi si standard për kolateral kërkohet prej huadhënësit nga 100% deri 150% e vlerës së kredisë.

Grejs periudha apo periudha e shtyrjes së pagesës, varion nga 3 deri në 12 muaj, megjithëse në disa publikime figuron 18 muaj, varësisht nga rastet ku grejs periudha është fleksibile. Vlen të theksohet se shlyerja e përqindjes më të madhe të kredive bëhet pas sezonit të korrjes. Ndër vite, vërehet që grejs periudha ishte më e ulët kurse në vitet e fundit ka ngritje të saj.

Pjesëmarrja e kredive në bujqësi në krahasim me kredi të tjera, nëpër Banka dhe IMF dallon shumë. Te Bankat, deklarimi i pjesëmarrjes është nga 0.4% deri në 11.7%, që është shembull i mirë. Te IMF-të, deklarimi i pjesëmarrjes varion nga 15.4% në 33% që si mesatare është mbi 27%.

Huamarrja në banka dhe IMF me norma të interesit ndryshon varësisht nga shuma e kredisë dhe maturiteti i saj. Sa më e madhe është shuma dhe sa më e shkurtër është kohëzgjatja e kredisë, aq më e ulët është norma (kamata) e interesit si dhe e kundërta.

Nga figurat e mëposhtme shihen dallimet në shifra mes Bankave komerciale dhe IMF-ve.

Figura 51: Shuma e agrokredive nga Bankat dhe IMF, mil. €



Burimi: Banka & IMF, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Bankat karakterizohen me numër më të vogël të kredive por me shuma më të mëdha, që i bie se mesatarja për kredi për vitin 2021 ishte 19,300 €. Te IMF-të, mesatarja për kredi është 2,900 €, rrjedhimisht, numër të madh të kredive por me shuma më të vogla, gjë që arrihet baraspesha e interesave gati për çdo fermer.


Figura 52: Numri agrokredive nga Bankat dhe IMF, '000 €



Burimi: Banka & IMF, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Kamatat në kredi-dhënie për sektorin bujqësor janë të larta në krahasim me kreditë e sektorëve tjerë dhe me vendet e regjionit, megjithëse viti 2021 u karakterizua me rënie të lehtë të normës së interesit për 1.3 pikë përqindje krahasuar me vitin 2020 e kjo rënie e normës së interesit nuk ndikon si stimulim për fermerët kur dihet që dallimi me kredi biznesi ende është i lartë (2 pikë përqindje).

Figura 53: Norma e interesit në kredi bujqësore nga Bankat dhe IMF, %



Burimi: BQK

Kamatat në kredi-dhënie për sektorin bujqësor të IMF-ve për vitin 2021, u karakterizuan me ngritje të normës së interesit për 0.5 pikë përqindje krahasuar me vitin paraprak apo për 3.7 pikë përqindje ulje të normës së interesit krahasuar me vitin 2017.

Sa i përket përqindjes së pjesëmarrjes së kredive të këqija tek agrokreditë, mund të themi se janë në nivelin e pranueshëm brenda limiteve të përcaktuara nga shumica e bankave dhe institucioneve financiare. Krahasuar me vendet e rajonit, jemi në një nivel shumë të kënaqshëm.

Ndër vite të Bankat, maksimumi i kredive të këqija ishte rreth 5%, ndërsa të IMF-të është dukshëm më i lartë.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore – FKGK

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është entitet juridik i pavarur me karakter zhvillimor, i cili ofron garanci kreditore për Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM), duke ndarë riskun kreditor me institucionet financiare.

FKGK vazhdon ta ketë një ndër objektivat më të rëndësishme mbështetjen e zhvillimit të sektorit të bujqësisë, përmes garantimit të agro kredive përgjatë tërë zinxhirit të shtimit të vlerës brenda këtij sektori.

Poashtu, ka vazhduar të garantojë sektorin e bujqësisë edhe gjatë pandemisë COVID-19 duke vazhduar ta përkrahë tutje këtë sektor dhe ta ketë në fokus të veçantë. Për më tepër, Banka Gjermane Zhvillimore (KfW) gjatë muajit prill 2021, kur edhe ishte fillimi i vrullshëm i kësaj pandemie, ka dhuruar 6.5 mil. €, duke ndikuar kështu në rritjen e kapitalit të FKGK-së dhe fuqizuar më tutje Dritaren Agro.

Sikur edhe sektorët tjerë, po ashtu edhe bujqësia është ndikuar nga pandemia. Vlenë të theksohet fakti që jo të gjithë nën-sektorët janë ndikuar në të njëjtën formë. Përderisa nën-sektori i frutave të imta ishte profitabil për shkak të kërkesës së rritur për këto produkte dhe mundësisë së vjeljes së tërë rendimentit të tyre. Në anën tjetër fermerët që ishin pjesë e zinxhirit të HoReCa-s dhe e furnizonin këtë sektor me produktet e tyre, kryesisht kishin probleme për shkak të ndalesave që ky sektor ishte ballafaquar gjatë kësaj pandemie.

Deri në fund të vitit 2021, FKGK ka nënshkruar marrëveshje me 7 banka dhe 3 Institucione Mikrofinanciare (IMF) të FKGK-së që janë aktive në agro kredi dhënie për Dritaren, përderisa ka filluar të nis procesin e regjistrimit të IMF të katërt me radhë. Një pikë kthese për regjistrimin e IMF në FKGK ishte edhe mundësia që ju ofrua institucioneve financiare për të garantuar kreditë që u jepen fermerëve që posedojnë Certifikatë të Fermerit dhe Numër Identifikues të Fermës (NIF), e cila mundësi nuk ishte më parë. Kjo është mundësuar gjatë vitit 2021, periudhë kjo që përkon me kohën kur ka qenë aktive dhe është zbatuar Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE) nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK). Kjo pako përpos mundësisë së garantimit të fermerëve që posedojnë NIF, ju mundësoi institucioneve financiare partnere edhe garantimin deri në 80% të agro kredisë.

Gjatë vitit 2021, janë miratuar gjithsejt rreth 15.6 mil. € kredi të reja nga IFP-të në sektorin e bujqësisë të cilat janë vënë nën garancionin e FKGK-së. Kjo paraqet rreth 118% rritje të

volumit të kredive të garantuara krahasuar me vitin paraprak 2020 (apo rreth 65% rritje krahasuar me vitin 2019), e cila rritje ka ardhë si rrjedhojë e rritjes së kreditimit gjatë periudhës së fillimit të rimëkëmbjes pas pandemisë. Gjithashtu edhe numri i kredive të garantuara është rritur nga 202 në 469, për 132% krahasuar me vitin paraprak (apo rreth 108% krahasuar me vitin 2019).

Shuma mesatare e kredive të garantuara në sektorin e bujqësisë gjatë 2021 ishte rreth 33,400 €, me maturitet mesatar mbi 39 muaj (rritje nga 35.7 muaj që ishte një vit më herët).


Shpërndarja rajonale e 15.6 mil. € të kredive të lëshuara nga IFP-të dhe të garantuara nga FKGK, në rajone të ndryshme për sektorin e bujqësisë gjatë vitit 2021 është si në vijim:

Tabela 96: Shpërndarja rajonale e kredive të miratuara, 2021

Shpërndarja rajonale	Kreditë e miratuara, €
Prishtinë	7,613,000
Prizren	2,631,600
Pejë	1,140,200
Mitrovicë	754,600
Gjakovë	960,300
Gjilan	1,601,700
Ferizaj	921,600
Gjithsej	15,623,000

Burimi: FKGK

Figura 54: Proporcioni i shpërndarjes së kredive, %



Burimi: FKGK

6.4 Sigurimet në fushën e bujqësisë

Pajisja e fermerëve me një polisë sigurimi është një mundësi unike për të ndihmuar zhvillimin e bujqësisë në vend, si dhe për të rritur qasjen në financa për të gjithë fermerët kosovarë dhe për të krijuar mundësi të reja për të kaluar rreziqet me të cilat përballen çdo ditë. Sistemi i sigurimeve bujqësore të Kosovës po forcon bazat e tij, duke sjellë praktikatat më të mira ndërkombëtare në hartimin e produkteve më të përshtatshme për fermerët kosovarë.

Zhvillimi dhe Shitja e Produktet Indeks të Sigurimit Bujqësor

Në vitin 2021, përveç shtatë (7) produkteve ekzistuese të sigurimit indeks për mollën, rrushin, kumbullën, specin, dredhëzën, mjedrën dhe arrën, janë zhvilluar edhe (5) produkte të sigurimit indeks. Këto pesë produkte shtesë të sigurimit indeks u zhvilluan për këto kultura bujqësore (vishnja, qershia, fasulja, dardha dhe misri). Këto produkte u dizajnuan për t'u lansuar në vitin 2022. Këto kultura u zgjodhën bashkërisht nga MBPZHR-ja dhe IFC-ja bazuar në faktorë të ndryshëm si struktura e fermës, numri i fermerëve, kostoja e prodhimit, zinxhiri i vlerës dhe analiza e rrezikut për secilën kulturë.

Pas zhvillimit të këtyre produkteve, gjithsej produkte të sigurimit indeks janë dymbëdhjetë (12) produkte (shih tabelën e më poshtme).

Tabela 97: Produktet e Sigurimit Indeks për Kosovë për vitin 2021

Lloji i kulturës	Rreziqet e mbuluara	Periudha e mbulimit
Molla	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Kumbulla	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Rrushi	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Mjedra	Temperatura të larta ekstreme	1 Korrik - 31 Gusht
Dredhëza	Ngricat pranverore	1 Mars - 30 Prill
Speci	Shirat e tepërta	15 Maj - 10 Qershor
Arra	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Vishnja	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Qershia	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Dardha	Ngricat pranverore	20 Mars - 15 Maj
Fasulja	Temperaturat e larta	15 Qershor - 31 Korrik
Misri	Temperaturat e larta	25 Qershor - 25 Korrik

*Shënim: Produktet e sigurimit mund të ndryshojnë çdo vit, pas një rishikimi vjetor. Produktet e sigurimit për vishnjën, qershinë, dardhën, fasulen dhe misrin janë dizajnuar për tu vënë në dispozicion në vitin 2022.

Sa i përket shitjes të produkteve të sigurimit indeks, viti 2021 shënon dy vite prej pilotimit të programit të sigurimit bujqësor (fazës pilotuese). Përgjatë këtij viti, skemës së sigurimeve iu bashkuan një numër i përgjithshëm prej njëzetë e tre (23) fermerësh. Këto polica sigurimi u lëshuan vetëm për kulturën e mjedrës-sigurimin indeks të mjedrës. Policat e shitura kanë ofruar mbrojtje në pjesën lindore të Kosovës, përkatësisht në komunën e Podujevës dhe në pjesën jugore të vendit, përkatësisht në komunën e Shtërpçës.

Gjithsej, një sipërfaqe prej 5.08 ha të kultivuara me mjedër ishte siguruar, me sipërfaqe minimale të siguruar prej 0.20 ha dhe maksimale deri në 0.40 ha. Në përgjithësi, në vitin 2021, sipërfaqja mesatare e siguruar me mjedër ishte 0.22 ha. Për të siguruar këtë sipërfaqe të kultivimit të mjedrës, fermerët e mjedrës paguan një çmim mesatar prej 26 € për policën e sigurimit, duke filluar nga një vlerë minimale prej vetëm 15 € deri në një maksimum prej 90 €. Këta fermerë kanë paguar gjithsej 599.62 € si premi, kurse shuma totale e sigurimit arriti vlerën prej 9,652 €.

Krahasuar me vitin 2020, numri i fermerëve që kanë siguruar pemishtet e tyre me mjedër është pothuajë i njëjtë, ku sipërfaqja totale e siguruar me mjedër është zvogëluar vetëm me 3%. Mirëpo, krahasuar me vitin 2020, numri i përgjithshëm i fermerëve që kanë siguruar sipërfaqet e tyre të kultivimit është zvogëluar për 57%, ndërsa sipërfaqja totale e siguruar është zvogëluar përkatësisht me 68%.

Figura 55: Sipërfaqja totale e siguruar në ha dhe nr. i fermerëve të siguruar



Burimi: Sistemi Informativ i Sigurimit Bujqësor (SISB)

Dëmet/ humbjet dhe Pagesat e Dëmshpërblimit

Ashtu si në vitin 2020, policat e sigurimit të mjedrës kishin një periudhë vlefshmërie nga data 1 korrik deri më 31 gusht 2021 - gjithsej 62 ditë mbulim rreziku ndaj temperaturave të larta prej 29°C e lart për 10 ditë rresht. Pasi që vera e vitit 2021 në Kosovë u shoqërua me temperatura relativisht të larta, këto temperatura rezultuan edhe në dëmtimin e pemishteve të mjedrës.

Fatmirësisht, nga grupi i fermerëve që blenë sigurime të mjedrës, të gjithë fermerët morën pagesa të dëmshpërblimit për humbjet në pemishtet e tyre. Nga kufijtë e prekur të sigurimit, fermerët e siguruar pësuan dëme që varionin nga 25% deri në një maksimum prej 67.5%. Në vlerë monetare, mesatarisht, fermerët e mjedrës që pësuan humbje morën një kompensim

prej 154 € për humbjet e tyre, duke filluar nga vlera minimale e kompensimit prej 95 € deri në vlerën më të lartë të kompensimit prej 513 €.

Produktet Tradicionale të Sigurimit Bujqësor

Në fillim të punës së projektit të sigurimeve në vitin 2017, sigurimi tradicional nuk ishte i përshtatshëm për Kosovën pasi kërkonte ekspertizë dhe njohuri të thella të marrjes në sigurim, vlerësimit të rrezikut dhe vlerësimit (llogaritjes) së humbjeve (dëmeve). Për më tepër, zgjedhja e pafavorshme dhe rreziqet e rrezikut moral ishin të larta. Sidoqoftë, kushtet klimatike që kanë mbizotëruar në Kosovë në vitet e fundit kanë shkaktuar dëme të jashtëzakonshme tek shumë fermerë, veçanërisht atyre në nën-sektorin e frutave, duke dëmtuar kështu rëndë produktet e tyre bujqësore dhe duke i dekurajuar ata të vazhdojnë dhe zgjerojnë bizneset e tyre. Breshëri ka qenë një fenomen i zakonshëm meteorologjik që ka prekur pjesën më të madhe të vendit, duke shkaktuar dëme të mëdha sidomos në nën-sektorët bujqësorë të frutave, perimeve dhe vreshtave. Tabela e më poshtme paraqet humbjet e raportuara të fermerëve në pesë vitet e fundit. Siç shihet, në tre nga këto vite, breshëri përbën rrezikun me më shumë se gjysmën e të gjitha dëmeve të deklaruara.

Tabela 98: Dëmet e raportuara nga fermerët në periudhën 2017-2021, në €

	2017	2018	2019	2020	2021
Të gjitha humbjet (dëmet)	15,425,096	8,381,478	1,969,656	11,837,908	4,996,848
Humbjet nga breshëri	1,972,730	6,457,937	1,198,947	3,448,707	3,085,539
Humbjet nga breshëri (%)	13	77	61	29	62

Burimi: Evidenca nga puna e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për kompensim të dëmeve

Pra, edhe nga dëmet e raportuara, breshëri përbën rrezikun kryesor. Për më tepër, sigurimi i breshërit u bë një kërkesë e zakonshme e sigurimit nga fermerët në të gjithë Kosovën. Prandaj, për të ndihmuar fermerët të kapërcejnë këto situata të vështira, ishte e domosdoshme të zhvilloheshin produkte të sigurimeve bujqësore që do të ndihmonin në kapërcimin e këtyre rreziqeve dhe sigurimin e vazhdimësisë së aktivitetit për shumë fermerë kosovarë. Andaj deri më tani janë zhvilluar tre produkte tradicionale të sigurimit (kundër breshërit, përkatësisht për këto kultura: mollë, rrush dhe spec. Mbulimi i sigurimit të breshërit do të ofrojë mbrojtje kundër dëmtimeve fizike nga breshëri, dhe në shumë raste do të përfshijë mbulim edhe për disa sëmundje të cilat rezultojnë si ndikim i breshërit. Gjatë vitit 2021, është plotësuar dokumentacioni i nevojshëm për funksionalizimin e plotë të produkteve të sigurimit tradicional.

Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Zhvillimi i kapaciteteve tek vlerësuesit e parë të humbjeve bujqësore në Kosovë

Përgjatë tre viteve të kaluara, përkatësisht gjatë 2018, 2019 dhe 2020, puna në sigurime bujqësore ishte fokusuar edhe në zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme njerëzore që do të

mundësonin funksionalizimin e plotë të produkteve tradicionale të sigurimeve. Duke pas parasysh që për sigurimet bujqësore tradicionale kërkohet vlerësim i humbjeve në terren, projekti i sigurimit ka trajnuar në vazhdimësi njëzet e pesë (25) vlerësuesit e ardhshëm të humbjeve, të cilët përcaktojnë përqindjen e saktë të dëmit në kulturën e siguruar dhe kështu mundësojnë llogaritjen e dëmit dhe vlerën e dëmshpërblimit që do të marrin fermerët.

Ndërsa përgjatë vitit 2021, projekti i sigurimeve bujqësore është fokusuar në licencimin apo krijimin e mundësive tjera alternative që këta vlerësues të certifikuar të dëmeve të fillojnë punën e tyre në terren. Për këtë arsye, projekti ka realizuar disa takime me kompanitë e sigurimeve dhe me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), për të mundësuar përdorimin e vlerësuesve ekzistues të dëmeve në sigurimet bujqësore. Bazuar në kërkesat ekzistuese për licencim, vlerësuesi i humbjeve duhet të ketë përvojë në fushën e sigurimeve dhe përvojë në fushën e bujqësisë. Nga vlerësuesit ekzistues të humbjeve të trajnuar në tre vitet e fundit, asnjë nuk i plotëson këto kritere. Prandaj, projekti i sigurimeve i ka rekomanduar institucioneve relevante që të numërohen (llogariten) trajnimet e vlerësuesve të humbjeve të ofruara nga IFC si përvojë e kërkuar në bujqësi.

Në kuadër të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve njerëzore, IFC në bashkëpunim të ngushtë me MBPZHR-në kanë vazhduar me trajnime për ngritjen e kapaciteteve të stafit të kompanive të sigurimit të cilat do të ofrojnë sigurime bujqësore si trajnime për produktet e sigurimeve bujqësore ashtu edhe trajnime për vlerësim të humbjeve.

Kampanjat Publike Vetëdijësuese

Ngjarjet me fermerë, kompani të sigurimit, banka komerciale dhe akterë të tjerë

Si pjesë e projektit të sigurimit të bujqësisë, në vitin 2021, IFC në bashkëpunim të ngushtë me MBPZHR-në organizoi dhe zbatoi disa ngjarje në kuadër të marrëdhënieve me publikun në të gjithë Kosovën. Qëllimi i këtyre ngjarjeve ishte zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe rritja e ndërgjegjësimit për sigurimet në bujqësi.

Përgjatë këtij viti, puna në sigurime bujqësore kryesisht u fokusua në takime konsultative (koordinuese) me fermerë dhe shoqata fermerësh dhe në përgjithësi ndërgjegjësimin e publikut dhe ngritjen e vetëdijes mbi rëndësinë e sigurimit bujqësor. Në kuadër të takimeve koordinuese, janë organizuar disa takime me fermerë (dy tryeza të rrumbullakëta dhe gjashtë takime të tjera), me qëllim të marrjes së mendimeve të fermerëve për produktet e reja të sigurimit bujqësor, përkatësisht për të konsultuar fermerët mbi saktësinë e produkteve të sigurimit bujqësor – përkatësisht për të konfirmuar shkaktarët, periudhën e sigurimit dhe koston e prodhimit. Përvec kësaj, pjesëmarrja në emisione televizive dhe publikimi i artikujve të ndryshëm në lidhje me sigurimet bujqësore ka qenë pjesë e aktiviteteve kyçe mbi ngritjen e vetëdijes mbi sigurimet bujqësore. Në përgjithësi, në vitin 2021, një numër prej 76 personave morën pjesë në një total prej 11 ngjarjeve të organizuara.

Sistemi Informativ i Sigurimeve Bujqësore

Përgjatë vitit 2021, përveç shtatë produkteve ekzistuese të sigurimit, pesë produktet e tjera të sigurimit indeks u përfshinë në këtë sistem informativ. Për më tepër, përgjatë këtij viti, në sistem është përmirësuar edhe forma e faturimit të polisave të sigurimit. Mirëpo, pjesa më e rëndësishme është që përgjatë këtij viti, për shkak të problemeve teknike sidomos në zhvillimin e veçorive të reja në sistem, është vendosur që të krijohet një sistem i ri informativ. Puna për krijimin e këtij sistemi ka filluar në gjysmën e vitit 2021 dhe pritet të përfundojë në fund të vitit 2022.

Gjithashtu edhe faqja e internetit www.sigurimibujqesor.com që u lansua në vitin 2019, u përditësua me material të reja gjatë vitit 2021.

6.5 Projektet e zhvillimit rural – Grantet investive

Pjesa e projekteve të zhvillimit rural, këtë vit do të paraqes përmbledhjen e Programit për Zhvillim Rural 2020-2021, për masat dhe nën masat e përfshira në program si në vijim:

Masa 101 – Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore, përfshinë: sektorin e pemëve frutore (mollë, dardhë, kumbull, vishnje, qershi, kajsi, pjeshkë dhe ftua), sektorin e serrave përfshirë patatet dhe depo për ruajtjen e perimeve, sektorin e mishit (trashja e viçave), sektorin e mishit (trashja e derrave), sektorin e qumështit (lopë qumështore, dele dhe dhi), sektorin e pikave grumbulluese, sektorin e rrushit si dhe sektorin e pulave vojse.

Masa 103 – Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, përfshinë: sektorin e përpunimit të qumështit, sektorin e përpunimit të mishit, sektorin e përpunimit të pemëve dhe perimeve si dhe sektorin e prodhimit të verës.

Masa 302 – Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale, përfshinë nën-masat si prodhimi dhe marketingu i mjaltit, përpunimi i prodhimeve bujqësore (të kultivuara) dhe marketingun e tyre, zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre, zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë, akuakultura/kultivimi i peshkut dhe rritja e shpezëve për vezë dhe mish.

Masa – Ujitja e tokave bujqësore.

Masa 303 – Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale – qasja Leader, përfshinë nën-masat: përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territoreve të GLV-ve të përzgjedhura; zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal, qasja LEADER – për GLV-të e përzgjedhura; dhe kooperimi-bashkëpunimi i cili do të fillohet në një fazë të mëvonshme, pasi që GLV-të të jenë mirë të strukturuar, punonjësit e tyre të jenë trajnuar dhe banorët e territoreve të tyre të kenë demonstruar kapacitetet për të përfituar nga ato aktivitete.

Tabela më poshtë paraqet buxhetin e paraparë për implementimin e Programit për Zhvillim Rural 2020-2021, vlera e paraparë arrin 29,370,000 € dhe përfshinë buxhetin për secilën masë dhe nën masë.

Tabela 99: Buxheti i paraparë i PZhR-së, 2020-2021

Masa dhe nën-masa	Vlera në €
Masa 101: Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore	17,620,000
101.1 Sektori pemë drufrutore arra dhe lajthia	3,200,000 800,000
101.2 Pemë manore	1,500,000
101.3 Sektori i perimeve dhe serrave	3,000,000
101.4 Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	1,200,000
101.5 Prodhimi i mishit/rritja e viçave	2,500,000
101.6 Prodhimi i mishit/rritja e derrave	400,000
101.7 Prodhimi i qumështit/lopë	2,500,000
101.8 Prodhimi i qumështit/dele dhe dhi	420,000
101.9 Pikat grumbulluese të qumështit	500,000
101.10 Prodhimi i rrushit	900,000
101.11 Prodhimi i vezëve	700,000
Masa 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	6,800,000
103.1 Sektori i përpunimit të qumështit	1,700,000
103.2 Sektori i përpunimit të mishit	2,000,000
103.3 Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve	2,100,000
103.4 Sektori i prodhimit të verës	1,000,000
Masa 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	3,850,000
302.1 Sektori, bletaria dhe prodhimi/përpunimi dhe tregtimi i mjaltit	700,000
302.2 Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i produkteve jo drusore të malit	700,000
302.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara	600,000
302.4 Zhvillimi i aktiviteteve artizanale dhe marketingu i tyre	300,000
302.5 Zhvillimi i turizmit rural dhe turizmit në fermë	700,000
302.6 Sektori i akuakulturës/kultivimi i peshkut	350,000
302.7 Sektori rritja e shpezëve për vezë dhe mish	500,000
Masa: Ujitja e tokave bujqësore	800,000
Masa 303: "Zbatimi i strategjive zhvillimore lokale qasje-Leader"	300,000
303.1 Përvetësimi i aftësive dhe nxitja e banorëve të territoreve të GLV-ve të përzgjedhura	89,000
303.2 Hartimi dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal qasja LEADER për GLV-të e përzgjedhura	211,000
Gjithsej	29,370,000

Burimi: Programi për Zhvillim Rural 2020-2021

Bazuar në të dhënat e raportuara nga Drejtoria për Autorizimin e Projekteve në AZHB, gjatë periudhës 2020-2021, janë autorizuar gjithsej 304 projekte në vlerë prej 9,749,612.68 €, nga buxheti i tërësishëm i paraparë për PZhR 2020-2021, 29,370,000.00 €. Vlenë të ceket se thirrja për aplikim për vitin 2021 është anuluar, andaj projektet e paraqitura janë projektet përfituese për thirrjen e shpallur për vitin 2020.

Sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme për masën 101 Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore që përmban nën masat 101.1, 101.2, 101.1.1 vlera e përkrahjes ishte gjithsej 5,804,681.72 € për 188 përfitues. Për masën 103 Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore vlera e përkrahjes ishte 2,623,685.08 € për

gjithsej 19 përfitues duke përfshirë nën masat 103.1, 103.2, 103.3, 103.4. Masa 302 Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve duke përfshirë nën masat 302.1, 302.3, 302.4, 302.7 vlera e përkrahjes ishte 1,211,430.68 € përfshirë 96 përfitues. Si dhe masa për ujitjen e tokave bujqësore që kishte vlerën 109,815.20 € dhe kishte vetëm një përfitues. Tabela në vijim e paraqet në detaje shpërndarjen e përfituesve dhe vlerën për secilën masë dhe nën masë.

Tabela 100: Projektet e autorizuara në kuadër të PZhR-ës, 2020-2021

Masa	Nën Masa	Nr. i përfituesve	Vlera e përkrahjes publike
MASA 101: Investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore	101.1 Pemë drufrutore	59	2,165,164.35
	101.2. Serra	105	2,825,915.36
	101.1.1 Pemë Arrore	24	813,602.01
Gjithsej masa 101		188	5,804,681.72
MASA 103: Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore	103.1 Përpunimi i qumështit	2	285,485.63
	103.2 Përpunimi i mishit	4	641,058.80
	103.3 Përpunimi i pemëve dhe perimeve	9	1,004,079.65
	103.4 Prodhimi i verës	4	693,061.00
Gjithsej masa 103		19	2,623,685.08
MASA 302: Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	302.1 Prodhimi, përpunimi i mjaltit	46	526,019.20
	302.3 Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare	16	196,095.58
	302.4 Zhvillimi i aktiviteteve artizanale	11	198,171.35
	302.7 Rritja e shpezëve për vezë dhe për mish	23	291,144.55
Gjithsej masa 302		96	1,211,430.68
Masa për ujitjen e tokave bujqësore	Masa për ujitjen e tokave bujqësore	1	109,815.20
Gjithsej UTB		1	109,815.20
Gjithsej		304	9,749,612.68

Burimi: AZhB, Drejtoria për Autorizimin e Projekteve

6.6 Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve

Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore në MBPZhR, ka vazhduar edhe këtë vit me bashkërendimin e aktiviteteve në nivel qendror dhe lokal, duke përkrahur dhe ofruar këshilla dhe trajnime.

DShKT në vazhdimësi merret me edukimin dhe trajnimin e këshilltarëve dhe të fermerëve. Për këshilltar organizohen trajnime për ngritje të kapaciteteve si dhe trajnime për certifikim, ndërsa për fermerë organizohen trajnime, këshilla dhe bëhen publikime.

Sistemi Këshillimor i Kosovës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është duke u përdorur për të arritur objektivat e vendosura në PBZhR. Këto fokusohen në ngritjen e të ardhurave bujqësore nga fermat përmes konkurrencës së përmirësuar të tregut, prodhimtarisë dhe zhvillimit rural. Për të ndodhur kjo, ka nevojë të përmirësohet:

- Njohuria bujqësore dhe aftësia e menaxhimit të fermerëve, në mënyrë që të rritet konkurrueshmëria e tyre dhe të inkurajohet inovacioni;
- Menaxhimi i qëndrueshëm i pronave bujqësore, përfshirë përdorimin e përmirësuar të teknologjisë dhe metodave të prodhimtarisë bujqësore;
- Ruajtja e ambientit (ujit, tokës dhe ajrit);
- Arritja e sigurisë së ushqimit dhe cilësisë;
- Veterinaria, fito-sanitaria, mirëqenia e kafshëve, mbrojtja e mjedisit, cilësia dhe standardet e higjienës;
- Zhvillimi i grupeve të fermerëve, raportet në mes prodhuesve, tregtarëve dhe inputeve nga furnitorët, si dhe paketimi i përmirësuar, cilësia dhe vazhdimi i furnizimit me ushqim.

Strategjia e SKKBZhR ka për synim të ofrojë shërbime këshillimore profesionale për fermerë në bazë të partneritetit publiko/privat. Shërbimi këshillimor është duke ndihmuar në ndërtimin e kapaciteteve teknike në nivel të fermave, në mënyrë që:

- Të arrihet një sektor bujqësor më konkurrues, i orientuar nga tregu (për eksporte dhe për importe);
- Të mbështesë fermerët të aplikojnë për grante dhe subvencione të cilat janë në dispozicion përmes MBPZhR dhe programeve BE/donatorë;
- Të ofrojë përkrahje përmes shërbimeve këshillimore për fermerë, si dhe familje rurale dhe komunitete të cilat adresojnë çështje më të gjëra socio-ekonomike në zona rurale;
- Të rreshtojë sektorin agro-bujqësor të Kosovës me atë të BE-së.

DShKT, përmes projekteve që janë zhvilluar në kuadër të planit të tyre ka arritur realizimin e aktiviteteve për përkrahje të fermerëve për analiza të tokës, trajnime, këshillime dhe rekomandime për rezultatet e analizave të tokës si në vijim:

Tabela 101: Pjesëmarrja në trajnime për analizat e dheut

Pjesëmarrësit në Trajnime 2021							
Nr. i trajnimeve	Nr. i pjesëmarrësve	Shqiptarë	Minoritete	Femra	Meshkuj	Mosha 18-40 vjeç	Mosha mbi 40 vjeç
65	884	709	175	52	832	299	585
	100%	75%	25%	4%	96%	24%	76%

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike

Në kuadër të aktiviteteve të zhvilluara në Qendrat Këshilluese Informativ (QKI) komunale të shërbimeve këshillimore, janë organizuar aktivitete për të përkrahur fermerët me këshilla teknike në sektorët e blegtorisë, bletarisë, vreshtarisë, pemëtarisë, perimtarisë dhe prodhimtarisë organike. Tabela në vijim paraqet aktivitetet e zhvilluara në QKI.

Tabela 102: Aktivitetet e zhvilluara në qendrat këshilluese informative

Nr. i aplikacioneve për subvencione të pranuar nga këshilltarët	9,340
Nr. i fermerëve të informuar për grante dhe subvencione	6,607
Nr. i fermerëve të përkrahur në aplikim për grante dhe subvencione	4,245
Nr. i fermerëve të përkrahur në përgatitjen e projekteve	246
Materialet e dhëna në formë të broshurave dhe fletëpalosjeve	4,891
Nr. i fermerëve i përkrahur me këshilla teknike në zyre	5,683
Nr. i përfituesve me trajnime dhe këshilla në teren	1,813

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike

Sqarim: janë të paraqitura vetëm aplikacionet e pranuar nga këshilltarët komunal dhe për këtë dallon nga gjithsej numri i aplikacioneve për subvencione sepse gjatë procesit të aplikimit angazhohen edhe staf plotësues për pranim të aplikacioneve.

Po ashtu sa i përket aktiviteteve të zhvilluara në terren, nga këshilltarët janë realizuar disa aktivitete me pajisjet e tyre që kanë për qëllim përkrahjen e fermerëve për përcaktimin e disa parametrave dhe në bazë të tyre dhënien e këshillave. Aktivitetet e zhvilluara në teren janë paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 103: Aktivitetet e zhvilluara në terren nga këshilltarët

Nr. i mostrave të marra dhe dërgimi i tyre për analizë	62
Nr. i matjeve dhe përcaktimi i pH të tokës	28
Nr. i matjeve dhe përcaktimi i pH të ujit	20
Nr. i matjeve të kripëzimit në tokë - EC e që bazohet në përmbajtje të kripërave në tokë	22
Nr. i matjeve të temperaturës dhe lagështisë së ajrit në objekte të mbyllura	136
Nr. i matjeve të sheqerit në fryte dhe përcaktimi i afatit të vjeljes	65
Nr. i matjeve të fortësisë së fryteve dhe përcaktimi kohës së vjeljes	25
Identifikimi i dëmtuesve në kultura bujqësore	74

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike

DShKT, në kuadër të planit të punës koordinon edhe kompanitë e licencuara për ofrimin e këshillave për bujqësi dhe zhvillim rural të cilat sipas udhëzimit administrativ obligohen të raportojnë dy herë brenda vitit si dhe të dërgojnë planin vjetor të punës në DShKT. Në

tabelën në vijim janë të paraqitura kompanitë e licencuara për ofrimin e këshillave për bujqësi dhe zhvillim rural ku deri më tani janë licencuar gjithsej 13 kompani.

Tabela 104: Kompanitë e licencuara për ofrimin e këshillave për bujqësi dhe zhvillim rural

Kompania	Komuna
IADK	Vushtrri
Consult Engineering	Prishtinë
IKC	Ferizaj
ESG	Prishtinë
KDC	Gjakovë
NSH. KMI	Prishtinë
SH.P.K "PMC"	Prishtinë
Ekrem Strana B.I	Mitrovicë
Novus Consulting	Prishtinë
Kosovo Consulting Group SH.P.K	Gjilan
Agrovinifera Sh.P.K	Rahovec
Recura Sh.a	Prishtinë
Organika	Prishtinë

Burimi: Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike

Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor

Shërbimi Këshillimor vazhdon t'i jep rëndësi të veçantë promovimit, efikasitetit dhe zhvillimit përmes web-faqes së MBPZhR-ës, ku aty ofrohen shërbime për fermerët dhe palët e interesuara, publikime të ndryshme dhe të dhëna statistikore, si dhe këshilla nga të gjitha fushat. Gjithashtu ofrohen mesazhe për fermer sipas periudhave ku synohet të sensibilizohen fermerët për afatet e kryerjes së aktiviteteve të ndryshme bujqësore në mënyrë që të jenë sa më produktiv dhe të njoftuar për çdo zhvillim.

Në kuadër të promovimit janë organizuar vizita të rregullta në QIK për bujqësi dhe zhvillim rural në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, ku edhe është bërë një analizë gjithëpërfshirëse rreth organizimit më të mirë të aktiviteteve nëpër komuna në bashkëpunim me DShKT. Përmes kësaj analize planifikohet edhe organizim i planit të punës në të ardhmen dhe bashkërendimi i aktiviteteve bashkë me komunat në mënyrë që shërbimi këshillimor të vazhdojë të jetë urë lidhëse dhe udhërrëfyes për çdo zhvillim në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

7 Shtojcat

7.1 Lista e ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me Bujqësinë, Pylltarinë dhe Zhvillimin Rural

7.1.1 Legjislacioni kombëtar në fuqi

Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 56/27 Korrik 2009)

7.1.2 Udhëzimet Administrative të miratuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2021

1. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) – Nr. 01/2021 të datës 01.03.2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) – Nr. 01/2018 për Kompensimin Financiar për Shërbimet Veterinare në Terren, të datës 12.02.2018.
2. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) – Nr. 02/2021 të datës 01.03.2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) – Nr. 02/2018 për Identifikimin dhe Regjistrimin e Kafshëve Shoqëruese, të datës 02.03.2018.
3. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) – Nr. 03/2021 për Caktimin e Kritereve për Tregtinë e Brendshme, Importin, Eksportin e Verës dhe Prodhimeve tjera nga Rrushi dhe Vera, të datës 29.04.2021.
4. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) – Nr. 04/2021 për Regjistrimin e Kultivuesve të Rrushit, Prodhuesve të Verërave, Verërave Frutore dhe Prodhimeve tjera nga Rrushi e Vera, të datës 29.04.2021.
5. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) – Nr. 05/2021 të datës 29.04.2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2009 për Caktimin e Taksës për Regjistrimin e Subjekteve, Testim të Varieteteve për Vlerën Kultivuese Prodhuese dhe Shtypjen e Etiketave për Farëra të Drithërave.
6. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) – Nr. 06/2021 të datës 29.04.2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. MA14/2004 për Regjistrimin, Licencimin dhe Caktimin e Taksës për Importuesit, Eksportuesit dhe Tregtuesit e Materialit Fidanor, të Ndryshuar dhe Plotësuar me Udhëzimin Administrativ MA Nr. 04/2007 të datës 14.03.2007 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2011 të datës 24.04.2011.
7. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 07/2021 për Pagesa Direkte në Bujqësi për vitin 2021, të datës 31.08.2021.

8. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 08/2021 të datës 29.10.2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) - Nr. 02/2020 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për vitin 2020-2021.
9. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 09/2021 për Shërbimet e Kryera në Departamentin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë, të datës 10.11.2021.
10. Udhëzim Administrativ (MBPZhR) - Nr. 10/2021 të datës 24.11.2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MBPZhR) - Nr.07/2021 për Pagesat Direkte në Bujqësi për vitin 2021, të datës 31.08.2021.


7.2 Statistikat krahasuese

Tabela 105: Moti në Prishtinë, numri i ditëve me shi dhe borë sipas muaji dhe vitit

Muajt	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Janar	17	8	16	15	10	19	14	10	10	17	6	17
Shkurt	19	10	14	14	5	12	14	6	18	6	10	7
Mars	17	8	4	17	15	14	14	7	23	2	14	12
Prill	17	10	17	11	19	6	7	10	6	19	8	14
Maj	15	9	12	16	15	10	17	15	11	16	14	8
Qershor	7	17	5	14	10	12	12	8	17	9	16	14
Korrik	7	9	5	4	15	3	8	9	21	9	11	7
Gusht	5	7	1	3	5	5	10	4	10	5	15	4
Shtator	9	3	7	9	18	11	8	11	4	9	9	8
Tetor	17	5	7	7	11	14	18	8	7	3	11	13
Nëntor	15	7	8	9	12	8	10	14	10	16	2	9
Dhjetor	20	3	17	4	13	2	1	12	13	14	12	13
Gjithsej	165	96	113	123	148	116	133	114	150	125	128	126

Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Figura 56: Moti në Prishtinë, numri i ditëve me shi dhe borë 2010-2021



Burimi: Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Tabela 106: Gjatësia e lumenjve kryesore brenda territorit të Kosovës

Lumenjtë	Gjatësia në km
Drini i Bardhë	112
Sitnica	110
Lumbardhi i Pejës	56
Morava e Binçës	67
Lepenci	50
Ereniku	38
Ibri	85
Lumbardhi i Prizrenit	36

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela 107: Pyjet e Kosovës sipas llojit dhe pronësisë, ha

	Shtetërore	Private	Gjithsej
Pyje te larta	51,000	15,000	66,000
Pyje te ulëta	116,000	63,000	179,000
Pyje te degraduara	34,000	48,000	82,000
Shkurre/kaçuba	67,000	36,000	103,000
Gjithsej	268,000	162,000	430,000

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela 108: Liqejt kryesor në Kosovë, sipërfaqja në km

Liqejt kryesor në Kosovë, sipërfaqja në km	
Gazivodë	9.1
Radoniq	5.96
Batllavë	3.27
Badoc	2.57

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela 109: Përdorimi i internetit sipas grup moshave, 2018-2022* (%)

	2018	2019	2020	2021	2022
16-24	17	14.5	17.4	..	15.9
25-34	16.5	17.4	16.1	..	15.4
35-44	20.6	20.5	19.5	..	21.8
45-54	19.3	19.5	18.9	..	19.1
55-64	12.7	13.5	15.5	..	16.5
65+	8.4	9.2	10.1	..	10.1

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës,

*Sipas Metodologjisë së EUROSTAT-it nuk ka evidentim për vitin 2022

Tabela 110: Lloji i qasjes në internet në ekonomitë familjare sipas lloji i qasjes dhe viti (%)

	2017	2018	2019	2020	2021
Linja fix/mobil	88.8	93.2	93.2	96.4	96.1
Linja fix	83.6	90.2	91.2	95.1	94
Linja mobil	24.6	24.6	39.6	54.7	62.3

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës,

*Sipas Metodologjisë së EUROSTAT-it nuk ka evidentim për vitin 2022

7.3 Personat përgjegjës për Raportin e Gjelbër, 2022

Tabela e përmbajtjes		Personi përgjegjës
1	Mjedisi i përgjithshëm ekonomik	
1.1	Niveli i zhvillimit socio-ekonomik	H. Xhaferi
1.2	Puna dhe punësimi	H. Xhaferi
1.3	Llogaritë ekonomike në bujqësi	H. Xhaferi
1.3.1	Prodhimet bujqësore	H. Xhaferi
1.3.2	Të ardhurat sipërmarrëse	H. Xhaferi
1.3.3	Inputet në bujqësi	H. Xhaferi
1.4	Çmimet e inpleteve dhe prodhimeve bujqësore	A. Maksuti
1.4.1	Çmimet e inpleteve bujqësore	A. Maksuti
1.4.2	Çmimet e prodhimeve bujqësore	Sh. Duraku
	Çmimet e fermës të prodhimeve bujqësore	Sh. Duraku
	Çmimet e konsumit të prodhimeve bujqësore	Sh. Duraku
	Çmimet e importit të prodhimeve bujqësore	Sh. Duraku
	Krahasimi i çmimeve vendore me çmimet në vendet e regjionit dhe BE-së	Sh. Duraku
1.5	Privatizimi i tokave bujqësore	H. Xhaferi
1.6	Bizneset bujqësore - Agroindustria	H. Xhaferi
2	Prodhimi bujqësor dhe përdorimi i tij	
2.1	Përdorimi i tokës bujqësore	H. Xhaferi
2.2	Prodhimtaria bimore	A. Maksuti
2.2.1	Drithërat	A. Maksuti
2.2.2	Perimet	D. Hana
2.2.3	Pemët	D. Hana
2.2.4	Vreshtat dhe verërat	D. Hana
	Vreshtat	D. Hana
	Verërat	D. Hana
	Analizat fiziko- kimike të verës	D. Hana
2.2.5	Kulturat foragjere dhe drithërat e gjelbëra	A. Maksuti
2.2.6	Kulturat industriale	A. Maksuti
2.3	Ujitja e tokës bujqësore	D. Hana
2.4	Blegtoaria	A. Maksuti
2.4.1	Gjedhet	A. Maksuti
2.4.2	Dhentë dhe dhitë	A. Maksuti
2.4.3	Derrat dhe kafshët tjera të fermës	A. Maksuti
2.4.4	Shpezëtaria	A. Maksuti
2.4.5	Bletaria	A. Maksuti
3	Pylltaria	S. Bajrami
4	Tregtia	
4.1	Tregtia e përgjithshme	B. Dabiqaj/H. Xhaferi
4.2	Tregtia e produkteve bujqësore	B. Dabiqaj/H. Xhaferi
4.2.1	Tregtia sipas grupeve të shteteve	B. Dabiqaj/H. Xhaferi
	Tregtia me vendet e CEFTA-s	B. Dabiqaj/H. Xhaferi
	Tregtia me vendet e BE-së	B. Dabiqaj/H. Xhaferi
	Tregtia me vendet e treta	B. Dabiqaj/H. Xhaferi
4.2.2	Eksporti-Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)	B. Dabiqaj/H. Xhaferi
	Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve (1-24)	B. Dabiqaj/H. Xhaferi
	Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve (01-24)	B. Dabiqaj/H. Xhaferi
5	Siguria, standardet dhe cilësia e ushqimit	H. Xhaferi
5.1	Emetimi i gazrave serrë	H. Xhaferi
6	Politikat Bujqësore, Pagesat Direkte në Bujqësi dhe Përkrahja për Zhvillimin Rural	
6.1	Përmbledhja e synimeve, programeve, masave, buxhetit, granteve dhe subvencioneve	A. Maksuti
6.2	Pagesat direkte/subvencionet	A. Maksuti

6.2.1	Pagesat direkte për kulturat bujqësore, verë dhe sigurim bujqësor Primi i sigurimi bujqësor	A. Maksuti A. Maksuti
6.2.2	Pagesat direkte për blegtori dhe qumësht	A. Maksuti
6.2.3	Mbështetja e inputeve në bujqësi Mbështetja e fidanëve	A. Maksuti A. Maksuti
6.3	Agro kreditë dhe fondi garantues	Sh. Duraku
6.3.1	Agro Kreditë Fondi Kosovar për Garanci Kreditore - FKGK	Sh. Duraku Sh. Duraku
6.4	Sigurimet në fushën e bujqësisë Zhvillimi dhe Shitja e Produktet Indeks të Sigurimit Bujqësor Dëmet/ humbjet dhe Pagesat e Dëmshpërblimit Produktet Tradicionale të Sigurimit Bujqësor Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore Kampanjat Publike Vetëdijësuese Sistemi Informativ i Sigurimeve Bujqësore	A. Maksuti A. Maksuti A. Maksuti A. Maksuti A. Maksuti A. Maksuti A. Maksuti
6.5	Projektet e zhvillimit rural - Grantet investive	D. Hana
6.6	Përmirësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve Edukimi, trajnimi dhe shërbimi këshillimor Promovimi, efikasiteti dhe zhvillimi strukturor	D. Hana D. Hana D. Hana
7	Shtojcat	
7.1	Lista e ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me Bujqësinë, Pylltarinë dhe Zhvillimin Rural	D. Hana
7.1.1	Legjislacioni kombëtar në fuqi	D. Hana
7.1.2	Udhëzimet Administrative të miratuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vitin 2021	D. Hana
7.2	Statistikat krahasuese	H. Xhaferi

e-mailat kontaktues:

delvina.hana@rks-gov.net

hakile.xhaferi@rks-gov.net

adelina.maksuti@rks-gov.net

shkelqim.duraku@rks-gov.net

belgin.dabiqaj@rks-gov.net

skender.bajrami@rks-gov.net